- **Baza ligjore**. Teoria e rastit duhet gjithashtu të përmbajë një deklarim të qartë se cili do të duhej të jetë rezultati i duhur ligjor i rastit. Çfarë vendimi do të duhej të marrë gjyqtari dhe pse? Dhe mbi çfarë baze ligjore? Askush nuk guxon ta teprojë këtu – nuk mund, për shembull, t'i thuhet gjyqtarit se përfituesi nuk e ka qëlluar viktimën, por nëse e ka qëlluar, e ka bërë në vetëmbrojtje. Pothuajse gjithmonë ka shumë argumente ligjore që mund të bëhen dhe praktikuesi duhet të vendosë se cili është më i forti dhe që ka më shumë gjasa për të qenë i suksesshëm. Ky është një vlerësim jashtëzakonisht pragmatik ku praktikuesi pyet se çfarë rezultati mbështetet nga provat dhe është në përputhje me arsyen e shëndoshë. Ju do të duhej të shmangni kurthin e mendimit dëshiror se ka gjasë mbase që gjyqtari t'ju japë një rezultat edhe më të mirë duke vendosur në favorin tuaj për një çështje të dobët. Për shembull, një i paditur në një çështje kompensimi dëmi do të mund të argumentonte se nuk kishte pakujdesi, nuk kishte asnjë shkak të afërt, se paditësja pësoi vetëm dëme minimale, se aksidenti ishte i pashmangshëm ose se ishte 50% faji i vetë paditësit, por nuk mund t'i argumentojë të gjitha këto teori ligjore në të njëjtën kohë. Nëse praktikuesi i ndihmës juridike përfaqëson një të pandehur i cili, në kohën e një aksidenti, ishte i dehur, kishte tejkaluar shpejtësinë, duke vozitur në korsinë e gabuar dhe nuk kishte patentë, ai ose ajo do të duhej të ishte i lajthitur sikur të merrte në konsideratë një teori të rastit se përfituesi nuk kishte vepruar me pakujdesi, se sjellja e tij nuk ishte një shkak i afërt i përplasjes që pasoi, ose që aksidenti ishte i pashmangshëm. Nëse paditësja ka

pësuar vetëm dëmtime nga inercia e përplasjes, të cilat nuk mund të verifikohen në mënyrë mjekësore, dhe se ajo nuk e kishte lidhur rripin e sigurisë, teoria e rastit mund të mbështetet më mirë në argumentin se dëmet e provueshme janë të vogla dhe se paditësja ka kontribuuar me pakujdesi. Mbase do të duhet të pranohet se përfituesi do të duhet të paguajë kompensimin për disa dëme, por kjo është shumë më mirë sesa të ngrihet argumenti i paarsyeshëm se ai do të duhej të lirohet pa pasoja.

- **Emocionet.** Një teori e mirë e rastit shikon gjithashtu përmbajtjen emocionale të rastit. Nëse një gjyqtar është në anën tuaj emocionalisht dhe dëshiron të vendosë në favor të përfituesin tuaj, ai ose ajo zakonisht do të gjejë një mënyrë për ta bërë këtë. A është bërë një padrejtësi? A ka të drejtë klienti juaj për simpati? A do të zgjojë rasti juaj nostalgji, sentimentalizëm, ndjenjën e frymës së komunitetit, patriotizmit apo indinjatën e drejtë? A janë të përfshirë në rast fëmijët dhe kafshët shoqëruese? Zakonisht do të ketë të paktën disa aspekte të rastit tuaj që do të gjenerojnë reagime pozitive emocionale. Edhe nëse përfaqësoni një kriminel të urryer, mund të jeni në gjendje të krijoni pak simpati nëse ai ka pasur një fëmijëri të vështirë ose është abuzuar. Ana e kundërt e këtij shqyrtimi të përmbajtjes emocionale është se ju duhet të parapritni dhe të jeni të përgatitur për t'u marrë me emocionet që do të zgjohen kundër jush. A do të ketë antipati gjyqtari për përfituesin apo rastin tuaj? A do të nxiten qëndrime raciste apo seksiste nga faktet e rastit? A do t'ju duhet të përballeni me stereotipa negativë sepse përfituesi juaj është i ri, i moshuar, me tatuazh, obez, i papunë ose një ish-kriminel? Një teori e mirë e rastit merr parasysh të gjitha këto çështje emocionale dhe zhvillon një strategji për të theksuar aspektet pozitive dhe për të minimizuar ato negative.

- **Dobësitë**. Një praktikues duhet të njohë, të pranojë dhe të ketë një shpjegim të arsyeshëm dhe koherent për dobësitë në rastin e përfituesit. Me dobësi nënkuptojmë problemet e qenësishme të rastit që lindin pavarësisht se çfarë bën apo thotë pala kundërshtare, dhe jo kontestet që lindin nga konfliktet në prova. Një dobësi është një boshllëk, mospërputhje, pamundësi ose e metë në teorinë e rastit. Ato lindin kur faktet kryesore nuk mund të provohen, janë të pavërtetuara, vijnë nga dëshmitarë me probleme besueshmërie, ose mbahen mend ndryshe nga dy dëshmitarë të vetë klientit, për shembull. Llojet e tjera të dobësive përfshijnë të metat e karakterit të dëshmitarëve të rëndësishëm, nevojën për t'u mbështetur në aspekte teknike ligjore, asociimet e pafavorshme dhe vendet ku rasti nuk është në përputhje me arsyen e shëndoshë. Pjesë e procesit të planifikimit është të vendosësh nëse një dobësi është mjaft e rëndësishme për ta pranuar atë në kuadër të rastit, dhe nëse po, si të zvogëlohet efekti i saj negativ.

- **Parapritni argumentin e kundërshtarit**. Mos harroni se ka një avokat në anën tjetër që do të përpiqet të bindë gjyqtarin për një histori që bie ndesh me atë të përfituesit tuaj. Në gjykimin që do të vijë, praktikuesi i ndihmës juridike do të duhet të luajë edhe në mbrojtje edhe në sulm. Nëse të dyja palët e bëjnë punën në mënyrë kompetente, gjyqtari do të duhet të zgjedhë mes dy versioneve konkurruese të ngjarjeve dhe sa më shumë që praktikuesi i ndihmës juridike arrin të demonstrojë pabesueshmërinë e argumenteve të kundërshtarit, aq më shumë ka gjasa që gjyqtari të pranojë versionin e përfituesit. Do të duhej të analizohen argumentet e kundërshtarit për të përcaktuar se ku do të lindin kundërthëniet dhe ku kundërshtari është i fortë dhe i dobët. Ky informacion do të duhej të përdoret për të vendosur se ku të sulmohet pala tjetër. Një strateg i mirë thekson pikat

e tij të forta dhe sulmon dobësitë e palës tjetër. Kjo pjesë e teorisë së rastit është kritike, sepse është kundërproduktive të përpiqesh të sulmosh pikat e forta të palës tjetër. Sulmet e tilla zakonisht dështojnë, dhe nëse dështoni mjaft shpesh, kjo e bën rastin e kundërshtarit të duket i pathyeshëm.

- **Përmbledhja e shkurtër**. Në fund, teoria e një praktikuesi të ndihmës juridike për rastin ka nevojë për një përmbledhje të mirë me tri ose katër fjali që e përthekon rastin dhe përpiqet të kapë me pak fjalë të gjitha elementet kryesore të teorisë së rastit: Kush kujt i çfarë i bëri dhe pse ia bëri? Cili ishte rezultati? Cilat janë arsyet ligjore dhe morale që kjo kërkon një vendim në favorin tuaj? Cila është prova juaj më e rëndësishme dhe përgjigja juaj më e mirë për argumentet e palës tjetër? Është një praktikë e mirë që të shkruhet përmbledhja e teorisë së rastit në pjesën e jashtme të dosjes së rastit dhe/ose në çdo sistem të automatizuar për menaxhimin e rasteve për ta mbajtur atë vazhdimisht të pranishme.

NJËSIA E MUNDSHME MATËSE: Teoria e Rastit, me elementet e saj faktike, ligjore dhe provuese, të përcaktuara dhe të dokumentuara shkurtimisht në procesverbalin/raportin përfundimtar të rastit.

Standardi 11. Një praktikues i ndihmës juridike do të duhej të marrë parasysh angazhimin e konsulentëve dhe dëshmitarëve ekspertë kurdo që është e përshtatshme dhe e mundur, pavarësisht nëse rasti i përfituesit është në gjykatë apo jo.

Marrja e provave me cilësi të lartë në favor të përfituesit është çelësi i suksesit, qoftë në arritjen e një ujdie të favorshme ose në gjykim. Së këndejmi, praktikuesi, veçanërisht në raste komplekse që përfshijnë, për shembull, çështje psikologjike (kujdestaria e fëmijës, vizitat me fëmijën dhe pothuajse çdo rast që përfshin përcaktimin e "interesit më të mirë" të fëmijës ose fëmijëve), ato shkencore (përgjegjësia rreth produkteve ose kompensimi i dëmeve) ose çështjet e vjetra të kadastrës ose pronës, do të duhej të bëjë çmos për t'u konsultuar me ekspertë të pavarur për të ndihmuar trajtimin e këtyre rasteve dhe për të ndihmuar në sigurimin e provave pozitive.

Përdorimi i ekspertëve si dëshmitarë diskutohet më tej në Seksionin më poshtë.

Ashtu si në pjesën më të madhe të botës, shumica e praktikuesve apo organizatave të ndihmës juridike në Kosovë nuk kanë fonde të mjaftueshme për të paguar shoqërimin ose këshillimin e ekspertëve në rastet e tyre. Së këndejmi, praktikuesi duhet të jetë kreativ në sigurimin e kësaj mbështetjeje të rëndësishme multidisiplinore dhe eksperte. Një praktikë e mirë ndërkombëtare është nënshkrimi i memorandumeve të mirëkuptimit me universitetet vendase nëpërmjet fakulteteve të tyre të psikologjisë, biologjisë, kimisë ose mjekësisë për të ofruar shoqërim dhe këshillim të ekspertëve nëpërmjet studentëve në vitet e fundit të studimeve ose si pjesë e proceseve të praktikës. Ndonëse këta persona mund të jenë më pak në gjendje të japin dëshmi në gjykim sesa profesionistët e certifikuar duke pasur parasysh mungesën e tyre relative të përvojës, ata megjithatë mund të ofrojnë njohuri, ndihmë dhe shoqërim të çmueshëm për të kuptuar çështjet që shpesh janë përtej bazës së njohurive të praktikuesit të ndihmës juridike. Një praktikë e mirë ndërkombëtare për zyrat e ndihmës juridike/mbrojtjes publike është që të ketë të paktën një psikolog ose punonjës social si pjesëtar të stafit me orar të plotë për të ndihmuar në çështjet e të drejtës familjare dhe të tjera.

NJËSIA E MUNDSHME MATËSE: Numri i ekspertëve të pavarur të konsultuar formalisht ose joformalisht gjatë rastit.

Standardi 12: Praktikuesi i ndihmës juridike në rastet e përfaqësimit në gjykatë do të duhej të paraqesë dhe të argumentojë me kohë të gjitha parashtresat ose propozimet e procedurës paraprake që mund të jenë të dobishme për përfituesin sipas LPK, duke zbatuar me shkathtësi dhe ekspertizë të drejtën materiale dhe procedurale. Kjo përfshin përcjelljen e kujdesshme të afateve procedurale.

LPK parasheh një numër të madh të "propozimeve" të procedurës paraprake që palët mund t'i bëjnë para gjykatës. Shumë prej këtyre mund të jenë me përfitime pozitive për përfituesit (si paditësit ashtu edhe të padituri). Këtu përfshihen propozimet ose "kërkesat" për:

- Lirimin nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore (neni 468 i LPK);
- Përjashtimin e gjyqtarit (neni 68 i LPK) për anshmëri, konflikt interesi ose arsye tjetër;
- Hedhjen e padisë për shkak të mungesës së kompetencës lëndore, territorial ose personale të gjykatës (neni 391 i LPK);
- Hedhjen e padisë për shkak të lidhjes së ujdisë paraprake (neni 391 i LPK);
- Marrjen e deklaratës nga njëra prej palëve në gjykim (neni 373 i LPK);
- Marrjen ("sigurimin") e provës përpara gjykimit nëse ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet marrja e saj në gjykim (nëse është "shumë e rëndësishme" për çështjen) (LPK neni 379.1);
- Kryerjen e "ekspertizave" me urdhër nga gjykata (nenet 356-358, 407 të LPK);
- Skualifikimin ose "përjashtimin" e ekspertëve pas marrjes së ekspertimit me mendimin e tyre (neni 360 i LPK);
- Mbajtjen e takimit për ujdi (neni 411 i LPK);
- Zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim; ose
- Kompensimin e dëmit të shkaktuar nga mosrespektimi i rregullave procedurale nga gjyqtari (neni 288.2 i LPK).

Edhe pse jo në mënyrë specifike në LPK (dhe në disa nga ligjet materiale ose në rregulloret e nxjerra në përputhje me Ligjin për Gjykatat e vitit 2018), gjyqtarëve u kërkohet të vendosin disa raste, si ato që përfshijnë rrezik për fëmijët ose të tjerët, në – udhë të shpejt. Si i tillë, është e rëndësishme që praktikuesi i ndihmës juridike të shqyrtojë çdo dhe të gjitha faktet në lidhje me çdo nevojë për lehtësim urgjent dhe/ose të përkohshëm dhe çdo pasojë që mund të rezultojë nëse një lehtësim i tillë nuk ofrohet, dhe ta vendosë këtë informacion në kërkesë ose përgjigje në çështjet civile, familjare ose pronësore, me synimin për të bindur gjykatën që ta marrë çështjen në mënyrë të shpejtë. Këto propozime për urgjencë ose për masa të përkohshme i dorëzohen me shkresë Kryetarit të Gjykatës Themelore, por një kopje (me numrin e indeksit) duhet t'i jepet edhe gjyqtarit të caktuar për rastin.

Afatet kohore procedurale të përcaktuara në LPK: LPK përcakton standarde të qarta kohore për çdo hap procedural drejt zgjidhjes së kërkesëpadive civile. Këtu përfshihen:

- Gjyqtari duhet t'ia dërgojë të padituri padinë me shkresat e bashkangjitura brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur është paraqitur në gjykatë (neni 394 i LPK);

- I padituri duhet të përgjigjet me shkrim në padi brenda afatit prej 15 ditësh nga marrja e njoftimit nga gjykata (neni 395.1 i LPK);
- Si rregull, gjyqtari duhet të mbajë seancën përgatitore brenda afatit prej 30 ditësh nga dita në të cilën gjykatës i ka arritur përgjigja në padi e të padituri (neni 400.4 i LPK);
- Si rregull, gjyqtari duhet ta mbajë seancën kryesore brenda afatit prej 30 ditësh nga seanca përgatitore (neni 420.2 i LPK); dhe
- Gjyqtari duhet të nxjerrë aktgjykim për lëndën brenda afatit prej 15 ditësh nga përfundimi i seancës kryesore; çdo vonesë në nxjerrjen e aktgjykimit duhet t'i raportohet Kryetarit të Gjykatës (neni 153 i LPK).

LPK në mënyrë të nënkuptuar lejon përshtatjen e arsyeshme të disa afateve dhe kornizave kohore, por në përgjithësi parashikon përfshirjen aktive të gjyqtarëve për të mbajtur procesin e gjykimit brenda standardeve të përcaktuara kohore. Për shembull, LPK parashikon që "si rregull" seanca përgatitore dhe seanca kryesore duhet të ndodhë brenda 30 ditëve nga ngjarja paraprake—duke sugjeruar që gjyqtarët kanë njëfarë fleksibiliteti kur është e nevojshme. Mirëpo, një lexim i thjeshtë i gjuhës normative nuk lejon shtyrje të pacaktuara ose të pajustifikuara (shih, për shembull, LPK, nenet 441.1 dhe 441.2) dhe Kryetari i Gjykatës duhet të monitorojë të gjitha shtyrjet e shqyrtimeve kryesore (shih LPK, neni 441.3).

Ndërsa në praktikë dihet gjerësisht se shumë, shumë gjyqtarë në lëndët që shqyrtohen në gjykatat në Kosovë, veçanërisht në qytetet më të mëdha, nuk i respektojnë të gjitha këto afate procedurale në secilin rast, pjesërisht për shkak të numrit të madh të lëndëve të prapambetura, megjithatë është thelbësore që avokati i ndihmës juridike të jetë plotësisht i vetëdijshëm dhe t'i ndjekë këto afate kohore në çdo rast, duke ndërmarrë veprimet e duhura (siç janë paraqitja e propozimeve ose hartimi i parashtresave) në gjykatë në rast të mospajtueshmërisë.

NJËSIA E MUNDSHME MATËSE: Numri i propozimeve, kërkesave dhe njoftimeve të procedurës paraprake të paraqitura në gjykatë ose të përgatitura dhe të dhëna përfituesit në rastet e përfaqësimit të pjesshëm. Nota në vlerësimin e dosjes/shkresave të lëndës, që mund të kryhet me mbylljen e një rasti nga mbikëqyrësit.

Standardi 13: Një praktikues i ndihmës juridike do të duhej të eksplorojë me kujdes opsionet për ujdinë ose ndërmjetësimin e çdo kontesti për të përcaktuar nëse këto do të ishin në interesin më të mirë të klientit.

Procedimi i plotë gjyqësor i çështjeve civile, familjare dhe pasurore mund të jetë i gjatë, i kushtueshëm (nga aspekti i kohës dhe burimeve) dhe çështjet e komplikuara janë shumë frustruese për klientët. Duke marrë parasysh ankimin dhe potencialisht taktikat zvarritëse nga pala tjetër, rastet shpesh mund të marrin disa vite për t'u përfunduar. Së këndejmi, zgjidhja me ujdi e rasteve të përshtatshme përpara një gjykimi të plotë, në varësi nga kushtet e ujdisë, shpesh mund të jetë në interesin më të mirë të klientit. Prandaj, praktikuesit e ndihmës juridike do të duhej të eksplorojnë opsionet për zgjidhjen e kërkesëpadisë me ujdi me palën kundërshtare (qoftë drejtpërdrejt me palën kundërshtare, ose me avokatin e palës kundërshtare nëse dihet se ai ose ajo përfaqësohet nga avokati).

Këshilla se si të përgatiteni për negociata të suksesshme për ujdi:

- **Kryeni një hetim të plotë**. Praktikuesi i ndihmës juridike ende do të duhet të kryejë procesin e plotë hetimor (i njohur edhe si "zbulim" në disa juridiksione) ashtu sikur ai ose ajo do të planifikonte dhe do të përgatitej për procedim në gjyq. Kjo do të ofrojë municion të konsiderueshëm në negociatat e ujdisë. Ai ose ajo do të duhej të kërkojë dëshmitarë, të marrë deklaratat e tyre ose t'u kërkojë atyre të hartojnë deklarata nën betim, të shoshitë dokumentet për të gjetur prova të mira dhe të konsultohet me dëshmitarët ekspertë për mendimet e tyre për provat.
- **Njihuni me rastin**. Praktikuesi i ndihmës juridike do të duhej të dijë gjithçka për praktikën gjyqësore, ligjet, faktet e çështjes, provat dhe dëshmitë e dëshmitarëve. Kjo do të bëjë që praktikuesi i ndihmës juridike të duket jashtëzakonisht i përgatitur dhe madje mund të frikësojë palën tjetër.
- **Thurni një tregim të fuqishëm**. Në çdo gjykim, avokatët përpiqen të thurin tregime të fuqishme dhe bindëse gjatë fjalës hyrëse, në mënyrë që të formësojnë mendimin e porotës për atë që ka ndodhur përpara se të dëgjojnë provat. Praktikuesi i ndihmës juridike |do të dëshirojë të bëjë të njëjtën gjë në negociata në mënyrë që të përpiqet të bindë palën kundërshtare se tregimi i përfituesit të tij ose të saj është versioni i saktë i asaj që ka ndodhur.
- **Identifikoni cakun e negociatave dhe kufijtë më të ulët të klientit**. Për të negociuar shifrat e ujdisë, praktikuesi i ndihmës juridike, në konsultim me përfituesin, do të duhet të dijë shumën më të ulët që klienti është i gatshëm të pranojë, si dhe cila është shuma e synuar. Në një rast të kompensimit të dëmit, minimumi i thjeshtë zakonisht është i barabartë me shpenzimet nga xhepi, siç janë tarifat e avokatëve dhe shpenzimet mjekësore. Shuma e synuar do të përfshijë humbjen e cilësisë së jetës, shqetësimin emocional, pagat e humbura dhe më shumë.
- **Parapritni argumentet e palës tjetër dhe përgatitni kundër-argumente**. Asnjëherë nuk dihet se çfarë do të ndodhë saktësisht në dhomën e negociatave, por praktikuesi i mirë i ndihmës juridike do të duhej të jetë i përgatitur për çdo gjë. Ai ose ajo do të duhej të krijojë strategji të ndryshme për situata të ndryshme. Kjo do t'i mundësojë atij ose asaj të argumentojë mënyrën e tij ose saj drejt një marrëveshjeje të suksesshme të ujdisë.

Relativisht pak padi do të duhej të kalojnë nëpër gamën e plotë të procedurave dhe deri në seancën kryesore. Në një botë ideale, vetëm rastet më të diskutueshme do të duhej të shkojnë në një gjykim të plotë, i cili shpesh është një proces i gjatë, i kushtueshëm dhe irritues për palët. Në shumë vende të botës, shumica dërrmuese e çështjeve civile zgjidhen me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet palëve. Një kontest në Kosovë dhe gjetkë mund të zgjidhet edhe përpara se të ngrihet një padi. Pasi të paraqitet padia, kontesti mund të zgjidhet përpara fillimit të gjykimit dhe deri në fund të seancës kryesore, ose në apel (neni 411.2 i LPK). Gjyqtari mund t'i ndihmojë palët të arrijnë një ujdi (por shpesh nuk kanë kohë për ta bërë këtë). Në Kosovë, LPK (neni 41) i lejon gjyqtarit (nëse shihet si "e nevojshme") ose palëve që ta referojnë çështjen për një proces "ndërmjetësimi" ose zgjidhje me ujdi, edhe pse fatkeqësisht në praktikë shkalla e zgjidhjes së lëndëve civile me ujdi është relativisht e ulët.

Ujdia zakonisht nuk thotë se cila palë e kishte me të drejtë ose gabim, as nuk duhet medoemos të zgjidhë të gjithë rastin (neni 414 i LPK). Mund të zgjidhet një pjesë e kontestit, ndërsa çështjet e mbetura mbeten për t'u zgjidhur nga gjyqtari. Marrëveshjet e ujdisë do të duhej të përmbajnë

<u>Këshilla për një fjalë hyrëse të suksesshme</u>:

Përdorni një deklaratë të fortë hyrëse dhe një temë, e cila do të vazhdojë gjatë gjithë gjykimit. Tema do të duhej të jetë tërheqëse dhe e lehtë për t'u mbajtur mend (p.sh. "ky rast i kujdestarisë së fëmijës është një rast i njerkës së keqe").

Sigurimi i kredibilitetit. Praktikuesi i ndihmës juridike do të duhej të përpiqet të tërheqë vëmendjen e gjyqtarit me fjalën hyrëse. Një fjalë e mirë hyrëse demonstron sinqeritet, njohuri të fakteve, vetëbesim dhe pëlqyeshmëri të gjitha në të njëjtën kohë. Fjala hyrëse nuk do të duhej të përmbajë as premtime të tepruara as synime modeste.

Trajtoni çdo fakt të pafavorshëm drejtpërdrejt. Shumica e rasteve përfshijnë një masë të caktuar të fakteve "të këqija" për klientin. Këto do të duhej të trajtohen drejtpërdrejt në vend që informacioni të vijë nga avokatët kundërshtarë në një dritë më të pafavorshme.

Ofroni gjyqtarit një udhërrëfyes të lëndës, duke përdorur teorinë e rastit. Disa avokatë përdorin PowerPoint ose tabela të bardha për të dhënë fjalën hyrëse. Çështjet do të duhej të futen në kornizë, të shpjegohen në mënyrë të thjeshtë dhe të tregojnë një histori bindëse.

Qëndroni në temë. Thoni gjyqtarit se çfarë do të tregojnë apo vërtetojnë provat. Dhe mos dilni jashtë temës.

Krijoni energjinë e duhur. Kontakti me sy me gjyqtarin është i rëndësishëm siç është përdorimi i një toni të përshtatshëm. Mos kini frikë të përdorni lëvizje të qëllimshme – si ecja përpara ose gjestet – për të krijuar energjinë e duhur në sallën e gjykimit.

formulimin në lidhje me përmbarimin e marrëveshjes dhe çfarë ndodh në rast të mosrespektimit. Tarifat e avokatit dhe të gjykatës mund të jenë gjithashtu pjesë e marrëveshjes së ujdisë (neni 416 i LPK)

Ujditë do të duhej të hartohen me kujdes dhe të jenë sa më të plota sipas rrethanave. Avokatët do të duhej të përdorin gjuhë të përpiktë dhe të shmangin dykuptimësitë. Megjithëse shpesh është e dobishme të rishqyrtohen dhe ndonjëherë edhe të përfshihen formulimet nga ujditë e mëparshme, kjo nuk do të duhej të bëhet pa shqyrtim të kujdesshëm të zbatueshmërisë së formulimit në rastin konkret. Gjithashtu, formulimet e negociuara në marrëveshjet e mëparshme rrallë do të jenë të përshtatshme për t'u përdorur në marrëveshjet e propozuara. Avokatët do të duhej të mbajnë një dosje të propozimeve të tyre fillestare të ujdisë për përdorim kur nevojitet një model për hartimin e një marrëveshjeje të re. Hartimi i dokumenteve të ujdisë nuk do të duhej të trajtohet kurrë si një detyrë rutinë, pavarësisht nga thjeshtësia e dukshme e dispozitave që palët i konsiderojnë thelbësore.

Pavarësisht nëse një çështje zgjidhet me ujdi apo jo, praktikuesit e ndihmës juridike do të duhej të përpilojnë një memorandum të negociatave/ofertës për ujdi për ta pasur në dosje që parashtron përpjekjet e bëra nga avokati për ujdi, kushtet e çdo oferte të propozuar për ujdi së bashku me detajet e prezantimit ose diskutimit të tyre me klientin, dhe, nëse janë refuzuar nga përfituesi dhe arsyet për refuzim. Një praktikë e mirë është që avokatët të përgatisin dhe të përfshijnë një letër drejtuar klientit me detajet e çdo oferte për ujdi dhe rekomandimet e avokatit në lidhje me këtë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse përfituesi humb gjykimin ose i jepet një shumë më e ulët sesa parashikohej në ofertën e ujdisë.

NJËSIA E MUNDSHME MATËSE: Ekzistenca e një memorandumi të negociatave ose të ofertës në dosje. Nota në vlerësimin e dosjes/shkresave të lëndës, që mund të kryhet me mbylljen e një rasti nga mbikëqyrësit.

Standardi 14: Një ofrues i ndihmës juridike do të duhej të paraqesë argumente të qarta, të fokusuara, të forta dhe të përgatitura mirë në seancën kryesore, të cilat zbatojnë ligjin dhe faktet në mënyrë efektive në mbështetje të një teorie bindëse të rastit dhe të kryejë me

shkathtësi marrjen në pyetje të dëshmitarëve të vet dhe të palës kundërshtare (përveç nëse nuk është bërë dëm në marrjen në pyetje të drejtpërdrejtë).

LPK thotë fare pak për detajet e zhvillimit aktual të seancës kryesore. Së këndejmi, ka dallime nga gjyqtari në gjyqtar. Praktikuesi i ndihmës juridike do të duhej të përpiqet të bëjë fjalën hyrëse dhe fjalën përmbyllëse bazuar në fakte dhe ligjin në fuqi dhe do të duhej të kryejë një "marrje në pyetje të drejtpërdrejtë" të dëshmitarëve në favor të pozicionit të përfituesit, duke përfshirë edhe vetë përfituesin nëse merret vendimi strategjik që përfituesi të dëshmojë dhe një "marrje në pyetje të tërthortë" të dëshmitarëve, duke përfshirë të padituri, për dëshmitarët që dëshmojnë ose pritet të dëshmojnë kundër interesave të paditësit. Me përjashtim të pyetjeve që "sugjerojnë" përgjigjen (neni 433.2 i LPK), pyetjeve që janë të parëndësishme dhe që tashmë janë bërë dhe janë përgjigjur (neni 433.3 i LPK), ose pyetjeve që fyejnë ose shqetësojnë (neni 433.4 i LPK), LPK nuk jep shumë detaje lidhur me formën e pyetjeve që mund të bëhen, duke ia lënë këtë palëve. Praktikuesi i ndihmës juridike gjithashtu do të duhej të jetë i përgatitur që të parashtrojë "prapësim" te gjyqtari lidhur me formën e pyetjeve të bëra nga avokati kundërshtar dhe të insistojë që gjyqtari të përfshijë këto kundërshtime në procesverbalin e seancës kryesore.

Ndërsa praktika efektive e përfaqësimit në gjykim mund të jetë (dhe shpesh është) temë e një libri të tërë ose manual i veçantë, janë disa këshilla kryesore që praktikuesi i ndihmës juridike duhet të mbajë mend, duke përfshirë sa vijon: Shumë nga këshillat dhe praktikat më të mira të mëposhtme në lidhje me mbrojtjen e gjykimit janë njësoj të zbatueshme si për gjykimet civile ashtu edhe për ato penale. Në Kosovë, shkalla në të cilën palët mund dhe bëjnë të marrin në pyetje dëshmitarët dhe ekspertët gjatë gjykimeve civile ndryshon në mënyrë të konsiderueshme sipas gjyqtarit dhe stilit të tij ose të saj, por praktikuesit e ndihmës juridike duhet të jenë të vetëdijshëm se zakonisht është në interesin më të mirë të përfituesit të tyre që avokati i tij ose i saj të bëjë pyetje aktive, si nëpërmjet marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë dhe të kryqëzuar, si dhe duke bërë kundërshtime, kur është e përshtatshme.

Fjala hyrëse: Fjala hyrëse i jep gjyqtarit një pasqyrë dhe ia bën të ditur se cila është teoria e përfituesit për rastin, duke përfshirë elementet ligjore dhe faktike, dhe si do ta vërtetojë teorinë praktikuesi i ndihmës juridike. Praktikuesi nuk do të duhej të përmend gjëra që ai ose ajo nuk do të jetë në gjendje t'i vërtetojë gjatë seancës kryesore/gjykimit.

Marrja në pyetje e drejtpërdrejtë: Marrja në pyetje e drejtpërdrejtë do të duhej të ekzekutohet më shumë si një tregim sesa një sërë pyetjesh të gjata dhe të detajuara nga avokati. Dëshmitari do të duhej të bëjë pjesën më të madhe të të folurit dhe pyetjet në përgjithësi do të duhej të jenë të hapura për të kërkuar përgjigje të gjata, por përshkruese dhe narrative nga dëshmitari. Pyetjet e hapura përfshijnë sa vijon: "çfarë", "pse", "kush", "ku", "kur" dhe pastaj pyetje të tilla si "çfarë ndodhi më pas".

<u>Këshilla për mënyrën efektive të marrjes në pyetje "drejtpërdrejt"</u>:

- Përgatitni dëshmitarët përpara gjykimit (pa i udhëzuar se çfarë të thonë)
- Mos lejoni që dëshmitari të humbasë rrugën e tij/saj drejt pikave kyçe
- Përdorni gjuhë të përshtatshme dhe të kuptueshme
- Lëreni dëshmitarin të shpjegojë (duke shmangur konkluzionet e përgjithshme) dhe më pas bëni pyetje pasuese për detajet që mungojnë
- Vëzhgoni dhe dëgjoni dëshmitarin dhe mbani shënime në lidhje me dëshmitë kryesore
- Në përgjithësi organizoni dëshminë sipas rendit kronologjik, megjithëse fillimi dhe mbarimi me pikat më të forta mund të jetë një teknikë tjetër organizimi
- Nxjerrni në pah çdo dobësi të njohur në dëshminë e tij ose saj me fjalët e tyre.
- Përdorni mjete konkretizimi vizual (grafikë, diagrame, harta, foto, etj.) duke pasur parasysh se "një fotografi vlen më shumë se një mijë fjalë".
- Bëni pyetje të hapura, pyetje që kërkojnë një tregim dhe pyetje pasuese
- Kërkoni nga dëshmitari që fillimisht të përshkruajë vendin (vendosja e kontekstit) pastaj veprimet që kanë ndodhur
- Mbani kontakt vizual me dëshmitarin
- Përdorni heshtjen dhe pauzat për efekt dramatik
- Lëreni dëshmitarin të shpjegojë me demonstrim
- Vendosni bazat për ekspertët (përvoja, njohuritë, metodologjia, etj.) dhe më pas kërkoni mendimin e tyre

Marrja në pyetje e tërthortë: Praktikuesi i ndihmës juridike do të duhej të bëjë marrjen në pyetje të tërthortë për dëshmitarët e palës kundërshtare ose dëshmitarët armiqësorë. Çelësi i marrjes në pyetje të tërthortë në mënyrë të suksesshme është të theksohen pika kyçe për të sfiduar besueshmërinë e dëshmitarit ose dëshmisë së tij ose të saj dhe jo për të marrë tregimin e tyre siç është rasti me marrjen në pyetje të drejtpërdrejtë. Edhe pse nuk lejohen pyetjet "sugjestive", mund të bëhen pyetje të mbyllura. Pyetjet e mbyllura janë pyetje që kërkojnë elemente specifike të provës dhe jo përshkrime apo tregime.

Është e rëndësishme të vendoset nëse do të ndërmerret marrja në pyetje e tërthortë e një dëshmitari të caktuar. Për të vendosur këtë, do të duhej të merret parasysh:

Këshilla për marrje në pyetje të tërthortë me sukses

- Do të duhej të bazoheni gjerësisht në atë që dëshmitari ka thënë gjatë marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë dhe pyetjet të jenë relevante
- Përgatitni tema (kredibiliteti, anshmëria, paanshmëria, interesi financiar, mungesa e qartësisë, motivi për të gënjyer, kontradiktat në dëshmi me deklaratat e mëparshme, kapaciteti i dobët ose mungesa e mundësive për të vëzhguar ose perceptuar, memorie e dobët, etj.) për të adresuar ato që mbështesin teorinë e rastit, në vend të pyetjeve të shkruara
- Mos përdorni pyetje të hapura pasi në përgjithësi nuk do t'ju pëlqejë përgjigjja. Përdorni pyetje të hapura vetëm për të kërkuar dëshmi pozitive nga dëshmitari, nëse ka, ose për çështje kolaterale.
- Përdorni fjali të mbyllura duke kërkuar përgjigje specifike (duke shmangur ato sugjestive) për të mos lejuar që dëshmitari të marrë kontrollin. Asnjëherë, ama kurrë mos i bëni dëshmitarit një pyetje që fillon me "pse".
- Përdorni një ton zëri të palëkundur (pa qenë përçarës ose fyes)
- Mos i përsëritni aspektet e marrjes në pyetje të drejtpërdrejtë, veçanërisht nëse ato janë negative për klientin
- Dini kur të ndaloni dhe mos bëni "pyetjen e fundit" (d.m.th. pyetjen që konfirmon pikën që përpiqeni ta theksoni me marrjen në pyetje – pra që dëshmitari gënjen ose është i njëanshëm). Pyetja e fundit i jep dëshmitarit një mundësi për të shpjeguar. Përkundrazi, përdorni nxjerrjen e konkluzioneve në fjalën përmbyllëse për t'iu përgjigjur pyetjeve përfundimtare me fjalët tuaja.
- Mos bëni një pyetje nëse nuk e dini përgjigjen.

- A e dëmtoi dëshmitari teorinë e rastit të klientëve?
- A ishte dëshmitari i rëndësishëm?
- A ishte dëshmitari i besueshëm?
- A tha ai apo ajo më pak se sa pritej?
- Sa me risk do të ishte marrja në pyetje e tërthortë e dëshmitarit?
- Cilat janë pikat kryesore në teorinë e rastit të klientit dhe a janë prekur ato nga dëshmia e dëshmitarit?

Prapësimet:

Prapësimet e vetme për marrjen në pyetje të dëshmitarëve bazuar në dispozitat e përcaktuara shprehimisht të LPK-së, sipas nenit 433 të LPK-së, do të ishin për sa vijon:

- Pyetje e parëndësishme;
- Pyetje e përsëritur (pyetur dhe përgjigjur);
- Pyetje sugjestive;
- Pyetje fyese; ose
- Pyetje që shqetëson ose ka për qëllim të shqetësojë.

Praktikat e mira në lidhje me prapësimet në juridiksione të tjera që mund të përdoren në Kosovë, përfshijnë sa vijon. Për aq sa është e mundur, praktikuesi i ndihmës juridike mund dhe do të duhej të përpiqet të klasifikojë shumë nga këto prapësime në kategoritë e gjera si pyetje "fyese", "që ka për qëllim të shqetësojë" ose "e parëndësishme".

- Pyetje dinake ose kapcioze që ka për qëllim të ngatërrojë dëshmitarin (p.sh., kur i goditët fëmijët tuaj, a qanë ata?)
- Thashetheme (deklaratë e bërë nga një palë e tretë jashtë gjykatës e disponueshme për marrje në pyetje të tërthortë që po parashtrohet për të provuar të vërtetën e çështjes së pohuar nga dëshmitarët)
- Shkelje e privilegjit avokat-klient ose privilegjit tjetër
- Thirrje për dëshmi eksperti ose ekspertim kur dëshmitari nuk është ekspert
- E paqartë ose e dykuptimtë
- Thirrje për spekulime
- Kërkon informacione konfidenciale
- Kërkon informacione të diskutuara në ndërmjetësim
- Komplekse (si p.sh. dy pyetje në një)
- Supozon fakte që nuk janë pjesë e provave

Fjala përmbyllëse: Fjala përmbyllëse përmbledh rastin dhe përfshin argumentet e fundit që gjyqtari do të dëgjojë përpara se të marrë vendimin e tij/saj. Në përgjithësi, fjala përmbyllëse do të duhej të përfshijë: (1) një përmbledhje të provave të paraqitura në gjykim; (2) çdo konkluzion të arsyeshëm që mund të nxirret nga provat; (3) një atak në çdo vrimë ose dobësi në argumentet e palës tjetër; (4) një përmbledhje të ligjit të zbatueshëm dhe teorisë së rastit; dhe (5) një lutje konkrete drejtuar gjyqtarit për të ndërmarrë një veprim specifik ose për të vendosur në një mënyrë të caktuar.

NJËSIA E MUNDSHME MATËSE: Një rezultat i përgjithshëm pozitiv në gjykim (dhënia e kompensimit të dëmit, etj.). Nota në instrumentin e vlerësimit të performancës në gjykim (që mund të zbatohet nga zyrtari i ANJF ose monitoruesi tjetër i gjykatës).

Standardi 15: Një praktikues i ndihmës juridike do të duhej të shmangë në mënyrë proaktive çdo vonesë të panevojshme të çështjes.

Duke pasur parasysh se drejtësia e vonuar shpesh është drejtësi e mohuar, është detyrë e çdo praktikuesi të ndihmës juridike që vepron në emër

Këshilla për një fjalë përmbyllëse të suksesshme:

Filloni me një hyrje të fortë. Ashtu si me fjalën hyrëse, fjalët më të mira përmbyllëse fillojnë me një hyrje të fuqishme por dhe mbresëlënëse. Dhe fjalët më të mira përmbyllëse përsërisin, në pjesën hyrëse, *teorinë e rastit ose temën* që u përdor në fjalën hyrëse.

Sigurimi i vazhdimësisë dhe kohezionit gjatë gjithë prezantimit të rastit. Duke ndjekur të njëjtën strukturë në hyrje dhe në mbyllje (p.sh., duke përsëritur teorinë e rastit dhe temën).

Tregoni emocion dhe pasion. Asnjëherë mos jepni fjalën përmbyllëse në një mënyrë monotone ose të painteresuar. Tregoni emocionin e duhur. Argumentoni me pasion.

Mos e lexoni kurrë fjalën përmbyllëse. Qëllimi juaj gjatë përmbylljes do të duhej të jetë të arrini relacionin (lidhjen) me gjyqtarin. Mos harroni se një fjalë e shkëlqyer përmbyllëse ka të bëjë po aq me *performancën* sa ka të bëjë me *substancën*.

Adresoni dobësitë e rastit. Përpara se të jepni fjalën tuaj përmbyllëse, vendoseni veten në lëkurën e gjyqtarit. Çfarë pyetjesh do të kishit në lidhje me thelbin e çështjes suaj? Cilat dobësi do të identifikonit? Kur identifikoni pyetje dhe dobësi të tilla, *adresoni ato në fjalën përmbyllëse*.

Diskutoni provat në detaje, por bëni këtë në një mënyrë që tregon një histori (tregim). Avokatët më të mirë dinë të japin një tregim bindës në gjykim. Ata nxjerrin në pah faktet e favorshme dhe shpjegojnë faktet e pafavorshme. Dhe në përmbyllje, avokatët më të mirë përdorin dëshminë e nxjerrë në gjykim për të kompletuar tregimin e tyre dhe për të ngritur një argument me pasion për një vendim gjyqësor në favor të klientit të tyre. Avokatët më të mirë e dinë se çfarë *nuk* duhet të bëjnë: kurrë mos bëni vetëm një përmbledhje të provave.

Përdorni teknikat jo-verbale. Për të vendosur relacionin (lidhjen), ju do të duhej të përdorni lëvizje strategjike. Ndryshoni tonin dhe projeksionin e zërit. Mbani një qëndrim të hapur, me këmbë të hapura sa gjerësia e shpatullave. Përdorni shprehjet e fytyrës dhe gjestet e duarve për të theksuar pikat e rëndësishme. Qëllimi juaj është të jeni autentik, jo i ushtruar, dhe bindës, jo i sajuar. Dhe më e rëndësishmja, jini të sigurt, sepse vetëbesimi është gjithçka.

Jepni fund fuqishëm. Fjalët tuaja të fundit duhet të jenë më të mirat dhe më mbresëlënëset. Objektivi juaj është të siguroheni që pikat më të rëndësishme që mbështesin çështjen tuaj të mbeten në kujtesën e gjyqtarit.

të ANJF dhe ofruesve të tjerë të ndihmës juridike në çështjet civile, familjare dhe pasurore për të siguruar që çështja të trajtohet me aq efikasitet dhe shpejtësi sa të jetë e mundur, duke pranuar se shpesh kjo është jashtë kontrollit për shkak të ngarkesave me lëndë dhe vonesave në gjykata. Kjo do të thotë se:

- Duhet bërë çdo përpjekje për të shmangur çdo vonesë ose shtyrje në procedimin e një çështjeje civile, familjare ose pasurore.
- Shtyrjet do të duhej të shmangen, përveç rasteve kur është absolutisht e nevojshme, duke pasur parasysh të drejtën e të akuzuarit për tërheqje të akuzës ose procedim me gjykim.

NJËSIA E MUNDSHME MATËSE: Koha e përpunimit të çështjes nga paraqitja e kërkesëpadisë deri në zgjidhje (duke marrë parasysh vonesat jashtë kontrollit të praktikuesit të ndihmës juridike).

Standardi 16: Një profesionist i ndihmës juridike do të duhej të krijojë dhe të mbajë një dosje elektronike në sistemin e menaxhimit të lëndëve ose një dosje në kopje fizike për secilin prej rasteve të tij ose të saj, ku evidentohen të gjitha faktet materiale dhe transaksionet, ofrohet një evidentim i detajuar kronologjik i punës së kryer dhe përcaktohet një kurs veprimi i planifikuar. Përveç kësaj, një ofrues i ndihmës juridike do të duhej respektojë të gjitha politikat përkatëse në lidhje me ruajtjen e dosjeve të përfituesit dhe të dhënave të informacionit.

Dosjet elektronike (baza e të dhënave, si Sistemi i Informacionit për Ndihmën Juridike në ANJF ose SINJ, ose sistem i ngjashëm i menaxhimit të lëndëve) ose kopjet fizike të dosjeve do të duhej të organizojnë elementet kritike të rastit në një mënyrë logjike, kronologjike dhe koherente. Çdo shkresë do të duhej të përmbajë informacionin e mëposhtëm thelbësor:

- Një tregues i opsioneve të disponueshme dhe të përzgjedhura nga klienti, një deklaratë e objektivave të përfituesit dhe përmbledhja me 3-4 fjali e Teorisë së Rastit;
- Një regjistrim i plotë kronologjik i intervistave të përfituesit dhe komunikimeve të tjera me përfituesin (telefonata, etj.); kontaktet e kundërshtarit; intervistat e palëve të treta dhe dëshmitarëve ekspertë; hetimet në terren; dhe kërkimet e evidencave, duke përfshirë datat, emrat e personave të kontaktuar, faktet e rëndësishme të konstatuara dhe deklaratat e rëndësishme, dhe koncesionet dhe pretendimet e bëra;
- Një histori kronologjike e të gjitha aktiviteteve kyçe hetimore, gjyqësore dhe të ngjashme me data (për të qenë në gjendje të maten periudhat kohore);
- Një tregues i gjuhës kryesore për klientët, gjuha e preferuar e të cilëve nuk është shqipja, interpretuesit dhe përkthyesit e përdorur dhe kopjet e materialeve të përkthyera;
- Kopjet e të gjithë korrespondencës me shkrim, parashtresave, memorandumeve ligjore, hulumtimeve ligjore dhe dokumenteve të tjera që përfaqësojnë punën e bërë në rastin në fjalë, të organizuara në mënyrë sistematike për referim të gatshëm;
- Ose një kopje fizike ose një version elektronik i korrespondencës së shkëmbyer elektronike;
- Një plan specifik me një përcaktim të qartë të detyrave dhe një plan kohor me afate për kryerjen e secilës detyrë, duke përfshirë çdo periudhë përkatëse parashkrimi, në përputhje
  me kompleksitetin e rastit;

- Një regjistrim i plotë i kohës së shpenzuar për rastin në fjalë, i mjaftueshëm për të mbështetur çdo kërkesë për tarifat e avokatëve, nëse është e përshtatshme, dhe për të përmbushur nevojat e drejtuesve të organizatës, si dhe çdo kërkesë të vendosur nga ANJF ose burime të tjera financimi; dhe
- Një memorandum përmbyllës (së bashku me letrën mbyllëse) që përmbledh punën e bërë për klientin dhe rezultatet e arritura për klientin në rastet e mbyllura.

Një praktikues ose organizatë e ndihmës juridike mund të dëshirojë të zhvillojë dhe të përdorë protokolle, shabllone, standarde dhe lista kontrolluese për të udhëzuar praktikuesit në trajtimin e problemeve të përsëritura ligjore si rutinë.

Shabllonet janë formularë të paracaktuar në një dokument përpunues teksti me rubrika ku mund të plotësohen lehtësisht informacionet e rastit dhe mund të jenë shumë të dobishme dhe të kursejnë kohë në detyrat e përsëritura. Shabllonet janë veçanërisht të dobishme për dokumente, të tilla si marrëveshjet e angazhimit, propozimet rutinë në gjykatë, letrat mbyllëse për klientët, memorandumet e ujdisë dhe dokumente të ngjashme që kanë gjuhë të standardizuar. Një grup i shablloneve të përdorura nga ANJF është bashkëngjitur si Aneks dhe përmbajn këto shabllona:

• Ankesë në Inspektoratin e Punës
• Kërkesa gjyqësore për pagesën e përfitimeve të pensionit jubilar
• Ankesë në Departamentin e Pensioneve të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me ankesën për refuzim të pagesës së pensionit.
• Ankesë në Departamentin e Administratës Pensionale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me ankesën për mohim të përcaktimit të aftësisë së kufizuar.
• Autorizimi(ANJF)
• Fletë mbulesë e veprimit ligjor (ANJF).
• Deklarata e ekspertit mjekësor në lidhje me aftësinë e kufizuar të klientit
• Regjistri i Dëshmive të Veprimeve Ligjore (ANJF)
• Kërkesë për përjashtim nga taksat në gjykatë (ANJF)
• Apeli për Mbrojtjen e Ligjshmërisë në Çështjet Penale
• Kundërshtimi i provave dhe Kërkesa për Hedhjen e Aktakuzës
• Marrëveshja me shkrim e çiftit të martuar për mbrojtjen, edukimin dhe kujdesin e fëmijëve
• Referim tek Oda e Avokatëve të Kosovës, Avokati Privat
• Kërkesa në Gjykatën Themelore për Dëme sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve
• Ankesë në Gjykatën Themelore për Refuzimin e Kompensimit të Personave Paraplegjikë ose Tetraplegjikë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
• Kërkesë në Gjykatën Themelore për Besim dhe Alimentim të Fëmijëve
• Kërkesë në Gjykatën Themelore për Kontakt me Fëmijë (Vizitë)
• Ankesa në Gjykatën Themelore për Refuzim të Pensionit për Invalidët e Luftës dhe Viktimat Civile nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
• Kërkesë në Gjykatën Themelore për Verifikimin e Pronësisë së Pronës
• Kërkesë në Gjykatën Themelore për zgjidhjen e martesës (Shkurorëzimin)
• Përgjigja në Ankesën e Rastit të Kompensimit të Dëmit
• Kundërshtimi i debitorit në Gjykatën Themelore ndaj propozimit të kreditorit për përmbarim
• Propozim në Gjykatën Themelore për Përmbarim të Aktgjykimit
• Propozim në Gjykatën Themelore për Besimin e Fëmijëve me Marrëveshje

• Propozim në Gjykatën Supreme për Revizionin e Aktgjykimit për Zbatimin e gabuar të së Drejtës Materiale
• Mocioni në Gjykatën e Lartë lidhur me Urgjencën e Përshpejtimit të Çështjes
• Vendimi i ANJF-së për Pranimin e Kërkesës së Përfituesit për Ndihmë Juridike

Protokollet përcaktojnë çështjet bazë që duhen trajtuar dhe hapat thelbësorë që duhen ndërmarrë në rastet rutinë. Megjithëse janë të dobishme, protokollet do të duhej të përdoren nga praktikuesi vetëm si një udhërrëfyes për të vlerësuar objektivat e veçanta të përfituesit në një mënyrë pozitive dhe kreative, duke pasur parasysh rrethanat e rastit, dhe për të testuar për çështje të reja dhe unike. Protokollet mund të hartohen gjithashtu për të tërhequr vëmendjen ndaj situatave të zakonshme faktike ose çështjeve të zakonshme ligjore, në mënyrë që organizata të mund të marrë parasysh problemet e tilla në procesin e caktimit të prioriteteve dhe të drejtojë ndarjen e burimeve të saj për zgjidhjen efikase dhe ekonomike të këtyre problemeve të përsëritura.

Standardet përcaktojnë rezultatet e pritshme dhe realiste që do të duhej të arrihen në adresimin e çështjeve ligjore që përsëriten zakonisht. Standardet mund të jenë të ndryshme në mesin e zyrave, duke pasur parasysh ligjin dhe praktikën në çdo juridiksion. Shumë nga standardet e përcaktuara të performancës në këtë Manual kanë "njësi të propozuara matëse" të cilat janë një lloj standardi për vlerësimin e performancës dhe për të lehtësuar nivele më të larta të cilësisë.

Listat kontrolluese mund të jenë të dobishme për të siguruar që të gjithë hapat janë ndërmarrë dhe të gjitha dokumentet e kërkuara janë përgatitur, dorëzuar dhe përfshirë në dosjen e klientit. Shumë lista kontrolluese janë përfshirë më poshtë në këtë Manual.

3. Aspekte të përgjithshme në lidhje me Ligjin e Procedurës Kontestimore (LPK):

a. ***Pasqyrë:*** LPK është ligji procedural kryesor për përfaqësuesin dhe praktikuesin e ndihmës juridike civile, duke rregulluar në mënyrë të barabartë çështjet civile, familjare dhe pasurore. Ai zbatohet për të gjitha rastet që janë subjekt i fushëveprimit të këtij Manuali dhe si të tilla do të diskutohen më gjerë. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet aspekteve të hetimit dhe çështjeve provuese, veçanërisht në lidhje me çështjet me prioritet të së drejtës civile, familjare dhe pasurore.

b. Fazat procedurale sipas LPK:

Për të siguruar efikasitet dhe zgjidhje me kohë dhe të drejtë të padive civile, LPK parashikon një sërë hapash të veçantë, secili prej të cilëve është krijuar për të përgatitur rastet për ujdi eventuale ose zgjidhje me gjykim. Hapat e ndërmjetëm përfshijnë mbikëqyrjen e palëve, veçanërisht në lidhje me detyrimin e tyre për të paraqitur prova relevante dhe të pranueshme që mbështesin kërkesat e padisë dhe mbrojtjen e tyre brenda afateve dhe kornizave specifike kohore. LPK parasheh hapat e mëposhtëm për shqyrtimin e kërkesëpadisë:

Paraqitja e kërkesëpadisë. Shqyrtimi i çdo padie civile fillon me paraqitjen e kërkesëpadisë me shkrim të bazuar në prova kundër të paditurit(ve) që plotëson kërkesat procedurale të parapara me LPK.

Shqyrtimi fillestar i kërkesëpadisë. Gjyqtari duhet të kryejë (ose të mbikëqyrë kryerjen e) një shqyrtim fillestar të kërkesëpadisë së kërkuesit dhe të udhëzojë paditësin të korrigjojë ose të plotësojë parashtresën e tij/saj—ose, nëse paditësi dështon të veprojë në përputhje me këto udhëzime brenda ose përpara afateve përkatëse, të refuzojë kërkesëpadinë.

Caktimi me kohë i gjyqtarit për të udhëhequr çështjen është i nevojshëm në mënyrë që gjykata të mos dështojë në respektimin e afateve të detyrueshme të përcaktuara me LPK. Për shembull, është e detyrueshme që gjykata të njoftojë të padituri për padinë (dhe të udhëzojë të padituri që të paraqesë një përgjigje ndaj padisë) brenda 15 ditëve nga paraqitja e padisë. Rrjedhimisht, shqyrtimi fillestar dhe çdo korrigjim ose plotësim i nevojshëm i kërkesëpadisë duhet të bëhet brenda asaj periudhe 15-ditore.

Gjyqtari duhet të bëjë një shqyrtim fillestar të kërkesëpadisë në lidhje me konfliktin e interesit ose moskorrektësi të tjera, kompetencën territoriale mbi çështjen dhe kompetencën personale mbi të padituri, dhe se ka pajtueshmëri procedurale.

Shmangia e konfliktit të interesit ose e padrejtësisë: Për të shmangur konfliktin e interesit ose shfaqjen e parregullsive nga ana e gjyqtarëve, LPK parasheh që gjyqtarët do të duhej të përjashtohen nga një rast i caktuar në rrethanat e mëposhtme, përkatësisht nëse ai ose ajo, në bazë të nenit 67 të LPK:

- Është vetë palë, përfaqësues ligjor apo me prokurë i palës, apo në qoftë se me palën është bashkëkreditor apo bashkëdebitor ose i obliguar për regresim, apo në qoftë se në të njëjtën çështje është dëgjuar si dëshmitar ose si ekspert;
- Është bashkëshort, partner jashtëmartesor, kushëri gjaku në vijën vertikale deri në cilëndo shkallë, kurse në vijën horizontale deri në shkallë të katërt, apo në qoftë se është bashkëshort, apo gjini e krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesa ka pushuar ose jo;
- Është kujdestar, adoptues ose i adoptuar i palës, i përfaqësuesit të saj ligjor ose me prokurë;
- Në qoftë se në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të gjykatës më të ulët, ose të organit tjetër, ose në procedurën e ndërmjetësimit;
- Në qoftë se ka vepruar në çështjen në të cilën është bërë ujdia gjyqësore, e me padinë e ngritur kërkohet anulimi i ujdisë së këtillë;
- Në qoftë se është aksionar apo anëtar i shoqërisë tregtare që është palë në procedurën e iniciuar me padi;
- Në qoftë se ekzistojnë rrethana të tjera që e vejnë në dyshim paanësinë e tij/saj.[45]

Për më tepër, një palë mund të bëjë kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit në rrethanat e mëposhtme (shih neni 68 i LPK):

- Pala e paraqet kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit posa të ketë mësuar se ekziston ndonjëri nga shkaqet e përjashtimit, por më së voni deri në përfundim të shqyrtimit të çështjes, e nëse nuk ka pasur shqyrtim të saj, atëherë deri në momentin e marrjes së vendimit meritor;

- Pala mundet në mjetin e goditjes së vendimit përfundimtar apo në përgjigjen në mjetin e goditjes ta emërtoj gjyqtarin që nuk do të mundej të marr pjesë në dhënien e vendimit për shkak te ekzistimit të rrethanave nga neni 67 i këtij ligji;
- Pala mund ta kërkojë përjashtimin e gjyqtarit të caktuar me emër dhe mbiemër që vepron në çështjen konkrete, përkatësisht të kryetarit të gjykatës i cili duhet të vendosë mbi kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit;
- Pala ka për detyrë që në kërkesën për përjashtim t'i cekë rrethanat nga të cilat përfundon se ekziston ndonjë bazë ligjore për përjashtimin e gjyqtarit;
- Gjyqtari duhet të pezullojë të gjitha procedimet për çështjen përkatëse pasi të mësojë për një kërkesë për përjashtim ose sapo gjyqtari të konstatojë se ekziston ndonjë nga kushtet për përjashtim të renditura në nenin 67 dhe më pas të informojë menjëherë Kryetarin e Gjykatës për situatën. Mirëpo, kur kërkesa e një pale bazohet në nenin 67(g) (duke pretenduar rrethana që mund të ngrenë pyetje në lidhje me paanshmërinë e gjyqtarit), gjyqtari duhet të njoftojë Kryetarin e Gjykatës dhe mund të vazhdojë procedimet për çështje që rrezikojnë të shtyhen;
- Nëse kërkohet përjashtimi i Kryetarit të Gjykatës, atëherë ai/ajo duhet të emërojë një gjyqtar zëvendësues nga gjyqtarët e fushës përkatëse—nëse kjo nuk është e mundur, atëherë ai/ajo duhet të veprojë në përputhje me nenin 63;
- Kërkesa e palës për përjashtimin e gjyqtarit nuk lejohet: (a) nëse kërkohet përjashtimi i të gjithë gjyqtarëve të gjykatës që do të mund të gjykonin në një kontest të caktuar; (b) nëse lënda e kërkesës është vendosur më parë; ose, (c) nëse nuk është arsyetuar shkaku në bazë të të cilit kërkohet përjashtimi;
- Mbi kërkesën e palës për përjashtimin e gjyqtarit vendo Kryetari i Gjykatës. Në qoftë se pala e kërkon përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës, vendimi për përjashtimin duhet të merret nga Kryetari i gjykatës më të lartë;
- Gjyqtari duhet të bëjë një deklaratë dhe mund të kryhen ekzaminime të tjera përpara se të merret një vendim për përjashtim.

Ndërsa këto rregulla të përjashtimit të gjyqtarëve janë shumë të detajuara, është e rëndësishme që praktikuesi i ndihmës juridike të jetë plotësisht i vetëdijshëm për to dhe të sigurohet që asnjëra prej tyre nuk zbatohet në çështjen në fjalë, dhe nëse zbatohet, të procedojë parashtresën e duhur përpara gjykatës së duhur prë të përjashtuar gjyqtarin për të shmangur çdo padrejtësi apo paragjykim ndaj klientit të tij/saj.

Sigurimi i kompetencës së gjykatës mbi lëndën, padinë dhe palën e paditur: Për të proceduar, gjykata duhet të jetë kompetente për padinë (kompetenca "lëndore"), për objektin e kontestit ("kompetenca territoriale" ose "vendi") dhe për palën e paditur ("kompetenca personale"). Praktikuesi i ndihmës juridike, për të paraqitur siç duhet një padi si dhe për ta mbrojtur atë, duhet të kuptojë rregullat që lidhen me kompetencën lëndore, territoriale dhe personale dhe të bëjë propozimet e duhura nëse konstatohet se gjykata nuk i ka të tri llojet e kompetencës. Problemet e kompetencës lëndore në përgjithësi ndodhin nëse, për shembull, një çështje penale paraqitet në një gjykatë civile.

Kompetenca territoriale ose vendi në përgjithësi qëndron:

- Në territorin e vendbanimit të fundit të përbashkët, vendbanimin e palës së paditur, ose gjykatën me kompetencë të përgjithshme territoriale (GJKPT) në kontestet e shkurorëzimit (neni 44, 56 i LPK);
- Në GJKPT ose në territorin ku fëmija e ka vendbanimin në kontestet e atësisë (neni 45 i LPK);
- Në GJKPT ose në territorin ku paditësi e ka vendbanimin e tij/saj në kontestet e mbajtjes së fëmijëve (neni 46 i LPK);
- Në GJKPT ose në territorin ku është shkaktuar ose ku ka lindur pasoja e dëmit, në kontestet e përgjegjësisë jashtë kontratës për dëmin (neni 47.1 i LPK);
- Në GJKPT ose në territorin ku paditësi e ka vendbanimin në rastet që përfshijnë dëme të shkaktuara nga vdekja ose lëndimi i rëndë trupor (neni 47.2 i LPK);
- Në GJKPT ose në territorin ku puna kryhet ose është kryer ose në territorin ku pretendohet se është themeluar marrëdhënia e punës në kontestet nga marrëdhënia e punës (neni 49 i LPK);
- Në GJKPT ose në territorin ku është bërë pagesa për kontestet që kanë të bëjnë me kambial ose çek (neni 50 i LPK);
- Në GJKPT ose në territorin ku ndodhet një person juridik në kontestet kundër një personi juridik (neni 51 i LPK);
- Në GJKPT ose në territorin ku ndodh pengimi në kontestet për pengim-posedimin mbi sendet e luajtshme (neni 52 i LPK); dhe
- Në GJKPT ose në territorin ku i padituri është i detyruar të përmbushë kontratën në kontestet e kontratave (neni 53 i LPK).

Në lidhje me kompetencën personale mbi të padituri, kjo në përgjithësi qëndron kur të padituri i është dorëzuar me rregull padia në adresën e tij të fundit të njohur. Kundërshtimi i kompetencës mbi këtë bazë në përgjithësi bëhet duke pretenduar se i padituri nuk e ka marrë padinë.

Njoftimi i të padituri dhe shqyrtimi i përgjigjes. Gjyqtari/gjykata e caktuar duhet t'i japë (dorëzojë) të padituri një kopje të padisë (dhe dokumentet mbështetëse) brenda afatit prej 15 ditësh nga paraqitja e kërkesëpadisë në gjykatë nga paditësi, së bashku me një udhëzim nga gjyqtari që i padituri duhet të paraqesë një përgjigje të bazuar në prova në gjykatë brenda afatit prej 15 ditësh nga marrja e materialeve nëse ai/ajo kundërshton kërkesëpadinë dhe një njoftim për pasojat e mosparaqitjes së përgjigjes në padi.

Në një çështje që përfshin një të paditur për të cilin i padituri nuk ka dhënë një adresë aktuale, gjyqtari mund të caktojë një përfaqësues ligjor të përkohshëm për të mbrojtur të drejtat e të padituri dhe për të minimizuar vonesat në procedurë. Ashtu si me kërkesëpadinë, gjyqtari duhet të kryejë (ose të mbikëqyrë kryerjen e) një shqyrtim fillestar të përgjigjes së palës së paditur dhe të udhëzojë palën e paditur të korrigjojë ose të plotësojë parashtresën e tij/saj—ose, nëse pala e paditur dështon të veprojë në përputhje me këto udhëzime brenda ose përpara afateve përkatëse, të marrë masat e duhura.

Nëse i padituri dështon të parashrojë një përgjigje brenda afatit të caktuar, gjyqtari ka diskrecionin për të nxjerrë aktgjykim të drejtpërdrejtë, përveç nëse ligji dhe rrethanat lejojnë ndryshe.

Shqyrtimi paraprak i rastit. Pasi të konstatohet se kërkesëpadia e bazuar në prova e paditësit është e vlefshme nga aspekti procedural dhe i padituri ka paraqitur një përgjigje të bazuar në prova (ose i padituri që ka marrë padinë në mënyrë të rregullt nuk ka parashtruar përgjigje brenda afatit 15-ditor), gjyqtari duhet të kryejë një shqyrtim paraprak të rastit për të vlerësuar nëse kontesti mund të zgjidhet në bazë të thelbit të padisë ose mbrojtjes pa gjykim—ose të ndërmarrë hapa për të siguruar që i pandehuri i saktë është emërtuar në padi.

Për shembull: (1) gjyqtari mund të nxjerrë **aktgjykim drejtpërdrejt**pa gjykim kur konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike; (2) gjyqtari mund ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit kur konstaton se nga provat e paraqitura nga paditësi nuk del themelësia e kërkesëpadisë sipas dispozitave ligjore në fuqi; dhe, (3) gjyqtari mund të nxjerrë **aktgjykim drejtpërdrejt** në favor të paditësit pa gjykim nëse përgjigjja në padi nga i padituri pranon faktet materiale që mbështesin kërkesëpadinë e paditësit. Shih LPK, neni. 399.1 (që i jep gjyqtarit diskrecionin për të hedhur poshtë padinë si të pathemeltë pas shqyrtimit të padisë, përgjigjes dhe provave mbështetëse); neni 399.2 (që i jep gjyqtarit diskrecionin për të hedhur poshtë padinë pas shqyrtimit të padisë, përgjigjes dhe provave mbështetëse, dhe kur konstaton se provat janë në kundërthënie me pretendimet e paditësit); neni 399.1 (që i jep gjyqtarit diskrecionin për të hedhur poshtë padinë si të pathemeltë pas shqyrtimit të padisë, përgjigjes dhe provave mbështetëse). Shih gjithashtu nenin 152 (parasheh që nëse gjyqtari konstaton se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare që mbështesin kërkesëpadinë e paditësit, gjyqtari mund të nxjerrë aktgjykim për zgjidhjen e kontestit, nëse nuk ka arsye të tjera për vazhdimin e procedimeve).

Fakti që një gjyqtar mund të nxjerr aktgjykim drejtpërdrejt në bazë të vetë kërkesëpadisë ka implikime të rëndësishme për praktikuesin e ndihmës juridike që përgatit kërkesëpadinë. Gjegjësisht, kjo do të thotë që praktikuesi i ndihmës juridike do të duhej që pas një hetimi të plotë (duke mos u mbështetur vetëm te klienti për të marrë informacion) të përfshijë një sasi të konsiderueshme detajesh në vetë kërkesëpadinë, në mënyrë që gjyqtari të kuptojë plotësisht çështjet e paraqitura. Gjithashtu do të duhej të parapriten argumentet e njohura të palës kundërshtare dhe të përmenden prova që kundërshtojnë argumentet e tilla, pa e forcuar në asnjë mënyrë përmbajtjen e përgjigjes në padi nga pala kundërshtare.

Seanca përgatitore. Nëse gjyqtari, pas shqyrtimit të kërkesëpadisë së paditësit dhe përgjigjes së të padituri, vendos se ekziston një kontest që kërkon gjykim, gjyqtari duhet "si rregull" të caktojë një seancë përgatitore brenda afatit prej 30 ditësh nga marrja e përgjigjes së të pandehurit, por duket se gjyqtarët kanë diskrecionin për të caktuar një seancë përgatitore për një kohë përtej afatit 30-ditor (me anë të një vendimi që cakton një datë specifike për seancën përgatitore që përmban një shpjegim të arsyeshëm për zgjatjen e afatit). Seanca përgatitore është e detyrueshme, përveçse në rastet kur gjykata konstaton se ndërmjet palëve nuk ka fakte kontestuese apo kur kontesti nuk është i ndërlikuar (neni 401 i LPK). Shkurt, një seancë përgatitore ka dy qëllime kryesore.

Së pari, gjyqtari duhet të përcaktojë rëndësinë dhe pranueshmërinë e provave të propozuara gjatë seancës përgatitore—domethënë nëse mbahet një e tillë (ose gjatë seancës kryesore nëse nuk mbahet seancë përgatitore)—dhe të nxjerrë një urdhër që, ndër të tjera, do të identifikojë cilat prova do të merren dhe cilët persona do të thirren si dëshmitarë në seancën kryesore. Për sa i përket lëndës në gjykim, pas seancës përgatitore, gjyqtari duhet të nxjerrë një urdhër (neni 420.1 i LPK) ku, ndër të tjera, cakton: (1) lëndën për shqyrtim gjatë seancës kryesore; (2) provat që do

të merren në seancën kryesore; dhe (3) personat që do të thirren si dëshmitarë në seancën kryesore. Kërkesa e një pale për dëshminë e ekspertit bëhet zakonisht gjatë seancës përgatitore (neni 407 i LPK) dhe, nëse kërkesa miratohet, gjyqtari bën emërimin dhe cakton një afat brenda të cilit eksperti duhet të paraqesë një mendim dhe konstatim me shkrim, duke pasur parasysh se palëve duhet t'u jepet parashtresa e ekspertit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të seancës së shqyrtimit kryesor (shih LPK neni 407).

Së dyti, gjyqtari do të vlerësojë në seancën përgatitore nëse ka mundësi për zgjidhjen e çështjes me ujdi pa gjykim. Nga njëra anë, gjyqtari do të përcaktojë në fillim të një seance përgatitore nëse palët kanë ardhur në seancë me një marrëveshje të ujdisë, e cila zakonisht do ta kufizonte fushëveprimin e seancës në shqyrtimin dhe miratimin e marrëveshjes së ujdisë nga gjyqtari. Nga ana tjetër, palët që nuk vijnë në seancën përgatitore me marrëveshje për ujdi mund të marrin parasysh zgjidhjen me ujdi në fund të seancës, sepse pasojat natyrore të diskutimit të gjyqtarit për meritat relative të padisë dhe mbrojtjes, si dhe diskutimi i shpenzimeve të procesit gjyqësor, do të ishte një demonstrim i përfitimeve të zgjidhjes me ujdi. Seanca përgatitore ofron një mundësi të shkëlqyeshme për gjyqtarin që të përpiqet të lehtësojë zgjidhjen e çështjes përmes ujdisë, dhe gjyqtarët kanë diskrecionin për të këshilluar palët se si të arrijnë një ujdi nën rrethanat e çështjes. Praktikuesi i ndihmës juridike do të duhej të përfitojë nga kjo mundësi për të eksploruar mundësitë për zgjidhjen e çështjes me ujdi në favor të klientit. LPK pret që gjyqtarët të inkurajojnë palët që të zgjidhin kontestet gjatë gjithë procedurës, e sidomos në seancën përgatitore, me anë të një ujdie të përshtatshme dhe korrekte gjyqësore (neni 431.1 i LPK). Dhe, në rrethana të përshtatshme, gjyqtarët kanë diskrecionin për t'u rekomanduar palëve gjatë seancës përgatitore që të përpiqen ta zgjidhin kontestin nëpërmjet ndërmjetësimit (neni 411.1 i LPK). Nëse gjyqtari e miraton (neni 3.3), zgjidhja e çështjes do të rezultonte në nxjerrjen e një **aktgjykimi me pëlqim**, me çka pushon padia (neni 391.1e i LPK).

Ndërmjetësimi: Ndërmjetësimi është gjerësisht i disponueshëm si një alternativë ndaj gjykimit dhe do të duhej të merret parasysh nga praktikuesi i ndihmës juridike në të gjitha rastet e përshtatshme ku mund të jetë në interesin më të mirë të përfituesit që të shkojë në ndërmjetësim. Dispozitat e Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësimin mund të zbatohen në procedurat kontestimore në çështjet pasurore, tregtare, familjare, të punës, dhe rastet tjera të kontesteve nga e drejta pronësore, siç janë të drejtat që kanë të bëjnë me fitimin e të drejtave pronësore përmes marrëdhënieve kontraktuese apo të fituara përmes trashëgimisë, procedurat e falimentimit, dhe raporte të tjera civile, administrative dhe penale. (neni 2.1 i LN). Ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet gjithatshtu, me përjashtime të caktuara, në rastet ku parashihet dënimi me burgim deri në tre vjet (neni 2.2 i LN).

Do të duhej të theksohet gjithashtu se disa lloje të procedimeve i nënshtrohen ndërmjetësimit të detyrueshëm përpara se të procedohen për gjykim në gjykatën civile. Këto përfshijnë, sipas nenit 9 të LN, kontestet nga marrëdhëniet familjare (si alimentacioni, kujdestaria, vizitat me fëmijët, mbajtja e fëmijëve dhe ndarja e pronës së përbashkët bashkëshortore) si dhe të drejtat e servituteve dhe kompensimi i pronës së shpronësuar. Seksioni 3 tek standardi 13 më poshtë diskuton rolet e mundshme të praktikuesit të ndihmës juridike në lidhje me procesin e ndërmjetësimit dhe marrjen e vendimit në lidhje me praninë e praktikuesit të ndihmës juridike në ndërmjetësim.

Është e mundur që mospjesëmarrja e një pale në seancën përgatitore pas marrjes së njoftimit të rregullt mund të çojë në një zgjidhje të kërkesëpadisë pa gjykim. Nëse i pandehuri nuk paraqet prapësim, gjyqtari duhet ta konsiderojë mosardhjen e paditësit të thirrur në mënyrë të rregullt në seancën përgatitore si tërheqje të padisë (neni 409.1 i LPK). Gjyqtari mund të mbajë një seancë përgatitore në mungesë të të pandehurit të thirrur në mënyrë të rregullt dhe pastaj të nxjerrë një aktgjykim mosveprimi kundër të pandehurit nëse faktet e paraqitura nga paditësi e mbështesin mjaftueshëm kërkesëpadinë – neni. 151.1 i LPK), përveç nëse ndalohet me ligj. Përkundër mungesës së një të pandehuri të thirrur në mënyrë të rregullt, gjyqtari mund të hedhë poshtë kërkesëpadinë nëse gjyqtari konstaton se provat e propozuara nga paditësi (edhe pas një mundësie për të korrigjuar problemin) nuk e mbështesin kërkesëpadinë (neni 151.4 i LPK).

Gjykimi (seanca kryesore). Si rregull, gjyqtari duhet ta mbajë seancën e shqyrtimit kryesor brenda afatit prej 30 ditësh nga përfundimi i seancës përgatitore (neni 420.2 i LPK), edhe pse gjyqtari ka diskrecionin që seancën e shqyrtimit kryesor ta mbajë menjëherë pas seancës përgatitore (neni. 420.3 i LPK), megjithëse kjo nuk ndodh shumë në praktikë.

Gjykimi përfshin mbikëqyrjen e gjyqtarit të paraqitjes efikase të palëve (d.m.th. përmes dëshmisë) dhe/ose paraqitjes së provave të pranueshme dhe të rëndësishme, në mënyrë që gjyqtari të mund të nxjerrë konstatime rreth fakteve që janë thelbësore për zgjidhjen e kërkesëpadisë. Në kryerjen e këtij funksioni, gjyqtari mbështetet në dëshminë e dëshmitarëve, dëshminë e ekspertëve, dokumentet e vërtetuara, provat materiale dhe/ose informacionin e marrë gjatë këqyrjeve gjyqësore.

Aktgjykimi me shkrim. Zbatimi i ligjit përkatës për faktet materiale nga ana e gjyqtarit, që shpesh përfshin harmonizimin e provave kundërthënëse dhe zgjidhjen e çështjeve të besueshmërisë, në një aktgjykim me shkrim që zgjidh kërkesëpadinë dhe jep arsyetimin për konstatimet e gjyqtarit. Aktgjykimi duhet të nxirret brenda afatit prej 15 ditësh nga përfundimi i gjykimit (neni 153.1 i LPK), dhe gjyqtari duhet të raportojë çdo mosrespektim të afatit, si dhe arsyet përkatëse, te Kryetari i Gjykatës (neni 153.2 i LPK).

Grafiku në vijim tregon rrjedhën e përgjithshme të lëndëve në gjykatë përgjatë procedurave kontestimore civile sipas LPK, me grafikët e rrjedhës të bashkëngjitur si grafikët 1, 2 dhe 3, duke treguar më shumë detaje thelbësore se si funksionon kjo rrjedhë e lëndëve. Ka rëndësi kritike që praktikuesi i ndihmës juridike, qoftë përfaqësues i ANJF apo avokat i kontraktuar privat, të kuptojë plotësisht këto rrjedha të lëndëve për të mbrojtur interesat e klientit të tij/ saj.

Paraqitja e kërkesëpadisë në gjykatë
Caktimi i gjyqtarit të rastit
Shqyrtimi fillestar i kërkesëpadisë nga gjyqtari dhe urdhrat përkatës të gjykatës
Korrigjimi i kërkesëpadisë së mangët
Njoftimi me kohë për të pandehurin
Emërimi i përfaqësuesit të përkohshëm ose përfaqësuesit ligjor (nëse është e përshtatshme)
Paraqitja ose mosparaqitja e përgjigjes ndaj kërkesëpadisë dhe korrigjimi i mangësive nga i pandehuri
Shqyrtimi paraprak i kërkesëpadisë dhe përgjigja e të pandehurit dhe urdhrat përkatës të gjykatës
Hedhja ose tërheqja e kërkesëpadisë (nëse është e përshtatshme)
Aktgjykimi i drejtpërdrejtë (nëse është e përshtatshëm)
Urdhri gjyqësor mbi kërkesën për ruajtje të pronës së kontestuar (nëse është e përshtatshme)
Seanca përgatitore (nëse është e përshtatshme) dhe urdhrat përkatës të gjykatës
Përpjekjet për zgjidhje alternative të kontestit
Zgjidhja e kontestit me ujdi (nëse është e përshtatshme)
Nxjerrja e urdhrit për caktimin e datës për gjykim me aktvendimet e provave
Thirrja e seancës gjyqësore
Zgjidhja e kontestit pa gjykim (nëse është e përshtatshme)
Nxjerrja e aktgjykimit të zgjidhjes së plotë ose të pjesshme
Nxjerrja e aktgjykimit të korrigjuar ose plotësues (nëse është e përshtatshme)
Zgjidhja e një ankimi (nëse paraqitet)

USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Contract Law Enforcement (CLE) Program
Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE)
Program za izvršenje i privredno zakonodavstvo (CLE)

Hapat e procedurës kontestimore sipas Ligjit nr. 03/L-006



Marrja e vendimit
Fillimi ose përfundimi i procedurës
Dokument në procedurë
Afat në procedurë
Hapat kryesorë
Informata lidhur me procedurën
Tregues i hapave
Tregues i hapave kthyes

Hequr e përgjegjësisë:

Kjo hartë procesuese është përgatitur nga Programi i USAID-it për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE), implementuar nga Checchi and Company Consulting, Inc., dhe përmbajtja e këtij dokumenti nuk pasqyron domosdo qëndrimet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) apo Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Kjo hartë nuk është parashikuar të ju ofrojë ndihmë ligjore. Për ndihmë ligjore ose pyetje specifike lidhur me Ligjin mbi procedurën kontestimore, ju lutem konsultoni avokatin.

c. Çështjet e provave dhe hartimi i kërkesëpadisë (padisë) në procedurat kontestimore sipas të drejtës civile:

Parashtrimi dhe vërtetimi i fakteve materiale duke përdorur prova të pranueshme janë disa nga funksionet kryesore të avokatit ndërgjyqës në çështjet civile, dhe si të tilla, do të trajtohen në hollësi në këtë Manual.

Hartimi i kërkesëpadisë: Siç u tha më lart, edhe kërkesëpadia edhe përgjigjja janë jashtëzakonisht të rëndësishme sipas LPK dhe, në fakt, mund të përbëjnë bazën e zgjidhjes përfundimtare të çështjes pa gjykim, varësisht nga përmbajtja e tyre. Së këndejmi, hartimi i kërkesëpadisë duhet të merret seriozisht dhe do të duhej të bëhet vetëm, siç sugjerohet në Standardin 9 më lart, pas kryerjes së një hetimi të plotë të fakteve të paraqitura nga paditësi, për aq sa është e mundur sipas rrethanave.

Barra e provës: Në lidhje me **barrën e provës,** nxjerrja e provave në gjykim, sipas LPK, i takon ekskluzivisht palëve ndërgjyqëse, dhe në veçanti paditësit që përpiqet të provojë kërkesëpadinë e tij. Ndryshe nga sa besojnë shumë, nuk është përgjegjësi ligjore e gjyqtarit të mbledhë prova. Një praktikues i ndihmës juridike nuk mund të rrijë duarkryq dhe të supozojë se gjyqtari do të mbledhë në mënyrë proaktive prova nga ekspertët dhe prova të tjera për të vërtetuar rastin e përfituesit të tij/saj. Neni 7, paragrafi 1 parashikon se " Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla." Nëse gjykatës nuk i ofrohen të gjitha provat e nevojshme që vërtetojnë faktet, gjykata nuk do të ketë mundësi që t'i mbledhë dhe t'i ekzaminojë ato prova dhe të nxjerrë aktvendim. Së këndejmi, është me rëndësi kritike për një avokat që të hetojë plotësisht të gjitha aspektet e çështjes dhe të paraprijë dhe të diskreditojë argumentet që pala kundërshtare ka të ngjarë të nxjerrë, si në parashtresa ashtu edhe në gjykim.

Llojet e provave: Provat mund të klasifikohen në dy grupe, prova "thelbësore" dhe "të rastësishme". **Prova thelbësore** janë ato që merren nga burime origjinale, si dëshmitarë okularë, dokumente origjinale ose zyrtare, etj. **Provat e rastësishme** janë ato që merren nga burime anësore ose rrethanore, siç janë dëshmitë e dëshmitarëve palë të treta, të cilët mund të mos e kenë parë vetë ngjarjen, por e kanë dëgjuar nga të tjerët. Ndërsa këto prova "thashetheme" nuk lejohen në disa juridiksione (si në Shtetet e Bashkuara dhe juridiksione të tjera të së drejtës zakonore me disa përjashtime), ato lejohen në Kosovë, por kanë shumë më pak vlerë provuese sesa provat thelbësore dhe gjatë gjykimit ose seancave, dhe praktikuesi i ndihmës juridike do të duhej ta bëjë këtë dallim në mënyrë të qartë.

Në lidhje me një fakt të caktuar, provat mund të klasifikohen si "direkte" ose "indirekte". **Prova direkte** është ajo provë që shërben si mjet për të vërtetuar drejtpërdrejt një fakt specifik, siç janë dëshmitë e dëshmitarëve të pranishëm kur paditësi ia dorëzoi të padituri një send të caktuar. Nga ana tjetër, **prova indirekte** është e lidhur tërthorazi me një fakt të caktuar, ose përdoret për të nxjerrë një konstatim të supozuar në lidhje me ekzistencën e një fakti të caktuar. Një fakt indirekt mund të jetë, për shembull, kur një kreditor i paraqet debitorit një vërtetim me shkrim të një borxhi të paguar dhe gjykata e pranon atë si provë për të vërtetuar pagesën.

Një "dëshmitar" është një person ligjërisht i ndryshëm nga palët ndërgjyqëse, dhe një dëshmitar është i detyruar vetëm të dëshmojë qartë dhe sinqerisht për njohuritë e tij/saj për kontestin në gjyq, dhe për këtë arsye me një deklaratë të tillë, ai/ajo mund të ndihmojë në adresimin ligjor të

kontestit. Dëshmitari kufizohet vetëm në perceptimet e tij shqisore, duke u përmbajtur nga shprehja e një mendimi për faktin e perceptuar.

d. Përdorimi i ekspertëve si burim i provave gjatë ose përpara gjykimit

Për të sqaruar ose vërtetuar një fakt, shpesh është e nevojshme të përfshihen individë me aftësi ose njohuri profesionale që nuk zotërohen nga Gjykata, dhe për këtë arsye, Gjykata mund të urdhërojë marrjen e provave në gjykim me "ekspertizë". "Ekspertë" janë personat me njohuri specifike dhe të mjaftueshme në një fushë të caktuar të njohurive dhe të cilët në bazë të njohurive të tilla janë në gjendje të ofrojnë para gjykatës një përshkrim të vërtetë të një gjendjeje faktike ose të arrijnë në një konstatim të saktë të rezultateve të gjendjes faktike në fjalë. Nga ana tjetër, procesi i studimit të objekteve që u vihen në dispozicion ekspertëve për të shprehur një mendim për problemet që kërkojnë njohuri ose përvojë të veçantë, me caktimin e gjykatës, quhet "ekspertizë".

Dhënia e një "ekspertize" është një aktivitet i përmbledhjes së evidences provuese për të vërtetuar faktet kontestuese dhe në përgjithësi ndërmerret nga një ekspert i angazhuar nga vetë gjykata (nëpërmjet një aktvendimi), dhe rezulton në një mendim të paraqitur nga eksperti në gjykata. Ligji për Procedurën Kontestimore, në nenet 356 – 372, ofron orientim për vërtetimin e fakteve me anën e ekspertizës, ku ekspertët japin mendimet dhe konstatimet e tyre në ekspertizën e tyre.

Konstatimin dhe mendimin e tij me shkrim eksperti ia dorëzon gjykatës para së të fillojë seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes, përveç nëse gjykata vendosë ndryshe. Mendimi i ekspertit gjithmonë duhet të jetë i arsyetuar (neni 364.1, 2 i LPK). Pala kundërshtare mund t'i bëjë pyetje ekspertit gjatë seancës kryesore për të sfiduar besueshmërinë e dëshmitarit dhe "ekspertizën" e tij ose saj. Praktikat më të mira ndërkombëtare i lejojnë palët të sfidojnë si kualifikimet e ekspertit ashtu edhe mjetet apo teoritë që eksperti përdori për të arritur te mendimi i tij/saj. Sfidat e bazuara te kualifikimet mund të përfshijnë arsimin, trajnimin e specializuar, vitet e përvojës ose njohuritë. Sfidat e bazuara në mjetet për të arritur te mendimi mund të përfshijnë:

1. Nëse mendimi bazohet në fakte ose të dhëna të mjaftueshme;
2. Nëse janë përdorur parime dhe metoda të besueshme në nxjerrjen e mendimit; dhe
3. Nëse parimet dhe metodat janë zbatuar në një mënyrë që është e besueshme në rastin në fjalë.
4. Nëse teoria është testuar dhe mund të testohet;
5. Nëse metoda ka kaluar shqyrtimin rigoroz nga recensentët dhe është publikuar;
6. Norma e gabimit, nëse dihet, ose norma e mundshme e gabimit, të mjeteve;
7. Standardet që ekzistojnë për metodën, si dhe respektimi i standardeve gjatë testimit në fjalë; dhe
8. Nëse për mjetet në fjalë ka një pranim të gjerë në komunitetin shkencor.

Neni 360 parasheh që eksperti mund të "përjashtohet" nga çështja për shkaqe të bazuara (d.m.th., sfidat e mësipërme mund të përdoren për të diskredituar ekspertët), por kjo duhet të bëhet para seancës kryesore me propozimin e palës kundërshtuese të ekspertit. Të dyja palët do të duhej të marrin një kopje të mendimit me shkrim të ekspertit së paku tetë (8) ditë para seancës kryesore (neni 367 i LPK).

Palët mund të marrin në pyetje ekspertin gjatë seancës kryesore (neni 371 i LPK), sipas rregullave të nenit 348 të LPK-së. Praktikat më të mira ndërkombëtare (veçanërisht në vendet e së drejtës zakonore) janë të kufizohet marrja në pyetje (pra marrja në pyetje e tërthortë) e dëshmitarëve kundër klientit vetëm te pyetjet e mbyllura (pra pyetje me përgjigje po ose jo) dhe të mos i bëhen pyetje dëshmitarit nëse avokati nuk e di tashmë përgjigjen, duke shmangur kështu befasitë në seancën kryesore. Për ta bërë këtë, praktikuesi i ndihmës juridike që kërkon të sfidojë një dëshmitar ekspert duhet të bëjë një hetim të plotë pasi të merret mendimi i ekspertit me shkrim, që mund të përfshijë konsultimin me ekspertë të tjerë për çështje të ndërlikuara. Nëse pala që kundërshton dëshminë e ekspertit mund të nxjerrë një argument mjaft të fortë kundër dëshmitarit ose mjetit, mund të jetë strategjikisht e dobishme të bëhet një mocion i nenit 360 për përjashtimin, pasi kjo mund të lehtësojë diskutimet e zgjidhjes, gjë që ndoshta nuk do të ishte rasti nëse dëshmitari sfidohet gjatë marrjes në pyetje gjatë seancës kryesore.

Së fundi, është e rëndësishme të theksohet se nëse paditësi mendon ose konstaton se ekspertiza është joprofesionale ose jo e bazuar në argumente profesionale, paditësi ose ndonjëra nga palët mund të propozojë nxjerrjen e provave me "superekspertizë" (dmth. komisioni i tre ekspertëve të kualifikuar profesionalisht në fushën në të cilën kërkohet ekspertiza lëshohet për të hetuar dhe për të dhënë mendim në gjykatë) sipas LPK.

e. Dëshmia e palëve gjatë seancës kryesore (gjykimit)

Gjithashtu, palët ndërgjyqëse, përkatësisht kërkuesi ose paditësi dhe i padituri mund të paraqiten si mjete provuese duke dëshmuar në gjykim në një procedurë kontestimore.

Ndërgjyqësit janë shpesh burimi kryesor dhe më i sigurt i njohurive për faktet e rëndësishme të çështjes në shqyrtim. Palët e dinë më së miri gjendjen faktike mbi të cilën i mbështesin kërkesat e tyre. Palët kujtojnë ngjarjet, ndodhitë, gjendjen e sendit ose të njerëzve, të rëndësishme për krijimin dhe zhvillimin e një marrëdhënieje civile.

Me nenin 373 të LPK të ri, dëshmia e palëve si mjet provues është vënë në të njëjtin nivel me mjetet e tjera provuese, prandaj ajo mund të përdoret si mjet provues në çdo kohë, si dhe për të vërtetuar çdo fakt. Për dallim nga ligji i vjetër, i cili parashikonte se marrja e provave nga dëgjimi i palëve lihej për në fund të procedurës, ligji i ri, në nenin 425, paragrafi 1, parashikon se procedura provuese fillon pikërisht me dëgjimin e deklaratave të palëve.

Është e rëndësishme të përmendet se edhe me paraqitjen e përgjigjes ndaj padisë, paditësi mëson qëndrimin e palës së paditur për kërkesëpadinë dhe padinë, e cila gjithashtu i ofron paditësit një mundësi për të sqaruar ose plotësuar pretendimet e tij apo edhe për të përgatitur prova të tjera eventuale në formë të propozimeve, gjatë seancës përgatitore ose seancës kryesore, nëse nuk është mbajtur seanca e tillë përgatitore. Kjo i mundëson gjykatës që shpejt dhe me efikasitet të udhëheqë procedurën drejt mbajtjes dhe zhvillimit të seancës përgatitore.

Paraqitja e përgjigjes në kërkesëpadi është një moment kyç në procedurën kontestimore, sepse i padituri shtjellon pikëpamjet e tij/saj për çështjen kontestuese dhe gjyqtari në fakt mund ta zgjidhë çështjen vetëm në bazë të parashtresave (p.sh. kërkesëpadisë dhe përgjigjes).

f. Roli i praktikuesit të ndihmës juridike në procedurat e ndërmjetësimit të përfituesit

LN nuk ndalon praninë e një avokati në procedurën e ndërmjetësimit për të ndihmuar klientin e tij/saj. Së këndejmi, klientët mund të kenë avokatët e tyre të pranishëm, sipas nevojës. Në përgjithësi, roli i avokatit në ndërmjetësim është të ndihmojë klientët, të ofrojë këshilla praktike dhe ligjore mbi procesin dhe për çështjet e ngritura dhe ofertat e bëra, dhe të ndihmojë në hartimin e rregullave dhe kushteve të ujdisë siç është rënë dakord. Mirëpo, roli i avokatit do të ndryshojë shumë në varësi nga natyra e kontestit dhe procesi i ndërmjetësimit.

Së këndejmi, një palë që përcaktohet të zgjidhë një kontest nëpërmjet ndërmjetësimit mund të përfaqësohet ose mund të mos përfaqësohet nga një avokat në çdo moment të procesit. Sipas përcaktimit të palës, për shembull, një palë mund:

1. Të përfaqësohet nga një avokat që nga momenti i paraqitjes së parashtresës së parë të palës;
2. Të hyjë në procedim e papërfaqësuar dhe të sigurojë përfaqësim në një moment të mëvonshëm gjatë procedimit ose gjatë procesit të ndërmjetësimit;
3. Të përfundojë procesin e ndërmjetësimit dhe të konsultohet me një avokat vetëm për të shqyrtuar kushtet e marrëveshjes së ndërmjetësuar; ose
4. Të përfundojë procesin e ndërmjetësimit dhe të lidhë një marrëveshje pa ndihmën e një avokati.

Roli tradicional i avokatit në Kosovë ka qenë të përfaqësojë interesat e klientit të tij ose të saj, duke e këshilluar përfituesin lidhur me procedurën dhe të drejtën materiale, duke këshilluar klientin dhe duke menaxhuar procesin ligjor për klientin. Ndërsa avokati do të vazhdojë të kryejë secilin prej këtyre funksioneve tradicionale edhe në procesin e ndërmjetësimit, mënyra dhe konteksti në të cilin kryhen këto funksione do të jenë të ndryshme. Dallimi jetik është se ndërmjetësimi është një *proces jo-akuzator*, nëpërmjet të cilit secila palë inkurajohet të marrë përgjegjësinë për zgjidhjen e kontestit.

Rolet e ndryshme që një avokat mund të marrë në ndërmjetësim përpara ndërmjetësimit: Duke ndihmuar palën në marrjen e vendimeve të informuara për procesin e ndërmjetësimit përpara fillimit të procesit, avokati inkurajon palën të marrë përgjegjësinë për zgjidhjen e kontestit, gjë që është shumë në përputhje me parimet e përgjithshme të ndërmjetësimit.

Avokati i shpjegon palës natyrën e procesit të ndërmjetësimit, çfarë duhet pritur gjatë ndërmjetësimit, ligjin përkatës që rregullon procesin e ndërmjetësimit dhe si procesi i ndërmjetësimit plotëson procedurat gjyqësore. Avokati e ndihmon palën të zgjedhë ndërmjetësuesin në mënyrë të informuar bazuar në faktorë të tillë si natyra e çështjes së palës, prapavija dhe përvoja e ndërmjetësuesit dhe tarifat e mundshme të përfshira. Avokati mund të shqyrtojë me palën listat dhe profilet e ndërmjetësuesve të certifikuar që gjenden në regjistrin e ndërmjetësuesve të licencuar nga Ministria e Drejtësisë.

Avokati ndihmon palën të përcaktojë nëse koha është një faktor në zgjedhjen e ndërmjetësimit. Për shembull, avokati mund të rekomandojë ndërmjetësimin në fillim të çështjes për të eksploruar

ujdinë përpara se të betonohen pozicionet, ose mund të rekomandojë që ndërmjetësimi të shtyhet deri në përfundimin e të gjithë ose një pjese të procesit të zbulimit.

Avokati këshillon palën mbi të drejtën materiale që zbatohet për çështjen në fjalë. Kjo i mundëson palës të kuptojë gamën e rezultateve që janë të mundshme nëse çështja zgjidhet me ndërgjyqësi dhe të formulojë një sërë rezultatesh të pranueshme për procesin e ndërmjetësimit. Për shembull, në një rast lëndimi personal, avokati mund të këshillojë palën për gamën e rezultateve në lidhje me përgjegjësinë, gamën e mundësive për një aktgjykim që urdhëron pagesë parash, si dhe opsione të tilla si shlyerjet e strukturuara. Këshillat që e ndihmojnë palën të kuptojë se mund të ketë më shumë se një zgjidhje që plotëson nevojat e asaj pale, e ndihmon palën të hyjë në ndërmjetësim duke qenë e gatshme të shqyrtojë opsione të ndryshme për ujdi.

Gjatë ndërmjetësimit: Ashtu si përpara fillimit të procesit, avokati vazhdon të këshillojë palën mbi të drejtën materiale që zbatohet për çështjen, duke e ndihmuar palën të kuptojë se çfarë informacioni mund të jetë i rëndësishëm për t'u ndarë ose për t'u mësuar gjatë ndërmjetësimit, opsionet që mund të jenë në dispozicion, pasojat e mundshme për secilin opsion, dhe rezultatet e mundshme për t'u parapritur nëse marrëveshja nuk arrihet nëpërmjet ndërmjetësimit.

Gjatë gjithë procesit të ndërmjetësimit, palët inkurajohen të marrin përgjegjësinë për zgjidhjen e kontestit. Kjo përgjegjësi përfshin pjesëmarrjen aktive në diskutimet për zgjidhjen e problemeve me ndihmën e një ndërmjetësuesi neutral dhe të trajnuar. Roli i avokatit është të ndihmojë palën që të negociojë vetë, duke pasur parasysh natyrën jo-akuzatore të ndërmjetësimit.

Avokati e udhëzon palën në negociata duke e inkurajuar palën të shprehë mendimet dhe ndjenjat, duke ndihmuar palën të përkufizojë interesat dhe duke ndihmuar palën të mbledhë informacionin e nevojshëm, të krijojë opsione dhe të shqyrtojë pasojat.

Avokati mund ta orientojë palën nëpër diskutimet drejt ujdisë pavarësisht nëse avokati merr pjesë në seancat e ndërmjetësimit apo jo. Avokati mund të konsultohet me palën dhe të këshillojë palën para dhe pas seancës(ave). Avokati mund të këshillojë gjithashtu palën se kur do të ishte e mençur të kërkojë një ndërprerje të ndërmjetësimit për t'u konsultuar me avokatin për informacione dhe këshilla shtesë. Në disa raste, pala dhe avokati mund të organizojnë që avokati të jetë i disponueshëm përmes telefonit për konsultim gjatë zhvillimit të ndërmjetësimit.

Avokati menaxhon procesin ligjor për palën gjatë ndërmjetësimit, duke e mbajtur palën të informuar për data të rëndësishme, duke iu përgjigjur dhe duke dorëzuar parashtresat e nevojshme dhe duke kryer zbulimin.

Zgjedhja nëse avokati merr pjesë në seancë(a), si dhe shkalla e pjesëmarrjes së avokatit, në fund të fundit i takon palës. Pala e bën zgjedhjen e saj pas diskutimit me avokatin dhe pas shqyrtimit të këshillës së avokatit. Për shkak se suksesi i procesit të ndërmjetësimit varet, ndër të tjera, nga marrja e vendimeve të informuara nga secila palë për zgjidhjen e kontestit, detyra e avokatit në këtë fazë është t'i mundësojë palës të marrë një vendim të informuar për këto çështje.

*Faktorët që ndikojnë në vendimin për pjesëmarrjen e avokatit***:** Meqenëse asgjë në lidhje me vetë procesin e ndërmjetësimit nuk sugjeron që një avokat *duhet* të marrë pjesë në seancat e ndërmjetësimit, vendimi varet kryesisht nga nevojat e palës brenda kontekstit të procesit të

ndërmjetësimit. Ndërsa disa persona përpiqen të përgjithësojnë rolin e avokatëve sipas llojit të çështjes (p.sh., "Ju keni nevojë për një avokat në një ndërmjetësim të dëmtimit personal, por jo në një ndërmjetësim për çështje familjare."), nevojat e palëve (si p.sh. informacioni, burimet dhe fuqia reale dhe e perceptuar negociuese e secilit) janë ato që do të duhej të nxisin vendimin për të pasur një avokat të pranishëm në ndërmjetësim, dhe jo lloji i çështjes.

Për shkak se ndërmjetësimi është një proces bashkëpunues i zgjidhjes së problemeve në të cilin ndërmjetësuesi lehtëson komunikimin ndërmjet palëve, konsiderata themelore është nëse pala është e aftë të marrë pjesë në proces në mënyrë efektive pa praninë e avokatit. Ky shqyrtim përfshin dy nivele të veçanta të hetimit: nëse një palë ka ndonjë pengesë personale për komunikimin efektiv dhe nëse natyra e marrëdhënies ndërmjet palëve pengon komunikimin efektiv.

Nëse pala mund të marrë pjesë dhe të komunikojë në mënyrë efektive në procesin e ndërmjetësimit pa praninë e avokatit të tij ose saj, avokati nuk ka nevojë medoemos të marrë pjesë në ndërmjetësim. Nëse rrethanat janë të tilla që pala nuk mund të marrë pjesë në proces mënyrë efektive pa praninë e avokatit, pavarësisht nga udhëzimet e ndërmjetësuesit, sigurisht që do të ishte në interesin më të mirë të palës që avokati i tij ose saj të merrte pjesë në seancën(at) e ndërmjetësimit.

Niveli i dytë i hetimit për të përcaktuar nëse pala mund të marrë pjesë në mënyrë efektive në procesin e ndërmjetësimit pa praninë e avokatit të tij ose saj fokusohet në marrëdhëniet ndërmjet palëve. Ky hetim mund të përshtatet si një pyetje e "ekuilibrit të fuqisë": a ka secila palë në këtë marrëdhënie fuqi të krahasueshme në mënyrë të arsyeshme për t'u përfshirë në mënyrë efektive në procesin e zgjidhjes së problemeve? Nëse jo, prania e një avokati do të ishte më e rëndësishme.

g. Këshilla praktike në lidhje me parashtresat dhe ndërgjyqësinë në llojet e veçanta të çështjeve familjare, civile dhe pasurore

1. Rastet e besimit të kujdestarisë së fëmijëve

Çështjet strategjike që duhen marrë parasysh në rastet e kujdestarisë së fëmijëve: Kur zhvillohet një strategji për ndërgjyqësi (teori e rastit), praktikuesi i ndihmës juridike do të duhej të ndihmojë klientin e tij/saj të mbledhë prova që janë të rëndësishme për "faktorët e kujdestarisë" të renditur më poshtë (që janë shqetësime të zakonshme të gjyqtarëve në çështjet familjare) dhe që në mënyrë efektive mbështesin parashtresat tuaja. Disa prova mund dhe do të duhej të bashkëngjiten (ose të paktën të referohen shprehimisht) në parashtresa.

- Interesi i prindërve dhe përfshirja aktive në rritjen e fëmijës(ve);
- Orari aktual i kujdestarisë fizike;
- Situata dhe standardet e jetesës, duke përfshirë kohën e lirë dhe rregullimet e kujdesit ndaj fëmijëve;
- Gatishmëria për bashkëprindërim;
- Paqëndrueshmëria mendore/emocionale;
- Prova për dhunë në familje në marrëdhënie ose çfarëdo dhunë ndaj fëmijës(ve);
- Abuzimi me substanca (drogë ose alkool); dhe

- Çdo provë e lënies pas dore të fëmijës(ve) në të kaluarën.

Është e domosdoshme të filloni mbledhjen e provave sa më herët që të jetë e mundur përpara se mundësitë të humbasin dhe ngjarjet të harrohen. Klienti do të duhej të fillojë të mbajë një ditar çdo ditë, duke dokumentuar përfshirjen e tij ose saj dhe aktivitetet e përditshme me fëmijën e tyre dhe çdo rast apo sjellje të shfaqur nga prindi tjetër.

Dokumentet e nevojshme për rastet e mbajtjes së fëmijëve

- Certifikata e kurorëzimit
- Certifikatat e lindjes së fëmijës(ve)
- Testet e atësisë nëse është në pyetje atësia
- Informacione mbi të ardhurat për të dyja palët
- Dokumentacioni i borxheve të papaguara
- Në rast të dhunës në familje, raportet policore dhe mjekësore
- Dokumentacioni për çdo nevojë të veçantë të fëmijëve dhe kostot përkatëse
- Dokumentacioni për çdo sfidë fizike të prindërve
- Dokumente të tjera relevante që lidhen me kujdestarinë e fëmijës dhe interesin më të mirë të fëmijës(ve).

Llojet e provave në procedimet kontestimore të kujdestarisë së fëmijëve: Që provat të konsiderohen të pranueshme nga gjykata civile, ato duhet të jenë materiale dhe relevante. Nëse provat nuk kanë të bëjnë me kujdestarinë, "interesat më të mira" ose mirëqenien e fëmijës, ato nuk janë relevante.

Mbajtja e kopjeve të komunikimeve dhe korrespondencës me prindin tjetër ka rëndësi vendimtare për një klient. Llojet më të zakonshme të provave të ofruara në një rast të kujdestarisë së fëmijëve përfshijnë: dëshmitarët (si dëshmitarë okularë ashtu edhe ekspertë); ditarët; emailet; mesazhe me tekst; posta zanore; letra; fotografi; video; regjistrime audio; oraret e vizitave dhe të tjera; dhe të dhëna të tilla si raporte financiare, mjekësore, shkollore dhe policore. Klienti, me ndihmën e përfaqësuesit/avokatit të ndihmës juridike do të duhej të mbledhë, dokumentojë dhe depozitojë me vëmendje këtë informacion në momentin që klienti fillon të ketë shqetësime se kujdestaria e fëmijës do të mund të kontestohej.

Dokumentet e nevojshme për rastet e kujdestarisë së fëmijëve

- Certifikata e kurorëzimit
- Certifikatat e lindjes së fëmijëve
- Informacione mbi të ardhurat për të dyja palët
- Në rast të dhunës në familje, raportet policore dhe mjekësore
- Dokumentacioni për çdo nevojë të veçantë të fëmijëve
- Dokumentacioni për çdo sfidë fizike ose mendore të prindërve
- Dokumente të tjera relevante që lidhen me kujdestarinë e fëmijës dhe interesin më të mirë të fëmijës(ve).

Dëshmitarët nën betim: Dëshmia e dëshmitarit mund të ndihmojë gjykatën në përcaktimin e legjitimitetit të kërkesave dhe pretendimeve në një rast për kujdestarinë e fëmijëve. Dëshmitë më me ndikim vijnë nga dëshmitarë të paanshëm që kanë njohuri personale ose eksperte si për fëmijën ashtu edhe për prindërit. Një listë e dëshmitarëve të mundshëm do të përfshinte ofruesit e kujdesit ditor, mësimdhënësit, punëtorët shëndetësorë, bashkëpunëtorët ose fqinjët. Sa më të paanshëm të jenë dëshmitarët, aq më shumë ka gjasa që atyre t'u besojë gjykuesi i fakteve (gjyqtari).

Interesi më i mirë i fëmijës: Provat në rastet e kujdestarisë së fëmijës duhet të demonstrojnë se dhënia e kujdestarisë ndaj fëmijës klientit është në të vërtetë në "interesin më të mirë" të fëmijës. Kriteret që gjyqtarët e gjykatave civile përdorin zakonisht kur përcaktojnë një marrëveshje të përshtatshme kujdestarie zakonisht quhen "Faktorët e

Kujdestarisë". Faktorët e Kujdestarisë shprehin shqetësimet më të zakonshme të gjykatave civile në përcaktimin e çështjeve të kujdestarisë.

2. **Procedura për mbajtjen e fëmijës (ose mbajtjen financiare të fëmijës) –** Ligji për Familjen, nenet 289-296

Çështjet strategjike që duhen marrë parasysh në procedimet për mbajtjen e fëmijëve: Në rastet e procedurave për mbajtjen e fëmijëve (si në rastin e alimentacionit) është thelbësore që të merret informacion sa më shpejt që të jetë e mundur për të ardhurat dhe pasuritë e palës kundërshtare, pasi kjo bëhet më e vështirë pasi të fillojë një procedurë kontestimore.

Llojet e provave në procedimet për mbajtjen e fëmijëve: Provat në procedimet për mbajtjen e fëmijëve fokusohen gjerësisht në të ardhurat e prindërve, në mënyrë që të mund të përcaktohet shuma e mbajtjes së fëmijëve që duhet paguar për fëmijët e mitur (nën 15 vjeç).

3. **Procedimet e shkurorëzimit dhe alimentacionit –** Ligji për Familjen, nenent 68-69

Shkurorëzimi në Kosovë është relativisht i lehtë për t'u prokuruar, përveç rasteve kur ka fëmijë të përfshirë, dhe është i disponueshëm për arsye të ndryshme, duke përfshirë, ndër të tjera, "jetën e padurueshme të bashkëshortëve, tradhtinë bashkëshortore, atentatin kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimin e rëndë, Braktisja e paqëllimshme dhe e pajustifikueshme, sëmundje e pashërueshme mendore dhe paaftësia e vazhdueshme për të vepruar, ndërprerja e paarsyeshme e bashkëjetesës faktike për më shumë se një vit dhe divorci me marrëveshje të ndërsjellë." (FC Art. 69). Nëse bashkëshorti kundërshtues nuk i refuzon në mënyrë specifike arsyet e parashtruara në kërkesë, ai ose ajo konsiderohet se është në marrëveshje të ndërsjellë për divorcin. FC Art. 68.4. Divorci nuk është i disponueshëm sipas Kodit të Familjes nëse gruaja është shtatzënë (dhe derisa fëmija i përbashkët të jetë të paktën një vjeç). FC Art. 70. Kontestet martesore shqyrtohen nga trupi gjykues i përbërë nga një gjyqtar dhe tre gjyqtarë porotë. FC Art. 73, pas një përpjekjeje të detyrueshme për pajtim (para Organit të Kujdestarisë – d.m.th. përmes Qendrave për Punë Sociale ose QPS-ve) nëse ka fëmijë të përfshirë). FC Art. 76. Ndryshe nga shumë vende të tjera, gjykata mund të refuzojë një divorc nëse interesat e fëmijës(fëmijëve) në rrethana të jashtëzakonshme që kërkojnë që martesa të mos zgjidhet. FC Art. 70.3. Për të shmangur moslejimin e zgjidhjes së martesës, përfituesi duhet të tregojë një plan adekuat (mundësisht të përgatitur në koordinim me bashkëshortin që përfituesi kërkon të divorcohet) për t'u kujdesur për fëmijët pas zgjidhjes së martesës.

Çështjet strategjike dhe të tjera për t'u marrë parasysh në rastet e divorcit dhe alimentimit: Kur bashkëshortët që kërkojnë divorc kanë fëmijë të mitur, Ligji për Familjen parashikon që procedura e pajtimit të kryhet nga QPS-të, të cilat do të zbatojnë "punën sociale dhe metodat e tjera profesionale" dhe do të shfrytëzojë këshilltarët për martesën dhe familjen dhe të tjerë. QPS-ja do të vlerësojë "kushtet aktuale të jetesës dhe zhvillimit" të fëmijëve të mitur dhe do të "mbrojë interesat e fëmijëve" duke marrë "të gjitha masat e nevojshme" për të siguruar që "arsimimi, siguria dhe mirëmbajtja financiare" të merren parasysh siç duhet në çdo marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve. Procedurat e pajtimit të kryera nga QPS-të nuk duhet të zgjasin më shumë se tre

muaj, përveç nëse bashkëshortët pajtohen. QPS-ja "pa vonesë" i dorëzon gjykatës një raport me shkrim "për rezultatet e procedurave të pajtimit".

Në praktikë, QPS-ve, sipas OSBE-së, shpesh u duhen shumë më tepër se tre muaj për të kryer punën e tyre dhe mund të vonojnë ndjeshëm procedurat e divorcit, madje edhe ato të bazuara në marrëveshje të ndërsjellë. Si i tillë, është e rëndësishme që praktikuesi i ndihmës juridike të punojë ngushtë me QPS-të për t'u siguruar që procesi të shkojë pa probleme dhe me shpejtësi dhe që të gjitha takimet ose intervistat të caktohen dhe të marrin pjesë në kohë.

Provat: Gjykimet e shkurorëzimit dhe seancat e tjera gjyqësore kontestimore shpesh varen nga ajo se cili bashkëshort mund t'i ofrojë gjykatës provat më të mira për të mbështetur argumentet e tij ose të saj nëse mund të miratohet shkurorëzimi dhe nëse dhe sa alimentacion do të duhej të jepet.

Dokumentet e nevojshme për rastet e shkurorëzimit dhe alimentacionit (mbajtjes martesore).

- Certifikata e kurorëzimit ose prova (qira, fatura, etj.) e "bashkëjetesës së hapur" si çift
- Certifikatat e lindjes së fëmijës(ve)
- Informacione mbi të ardhurat për të dyja palët
- Dokumentacioni i borxheve të papaguara
- Dokumentet në lidhje me zotërimin e pronës (si familjare ashtu edhe jashtë familjes)
- Në rast të dhunës në familje, raportet policore dhe mjekësore
- Dokumente të tjera përkatëse në lidhje me shkurorëzimin dhe alimentacionin

- *Cili bashkëshort ka qenë kujdestari kryesor i fëmijës së tij/saj?*
- *Sa të ardhura ka fituar një bashkëshort gjatë vitit të kaluar?*
- *A ka marrë bashkëshorti një pronë të kontestuar para martesës?*

Këtu jepen pesë këshilla për përmirësimin e provave në një rast shkurorëzimi dhe çështjet e lidhura me alimentacionin:

Komunikimi me shkrim: Nëse diçka e rëndësishme duhet të thuhet ndërmjet klientit dhe bashkëshortit(es) gjatë një procedimi të kontestuar për shkurorëzim ose alimentacion, gjithçka do të duhej të bëhet dhe të ruhet me shkrim. Mesazhet me tekst dhe emailet ndërmjet bashkëshortëve janë prova jetike dhe shpesh përdoren gjatë gjykimeve të shkurorëzimit, veçanërisht kur bëhet fjalë për fëmijët. Edhe nëse bashkëshorti nuk dëshiron të komunikojë me shkrim, ruani përpjekjet tuaja të njëanshme për komunikim me shkrim me bashkëshortin.

Kalendarët: Datat dhe koha e ngjarjeve shpesh kontestohen në gjykim. Nëse klienti dhe bashkëshorti/ja e tij/saj kanë mbajtur një kalendar familjar përpara paraqitjes së kërkesës për shkurorëzim, sigurohuni që ai ruhet. Nëse jo, klienti do të duhej të fillojë mbajtjen e kalendarit të ngjarjeve të përditshme dhe shkëmbimeve të tjera të rëndësishme me bashkëshorten e tij/saj sa më shpejt të jetë e mundur gjatë procedimeve të shkurorëzimit. Ndërsa mban kalendarin, ai ose ajo do të duhej të sigurohet që shënon çdo kohë të humbur prindërore nga bashkëshorti

kundërshtar, çdo udhëtim pune të ndërmarrë nga bashkëshorti i tillë, ose çdo takim ose aktivitet të fëmijëve që klienti juaj ka lehtësuar.

Postimet në rrjetet sociale: Bashkëshortët shpesh pa dashje postojnë informacione të dëmshme në faqet e rrjeteve sociale, të cilat mund të përdoren si prova kundër tyre. Sigurohuni që klienti është në proces të shkurorëzimit, që ai ose ajo vlerëson me kujdes informacionin që postohet në rrjetet sociale. Ata do të duhej të lusin edhe miqtë e tyre që i vënë "tag" në postime që ta bëjnë këtë po ashtu. Për më tepër, një klient do të duhej të ruajë postimet e bashkëshortes së tij ose të saj në mediat sociale duke shtypur pamjet e ekranit të llogarive të tyre me datën përkatëse ose duke shkarkuar postimet e tyre (nëse faqja lejon).
Fotot: Një foto vlen sa një mijë fjalë. Fotografitë do të duhej të bëhen dhe të datohen me kujdes për të kataloguar pronën në shtëpinë e klientit tuaj ose për të evidentuar çdo dëm fizik të kryer ndaj klientit tuaj nga bashkëshorti/ja e tij/saj.

“Po” dhe “Jo” serioze të mesazheve me tekst që ia vlen të merren parasysh gjatë procesit të shkurorëzimit.

PO-të.....

Afati i parashkrimit/ periudhat parashkruese: Një afat i parashkrimit ose një periudhë parashkruese është një ligj që përcakton se sa kohë ka pala për të paraqitur një padi dhe shpesh mendohet dhe diskutohet si një lloj ore. Llojet e ndryshme të kërkesëpadive ose padive zakonisht kanë kërkesa të ndryshme kohore, kështu që është e rëndësishme të dihet natyra e kërkesave për të përcaktuar se sa kohë do të jetë në dispozicion për t'i paraqitur ato në gjykatë. Ju gjithmonë do të duhej të kontrolloni afatin e parashkrimit ose periudhën parashkruese në juridiksionin në të cilin shpresoni të ngrini padinë tuaj përpara se ta paraqitni atë. Për shkak të afatit të parashkrimit ose periudhës parashikuese, gjetja e rastit më të mirë për të çuar përpara kauzën ose qëllimin tuaj përmes një procesi gjyqësor strategjik mund të jetë e vështirë. Mbase do të duhet të hulumtoni kufizimet kohore me të cilat do të përballeni sapo të keni një ide se procesi gjyqësor strategjik mund të jetë një strategji që ia vlen të ndiqet.

Nisja e orës/Fillimi i rrjedhjes së afatit: Ora (afati) zakonisht fillon të rrjedhë nga momenti kur në fakt kanë ndodhur veprimet për të cilat dikush shpreson të paraqesë padi, megjithëse në disa raste mund të ketë zgjatje të veçanta. Këto zgjatje shpesh kanë të bëjnë me rastet kur pala e dëmtuar nuk kishte dijeni për dëmin që po shkaktohej në momentin që po ndodhte, siç mund të ndodhë në raste të tilla si mashtrimi ose ekspozimi ndaj substancave toksike dhe të rrezikshme. Në ato raste, afati mund të fillojë të rrjedhë nga momenti kur i dëmtuari merr vesh për dëmin.

Ndalimi i orës: "Pezullimi" i afatit të parashkrimit ose periudhës parashkruese është një term ligjor që do të thotë se ora është ndalur. Ora mund të ndalojë për një sërë arsyesh, duke përfshirë nëse personi që pëson dëmin është i paaftë përkohësisht ose personi që shkakton dëmin përfshihet në disa procedime të tjera ligjore.

Ankimet: Nëse pala e humb rastin në një gjykatë më të ulët ose në një procedim tjetër gjyqësor, ajo mund të jetë në gjendje ta kundërshtojë këtë humbje dhe të kërkojë që një gjykatë më e lartë të shqyrtojë çështjen. Megjithatë, nëse dikush mund të bëjë ankim, ka të ngjarë që do të ketë një afat kohor për t'iu drejtuar gjykatës më të lartë të shqyrtojë urdhrin ose vendimin e gjykatës më të ulët. Kur paraqitet një padi, do të duhej të analizohet nëse garantohet ankimi, nëse mund të kërkohet ankimi por nuk do të ketë të drejtë ankimi me automatizëm, apo nëse vendimi i gjykatës do të jetë i formës së prerë. Nëse do të jeni në gjendje të paktën të kërkoni një ankim, vini re afatin e fillimit të procesit, i cili zakonisht fillon me paraqitjen e një parashtrese ligjore ose duke kontaktuar gjykatën. Disa juridiksione mund t'ju lejojnë të zgjatni këtë afat, por sigurohuni që ta hetoni këtë plotësisht pasi zgjatjet mund të mos jenë automatike. Për çështjet e paraqitura para Gjykatës Kushtetuese në Kosovë, për shembull, nuk ka të drejtë ankimi në nivel kombëtar.

Shterimi i mjeteve juridike: Në mënyrë që një çështje të shqyrtohet nga disa gjykata ndërkombëtare, rajonale ose më të larta kombëtare, pala duhet të ketë shterur mjetet e veta juridike. Kjo do të thotë se pala duhet së pari të kalojë nëpër kanalet e tjera të disponueshme gjyqësore përpara se gjykata e re të shqyrtojë kërkesëpadinë.
Për sa i përket tribunaleve ndërkombëtare ose rajonale, kjo mund të nënkuptojë se palës do t'i kërkohet të kalojë nëpër gjykatat kompetente kombëtare ku do të parashtronte padinë derisa të mos ketë më asnjë mundësi për ankim, e njohur si shterimi i mjeteve juridike. Pasi të ketë vepruar kështu, pala mund të ketë një afat kohor për të paraqitur kërkesëpadinë në një gjykatë më të lartë, ose përndryshe mendimi ose urdhri i gjykatës së fundit mund të qëndrojë në vend. Shumë tribunale ndërkombëtare e vendosin këtë kufi në gjashtë muaj.

Përjashtimet: Mund të ketë përjashtime si për shterimin e detyrimit të mjeteve juridike ashtu edhe për çdo afat kohor të caktuar. Për shembull, nëse dikush mund të provojë se gjykatat në juridiksionin ku do të paraqitnit kërkesëpadinë tuaj janë të korruptuara, mund të mos kërkohet detyrimisht që të ndiqet një mjet juridik në ato gjykata. Ose nëse dikush mund të tregojë pse nuk mund ta paraqitni çështjen tuaj brenda afatit kohor të pritur, mund t'i miratohet një zgjatje e afatit.

Pritshmëritë e kornizës kohore: Për shkak se procesi gjyqësor përfshin medoemos individë, organizata ose qeveri të tjera dhe duhet të mbikëqyret nga një organ gjyqësor, shpesh është e vështirë të parashikohet se sa kohë do të duhet përpara se të merret një vendim i formës së prerë. Është një sërë faktorësh që mund të ndikojnë në kohëzgjatjen e një procesi gjyqësor, por në përgjithësi proceset gjyqësore do të vazhdojnë për periudha më të gjata kohore sa më komplekse të jetë çështja, sa më shumë palë të jenë të përfshira, sa më pak të gatshme janë palët për të zgjidhur çështjet dhe sa më e ngarkuar të jetë gjykata. Në skenarin më të mirë, çështjet mund të zgjidhen brenda disa muajsh. Në disa raste, mund të duhen vite, apo edhe dekada për të marrë një vendim të formës së prerë. Kjo gjithashtu mund të ndryshojë gjerësisht si në të gjitha ashtu edhe brenda juridiksioneve.

Përpara se dikush të paraqesë një padi strategjike të fokusuar në ndërgjyqësi, do të duhej të përpiqet të vlerësojë se sa kohë mund të zgjasë procesi gjyqësor. Asnjëherë nuk mund të përcaktohet saktësisht se kur do të zgjidhet rasti, por mund të përcaktohet një kornizë kohore gjatë së cilës mund të shpresoni t'ju kontaktojë përsëri gjykata. Duke u bazuar në këtë kornizë, mund të ndahet koha dhe burimet në mënyrë të përshtatshme dhe të vendosen pritshmëritë e të gjitha palëve të përfshira.

Masat e përkohshme: Në disa gjykata ose tribunale, mund të ofrohet mundësia e parashtresës për masa të përkohshme (të quajtura gjithashtu mjete juridike të përkohshme), masa të përkohshme, masa siguruese të përkohshme dhe masa siguruese paraprake për të ruajtur *status quo*-në (ose për të shmangur dëmtimin e mëtejshëm gjatë rrjedhës së procesit gjyqësor). Në Kosovë, për shembull, nenet 296-318 të LPK parashikojnë që gjykata mund të marrë masa të përkohshme për "sigurimin e kërkesëpadisë". Këto masa të përkohshme janë të dizajnuara për të parandaluar çdo dëm të mëtejshëm për palët ndërsa çështja është duke u vendosur, kështu që gjykata ose tribunali mund të urdhërojë të pandehurit të pushojnë disa veprime në fillim të çështjes ose të parandalojë hyrjen në fuqi të një ligji ose politike potencialisht të dëmshme. Pasi të jetë nxjerrë aktgjykimi i formës së prerë, masat e përkohshme mund të bëhen të përhershme, të modifikohen ose të hiqen plotësisht.

KUSH MUND TË INICIOJË NDËRGJYQËSI STRATEGJIKE?

Padi në gjykata nuk mund të iniciojë kushdo. Në paditë gjyqësore strategjike, si në të gjitha llojet e padive, përcaktimi se kush janë lojtarët është kritik për suksesin. Ky seksion do të ndihmojë në identifikimin se kush do të duhej të paraqesë padinë, kë do të padisë dhe nëse ose si mund të ndërhyjnë ose të përfshihen ndryshe persona ose organizata që nuk përmenden si palë në padi.

1. Kush do të paraqesë padinë?

Legjitimiteti: Shumica e juridiksioneve, duke përfshirë Kosovën, ende kërkojnë atë që njihet si "legjitimiteti" i një pale të paraqitet në gjykatë. Legjitimiteti i palës është vetëm një mënyrë tjetër për të kuptuar se kush ka zotësinë për të ngritur një padi. Për shembull, në disa vende, për të pasur të drejtën për të ngritur një padi, pala duhet të jetë dëmtuar ose viktimizuar drejtpërdrejt nga personi, organizata ose qeveria që paditet. Është e rëndësishme të shikohet nëse juridiksioni i palës apo ndonjë juridiksion tjetër në të cilin çështja është duke u shqyrtuar kërkon legjitimitetin e palës, dhe – nëse po – çfarë kufijsh vendos se kush mund të ngrejë një padi. Disa juridiksione mund të lehtësojnë kërkesat e vazhdueshme për rastet e paraqitura me "interes publik", (p.sh., Ruanda, India, Afrika e Jugut dhe vende të tjera), të cilat shpesh përfshijnë raste që kanë të bëjnë me shkelje të të drejtave të njeriut.

Organizata kundrejt individit: Kërkesat për legjitimitet të palës zakonisht e bëjnë të qartë nëse një organizatë mund të paraqesë një ankesë në emër të personave që kanë pësuar të padrejta, ose nëse ata persona duhet të paraqesin paditë e tyre drejtpërdrejt. Nëse dikush mund të zgjedhë nga këto dy, vini re se një rast i paraqitur në emër të një grupi ka të ngjarë të gjenerojë shumë më tepër publicitet për grupin sesa nëse emri i grupit nuk do të përfshihej drejtpërdrejt. Kosova u mundëson organizatave që të ngrenë padi në emër të klientëve të tyre.

Palët e treta: Legjitimiteti i palës gjithashtu do të përcaktojë nëse palët e treta të interesuara lejohen të ndërhyjnë drejtpërdrejt ose të bashkohen (neni i LPK) në një padi që tashmë është paraqitur. Këto palë të treta mund të jenë individë ose organizata që nuk janë dëmtuar drejtpërdrejt nga veprimet ose sjellja e personit, organizatës, ose qeverisë që po paditet, por ka një interes të fortë në rezultatin e procesit gjyqësor.

- OJQ-të me orientim ligjor mund të dëshirojnë të ndërhyjnë në një rast për shumë arsye. Ata mund t'i shohin çështjet kyçe të rastit si thelbësore për misionin e tyre, të mendojnë se burimet e tyre do të ishin një ndihmë e nevojshme ose e mirëfilltë për rastin, ose ta shohin rastin si një mundësi për publicitet të mirë.
- Nëse palët e treta nuk lejohen të ndërhyjnë drejtpërdrejt ose të bashkohen në një çështje, ato ende mund të ndihmojnë në procesin gjyqësor duke i bërë opinionet e tyre të njohura si parashtresa *amicus curiae*. *Amicus curiae* do të thotë "mik i gjykatës" dhe shumë juridiksione u lejojnë organizatave të interesuara të përgatisin dhe të paraqesin shkresa ligjore në mbështetje të njërës prej palëve në rast. Edhe Gjykata Supreme e Kosovës edhe ajo Kushtetuese kanë lejuar parashtresat *amicus curiae* në raste të ndryshme.

Paditë e veprimit grupor: Një padi veprimi grupor, gjithashtu e njohur si "padi klasore", veprim kolektiv, apo ndërgjyqësi grupore, mund të jetë një mundësi në disa juridiksione, edhe pse ende nuk është e mundur në Kosovë. Sipas modelit të veprimit kolektiv ose klasor, një grup i vogël individësh ose një organizatë përfaqësuese paraqet padi në emër të një grupi shumë më të madh. Paraqitja e një padie veprimi grupi zakonisht kërkon miratim nga gjykata. Gjykatat mund të dëshirojnë të ekzaminojnë individët që shpresojnë të ngrenë padinë, pretendimet e tyre dhe individët e tjerë në klasën që ata shpresojnë të përfaqësojnë, kështu që do të ishte e udhës të merrni parasysh secilin prej këtyre aspekteve nëse dëshironi të ndiqni një padi veprimi grupor.

Shembull:

1. Shtetet e Bashkuara: Unioni Amerikan i Lirive Civile ngriti me sukses një padi kundër një distrikti shkollor që kishte diskriminuar studentët amerikanë vendas. Ky rast ishte Antoine et. al, kundër distriktit shkollor Winner.

2. *2. Si i zgjidhni paditësit e duhur?*

Gjetja dhe rekrutimi i paditësve: Jo të gjitha rastet e ndërgjyqësisë strategjike janë zgjedhur me kujdes që në fillim, por duke pasur parasysh natyrën e procesit gjyqësor strategjik, mund të gjeni veten në një pozitë duke kërkuar individët e duhur për të paraqitur një padi që mbështet kauzën ose qëllimin e përcaktuar. Nëse keni në mendje një rast të tillë, ka shumë mënyra se si mund të kërkoni dhe të identifikoni individët që mund të paraqesin pretendimet e tyre në gjykata. Këta individë zakonisht njihen si paditës, por mund të quhen edhe ankues, pretendues ose kërkues. Përpara se të filloni të kërkoni paditës në çfarëdo mënyre, sigurohuni që të shikoni ligjet dhe praktikat lokale për të përcaktuar nëse dhe si lejohet rekrutimi ose kërkimi i klientëve. Në Kosovë klientët munden të kërkohen ose të rekrutohen. Kini parasysh se rregullat mund të ndryshojnë për klientët që paguajnë dhe ata që nuk paguajnë Pavarësisht nëse dikush pret që paditësit të paguajnë për shërbimet ligjore në lidhje me rastin, është e rëndësishme të mbani mend se kur dikush flet me paditësit e mundshëm, shpesh ka për synim të çojë përpara kauzën e vet ose të organizatës. Sigurohuni që të jeni sa më të hapur për këtë synim.

Duke e pasur parasysh këtë gjë, më poshtë është një listë e mënyrave të zakonshme për të gjetur ose rekrutuar paditës për një proces gjyqësor strategjik:

- Vizitat në terren/intervistat;

- Referimet nga shërbimet e ndihmës juridike ose shërbime të tjera ligjore për klientët;
- Referimet nga OJQ-të;
- Kanalet ekzistuese për ankesa, si grupet apo organizatat lokale, qendrat komunitare dhe sindikatat;
- Krijimi i kanaleve ose pikave të reja për marrjen e ankesave me ndihmën e avokatëve në nivel lokal dhe kombëtar, avokatëve të gatshëm dhe të interesuar, studentëve të drejtësisë dhe vullnetarëve të tjerë;
- Mbajtja e orarit për konsultime ose punë në zyrë;
- Programet e trajnimit;
- Revistat, buletinet e lajmeve, buletinet e rasteve dhe publikimet e tjera;
- Reklamat në shtyp ose online; dhe
- Takimet ose konferencat me avokatë të interesuar dhe praktikues ligjorë.

Është e rëndësishme të kihet parasysh se një agjenci si ANJF është në një pozicion jashtëzakonisht të favorshëm për të gjetur paditës për ndërgjyqësi strategjike duke pasur parasysh numrin e madh të klientëve që kalojnë nëpër dyert e saj. Ndërgjyqësia strategjike shpesh përfshin adresimin e problemeve sistemore që prekin një numër të madh personash.

Vlerësimi i paditësve të mundshëm: Pasi të jenë identifikuar paditësit e mundshëm që mund ta avancojnë çështjen në një mënyrë kuptimplote, rrethanat e tyre të veçanta dhe karakteristikat individuale do të duhej të hetohen tërësisht përpara se të paraqitet padia. Gjërat që do të duhej të merren parasysh në këtë vlerësim intensiv përfshijnë:

- Pikat e forta dhe të dobëta të pretendimeve të paditësit të mundshëm dhe faktet individuale që lidhen me këto pretendime;
    - Pretendimet e paditësve mund të jenë më tërheqëse nëse rrjedhin nga shumë incidente ose përfshijnë baza të shumta. Paditësit do të duhej të jenë sa më të pëlqyeshëm dhe të mos "mbajnë shumë barrë" nga raste apo aktivitete të tjera.
    - Në disa raste, mund të jetë e udhës të qëndrohet brenda fushave më tradicionale dhe më të vendosura të ligjit, nëse po bëhet testimi i kompetencave të një ligji të ri ose luftimi i diskriminimit në të gjithë sistemin. Për shembull, dikush mund të dëshirojë të paraqesë pretendime të drejtpërdrejta për diskriminim në punësim në vend se të adoptojë një argument më kreativ ose të ri.
- Mënyra e jetesës, orari, koha e lirë dhe disponueshmëria e paditësit për t'u takuar dhe për të marrë pjesë aktive në rast;
- Interesi i paditësit për kauzën;
- Karakteristikat personale si besueshmëria, karizma dhe aftësia për të komunikuar në mënyrë të qartë dhe efektive; dhe
- Gjasat e suksesit dhe efektet që suksesi ose dështimi mund të ketë përfundimisht në ekzistencën e paditësit.

Konsideratat e sigurisë - Qasja "mos shkakto dëm": Është jashtëzakonisht e rëndësishme që siguria e paditësve potencialë ose aktualë, si dhe e çdo personi tjetër të përfshirë në rast, të merret gjithmonë parasysh. Një qasje e tipit "mos shkakto dëm" do të duhej të adoptohet në lidhje me përfshirjen e paditësve në proceset gjyqësore strategjike. Paditësit, avokatët, organizatat dhe

personat e tjerë që ndihmojnë në rastin në fjalë, apo edhe thjesht e mbështesin çështjen, mund të përballen me pasoja të rënda ekonomike, sociale dhe personale. Është e rëndësishme të siguroheni që personat e përfshirë në rastin në fjalë të ndihen të sigurt dhe të mbrojtur. Nëse ka reagime të ashpra të menjëhershme kundër rastit kur paraqitet padia ose situata përkeqësohet në vijimësi, ju do të duhej të siguroheni që të gjitha palët e përfshira dinë se kë mund të kontaktojnë nëse ndonjëherë mendojnë se janë në rrezik. Nëse një person ose organizatë mendon përfundimisht se duhet të ndërpresë përfshirjen në rastin në fjalë, sigurisht që inkurajoheni të diskutoni këtë vendim me ta, por mbi të gjitha duhet të respektoni dëshirat e tyre.

Konfidencialiteti: Të gjitha komunikimet ndërmjet avokatëve dhe klientëve potencialë ose aktualë duhet të mbahen në konfidencialitetin më të rreptë. Edhe fakti që dikush është duke u takuar me avokatë ose duke menduar për të paraqitur një padi është konfidencial. Kur intervistohen paditësit e mundshëm në lidhje me një padi, do të duhej të sigurohen se çdo informacion që mësohet do të mbahet konfidencial, përveç nëse jepet leje për të ndarë, transmetuar ose përdorur ndryshe atë informacion. Kjo do të duhej të vlejë pavarësisht nëse ata përfundimisht bëhen paditës apo marrin pjesë ndryshe në padinë tuaj.

3. Si të zgjidhni të padituri e duhur për paditje?

Përcaktimi dhe përzgjedhja nga të padituri e mundshëm: Po aq e rëndësishme sa gjetja e personave që do të ngrenë një padi është të zbuloni se kë saktësisht duhet të padisin ata. Pasi të paraqitet një padi, pala e paditur zakonisht njihet si e pandehur ose mund të quhet edhe e paditur, në varësi nga gjykata dhe llojit i padisë së paraqitur. Në disa raste, do të jetë shumë e qartë se kush do të ishte i pandehuri ose i padituri i duhur për një padi. Megjithatë, mund të ketë më shumë opsione të disponueshme sesa mendohet, dhe ka disa gjëra që mund të duhet të merren parasysh:

*Lënda***:** Lënda ose thelbi i padisë dhe ligjet që synohet të zbatohen mund të diktojnë ose drejtojnë në mënyrë eksplicite se kush do të ishte i pandehuri ose i padituri i duhur.

Procedura: Ligjet që mbështesin padinë ose gjykata në të cilën paraqitet padia mund të kenë kërkesa procedurale që sugjerojnë ose kërkojnë detyrimisht përzgjedhjen e një të pandehuri ose të padituri të caktuar.

Suksesi: Gjasa e suksesit që mund të keni me ngritjen e padisë kundër të pandehurve të mundshëm gjithashtu mund të hyjë në lojë. Mund të jetë më e lehtë të provohet se një i pandehur i mundshëm ishte përgjegjës për dëmin që pësoi paditësi juaj sesa një tjetër, kështu që mund të konsideroni të përqendroni vëmendjen dhe burimet tuaja te të pandehurit kundër të cilëve keni më shumë prova.

Mjetet juridike: Të pandehur ose të paditur të ndryshëm mund të jenë në gjendje të ofrojnë zgjidhje të ndryshme për të ndrequr dëmin që ka pësuar paditësi juaj nëse fitoni rastin. Për shembull, nëse paditet një kompani, ata mund të jenë në gjendje të ofrojnë para, por nuk do të jenë në gjendje të ndryshojnë një ligj. Me rastin e përzgjedhjes së të pandehurve, do të duhej të rishikohen qëllimet kryesore të çështjes për të kuptuar se cilët të pandehur mund të ofrojnë rezultatet e dëshiruara. I pandehuri ose i padituri do të jetë ketë rëndësi kritike për sjelljen e ndryshimit të dëshiruar shoqëror.

Të pandehur ose të paditur të shumtë: Ashtu siç është e mundur të ketë shumë paditës, është e mundur të ketë shumë të pandehur. Mund të ketë kuptim të paraqitni padi ndaj më shumë se një pale për të marrë ndreqjen/lehtësimin që po kërkoni, veçanërisht nëse kërkohen para. Në disa raste, një të pandehuri mund t'i kërkohet të paguajë për padrejtësitë që kanë shkaktuar të gjithë të pandehurit e tjerë. Kjo quhet përgjegjësi e përbashkët.

Të pandehurit e zakonshëm në proceset gjyqësore strategjike: Ka disa lloje të pandehurish që paditen rregullisht në procese gjyqësore strategjike. Pasi qëllimi i procesit gjyqësor strategjik është ndryshimi më i gjerë shoqëror, të pandehurit më së shpeshti janë degë të pushtetit. Megjithatë, ndonjëherë mund të jetë e mundur të paditen kompanitë dhe korporatat publike ose private që janë veçanërisht me ndikim ose që shkaktojnë dëm të konsiderueshëm. Një listë e të pandehurve më të zakonshëm në çështjet gjyqësore strategjike dhe aspektet që mund të dëshironi të shqyrtoni për të paraqitur një padi kundër tyre është si vijon:

Qeveritë kombëtare: Qeveritë kombëtare kanë kompetencat më të gjera për të ndryshuar ligjet ose praktikat në një shkallë të madhe. Ato gjithashtu mund të kenë më shumë burime për të mbrojtur një padi dhe për të qenë më rezistentë ndaj ndryshimit. Pyetjet që mund t'i bëni vetes përpara se të paraqitni padi ndaj një qeverie kombëtare përfshijnë:

- Cili është qëndrimi i mundshëm i qeverisë kombëtare për padinë? A do të jenë ata mbështetës apo do të zotohen ta luftojnë atë? Pse?
- Nëse qeveria kombëtare nuk është mbështetëse, a ka ndonjë opozitë të organizuar politike? A është ajo opozitë publike dhe e zëshme?
- Nëse qeveria kombëtare në tërësi nuk është mbështetëse, a ka politikanë individualë në nivel kombëtar ose lokal që janë ose do të ishin mbështetës?
- Sa burime do të jetë në gjendje të ndajë qeveria kombëtare për të mbrojtur çështjen? Sa të aftë janë avokatët e tyre? Cila do të jetë strategjia e tyre?
- A ka ndonjë cikël të zgjedhjeve në të ardhmen e afërt ose ndryshime të tjera në pushtet që mund të ndikojnë në qëndrimin e qeverisë kombëtare?

Armët e qeverisë kombëtare dhe nivelet më të ulëta të qeverisjes: Kjo kategori përfshin autoritetet kombëtare dhe lokale, ministritë apo agjencitë qeveritare dhe institucione të caktuara. Brenda një juridiksioni kombëtar, rajonet dhe komunat ose nënndarjet e tjera politike mund të kenë kompetencat e tyre qeveritare dhe të jenë të pandehur të përshtatshëm. Në një sistem federal, qeveritë e shteteve mund të jenë po aq të përshtatshme. Si më sipër, do të jetë e rëndësishme t'i bëni vetes pyetje në lidhje me qëndrimin dhe burimet e të pandehurit të mundshëm, por paraqitja e padisë ndaj një niveli më të ulët të qeverisjes vjen gjithashtu me grupin e vet të konsideratave:

- Nëse padia është e suksesshme, a do të ketë organi qeveritar mbrojtës burimet, fondet dhe infrastrukturën për të ofruar ndreqjen/lehtësimin e kërkuar?
- A ka opozitë të lokalizuar apo të komunitetit? Nëse po, a ka mënyra të mundshme për ta kapërcyer atë?
- A do të tërheqë vëmendjen kombëtare padia? Nëse kjo është e mundshme, a do të ndryshojë politika kombëtare perceptimin e padisë ose a do të ndikojë ndryshe në organin qeveritar ose komunitetin në përgjithësi?

Korporatat: Paditja e korporatave mund të ketë një ndikim të konsiderueshëm global dhe të krijojë një precedent të fortë për praktikat e biznesit. Sidoqoftë, korporatat kanë gjithashtu shumë burime ligjore dhe paditë mund të jenë të ndërlikuara duke pasur parasysh se në sa vende dhe në çfarë mënyrash bën biznes një korporatë e madhësisë së konsiderueshme.

- Korporatat publike, të cilat janë të listuara në bursa dhe priren të jenë më të mëdha për nga shtrirja, mund të presin reagime ndaj padisë nga shumë palë të interesuara. Këto palë përfshijnë aksionarët e korporatës, menaxhmentin, forcën punëtore, kreditorët dhe konkurrentët. Tregjet e përgjithshme financiare dhe rregullatorët e tregut mund të kenë gjithashtu interes. Kjo ka të ngjarë të rezultojë që më shumë njerëz t'i kushtojnë vëmendje më të madhe rastit tuaj, por mbani në mend se kjo mund të funksionojë si për ashtu edhe kundër padisë suaj në varësi nga ajo që palët e interesuara kanë për të thënë.

Për shembull:

1. Qeveria kombëtare. Rusia: Rastet e Impianteve Bërthamore Chelyabinsk/Mayak. Pas një prej fatkeqësive më të mëdha bërthamore në historinë botërore, fëmijët në zonat e prekura u detyruan të ndihmonin në përpjekjet e pastrimit dhe kanë vuajtur nga probleme të rënda shëndetësore prej kohësh. Shumë prej tyre kanë paditur me sukses qeverinë dhe tani marrin pagesa të vogla mbështetëse.
2. Këshillat e shkollave. Shtetet e Bashkuara: Brown kundër Bordit të Arsimit në Topeka, Kansas. Një grup prindërish paditën në emër të fëmijëve të tyre që ndiqnin mësimet në shkolla me segregacion racor. Në një vendim historik, Gjykata Supreme e SHBA urdhëroi që shkollat në të gjithë vendin të integrojnë trupat e nxënësve.
3. Korporatat. Nigeria**:** Një padi e veprimit kolektiv u paraqit nga qeveria nigeriane duke kërkuar kompensim për familjet e fëmijëve të dëmtuar nga testimi i paligjshëm i një ilaçi të paregjistruar të firmës farmaceutike Pfizer te fëmijët.
4. Korporatat. Bregu i Fildishtë: Në gjykatat e Shteteve të Bashkuara u paraqit një padi kundër tri korporatave të mëdha (Nestlé, Archer Daniels Midland Co. dhe Cargill) në emër të individëve që ishin trafikuar për skllavëri në fermat e kakaos kur ishin fëmijë.

5. ***Çfarë roli mund të luajnë OJQ-të dhe lojtarët e tjerë në proceset gjyqësore strategjike si partnerë?***

Ndryshe nga shumica e proceseve gjyqësore individuale, të kesh partnerë në ndërgjyqësi strategjike ka rëndësi kritike pasi ngërthen çështje të nivelit më të lartë përtej rastit individual.

OJQ-të: Shumë OJQ, nëse jo shumica, janë plotësisht të pajisura për të drejtuar çështjet gjyqësore strategjike në shkallë të gjerë pa ndihmë. Nëse një rast do të paraqitet në një vend përtej distancës së udhëtimit nga selia ose zyra në terren e një OJQ, mund të jetë shumë e vështirë të paraqitet ai rast pa përfaqësim lokal. Megjithatë, edhe OJQ-të pa burime për të ngritur paditë e tyre mund të përfshihen në masë të madhe në proceset gjyqësore strategjike. Ato mund të identifikojnë paditësit dhe rastet e mundshme; të menaxhojnë, të shërbejnë dhe të këshillojnë në paditë aktive; të publikojnë progresin e rastit dhe rezultatet eventuale; të monitorojnë përmbarimin e vendimeve gjyqësore; dhe të avokojnë për kauzën prapa çështjes gjyqësore në mënyra të tjera.

Organizatat e tjera të interesuara: Praktikuesi i ndihmës juridike mund të dëshirojë të mendojë për të nxitur pjesëmarrjen nga individë dhe organizata që nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në rastin në fjalë. Mendoni se cilët mund të jenë këta individë dhe organizata dhe pse mund të duan të përfshihen. Nëse ata janë të interesuar, mbase do të mund të bashkoni burimet ose të punoni për rastin së bashku. Për shembull, mund të konsultoheni me këshilltarë ligjorë, OJQ lokale ose ekspertë në fushën që trajton rasti për të ndihmuar në formulimin e strategjisë ligjore, për të siguruar prova të dobishme, për të mobilizuar mbështetje në komunitet ose thjesht për të dhënë komente dhe inkurajim të përgjithshëm. Përpara dhe kur dikush ju afrohet, mbani në mend se mund të keni të bëni me informacione të ndjeshme ose konfidenciale. Së pari duhet të siguroheni që çdo palë e tretë e mundshme me të cilën shpresoni të konsultoheni miratohet nga avokatët e tjerë dhe paditësit e përfshirë për të siguruar që keni lejen e tyre.

6. Ku do të duhej të paraqitet rasti?

Në përgjithësi: Kur e mendojmë se ku duhet të paraqitet një padi strategjike, nuk kemi të bëjmë vetëm me vendin. Mendimet e para mund të përfshijnë juridiksionet ku banojnë paditësit, ku banojnë të padituri dhe ku kanë ndodhur veprimet ose shkeljet për të cilat paraqitet padia. Megjithatë, këto nuk janë zgjedhjet tuaja të vetme – ka edhe tribunale ndërkombëtare edhe gjykata kombëtare në juridiksione të tjera që mund të jenë të gatshme të shqyrtojnë rastin tuaj.

Pasi të jetë përcaktuar gama e plotë të opsioneve, duhet të hulumtohen juridiksionet, gjykatat, tribunalet dhe organet e tjera gjyqësore të mundshme përpara se të bëhet përzgjedhja se ku do të paraqitet padia. Një listë e përgjithshme e vendeve që mund të merren parasysh për paraqitjen e rasteve strategjike, gjithmonë duke marrë parasysh detyrimin e mundshëm për të shterur mjetet juridike, përfshin:

- Gjykatat komunale, lokale ose shtetërore;
- Gjykatat kombëtare (d.m.th., Gjykata Kushtetuese e Kosovës);
- Gjykatat, tribunalet ose komisionet ndërkombëtare; ose
- Organet e traktateve të Kombeve të Bashkuara.

Gjyqtarët dhe profesionistët ligjorë: Pavarësia dhe integriteti i gjyqtarëve dhe profesionistëve ligjorë që punojnë në juridiksion është vendimtar për suksesin tuaj. Për të siguruar që rastit tuaj i jepet një shans i drejtë, gjyqtarët, avokatët dhe i gjithë personeli gjyqësor dhe ligjor duhet të kenë mjetet, mundësitë dhe mbështetjen për të kryer mirë punën e tyre.

Gjyqtarët: Duke qenë se gjyqtarët dhe punonjësit e sektorit gjyqësor do të mbikëqyrin rastin tuaj dhe do të hartojnë urdhra dhe vendime përkatëse, ju do të dëshironi të kërkoni një sistem që ofron një gjyqësor kompetent, të trajnuar mirë, të pavarur dhe të paanshëm. Duke pasur parasysh natyrën progresive të ndërgjyqësisë strategjike, ju gjithashtu mund të preferoni gjyqtarë më proaktivë. Nëse gjyqtarët në një juridiksion të caktuar dihet se janë të prirë ndaj ndikimit të jashtëm ose janë të anshëm në mënyrë tjetër, qëllimi i rastit mund të mos jetë fitorja, por nxjerrja në pah e këtij korrupsioni dhe tërheqja e vëmendjes së komunitetit ndërkombëtar.

Shembull:

1. Guatemala: Dy OJQ sollën së bashku një rast para Komisionit Ndër-Amerikan për të Drejtat e Njeriut për të kundërshtuar procedurat e adoptimit ku pretendohej se gjyqtarët kishin marrë ryshfet për të përshpejtuar aprovimin.

Avokatët: Avokatët e mirë dhe kompetentë janë çelësi për të fituar rastin pasi ata do të përfaqësojnë paditësit në sallën e gjykimit. Për të qenë efektivë, avokatët duhet të jenë në gjendje të punojnë pa u kërcënuar, frikësuar, ngacmuar ose pa u përballur me ndërhyrje të tjera. Ata duhet të jenë në gjendje të udhëtojnë lirshëm për të takuar klientët e tyre, ekspertët, konsulentët dhe personat e tjerë të përfshirë në rastin në fjalë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Nëse ata veprojnë brenda juridiksionit ose kodeve të sjelljes profesionale ose etike të një juridiksioni ose tribunali, ata duhet të jenë në gjendje të mbështeten në ato kode dhe të dinë se nuk do të sanksionohen ose të ndëshkohen ndryshe për veprimet e tyre në lidhje me rastin.

E drejta ndërkombëtare dhe tribunalet - sistemet moniste dhe dualiste: Në përgjithësi, ekzistojnë dy mënyra se si juridiksionet i qasen traktateve dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare. Në ato që quhen sisteme moniste, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare mund të zbatohen drejtpërdrejt nga autoritetet kombëtare dhe në gjykatat kombëtare pasi një traktat ose marrëveshje të jetë nënshkruar, ratifikuar dhe hyrë në fuqi. Mirëpo, në sistemet dualiste traktatet ose marrëveshjet nuk mund të zbatohen nga autoritetet ose gjykatat derisa të miratohen ligje kombëtare për të mishëruar parimet që qëndrojnë prapa atyre traktateve ose marrëveshjeve. Për shkak të kësaj, nëse padia juaj përfshin çështje ndërkombëtare, mund të jetë në njëfarë mënyre më e lehtë për të paraqitur padi në një sistem monist, me një juridiksion që do të zbatonte dispozitat e qarta të vetë traktatit ose marrëveshjes.

Ligjet dhe precedenti: Gjykatat e ndryshme, madje brenda të njëjtit juridiksion, mund të kenë ligje, rregulla dhe procedura shumë të ndryshme. Ato do të mbështeten në precedentë të ndryshëm në analizimin e pretendimeve të padive gjyqësore strategjike dhe vetë ligjit, dhe duhet të sigurohet që kuptohet se çfarë mund të jetë këndvështrimi ose predispozita e mundshme e secilës gjykatë ose tribunal ndaj rastit në fjalë. Për fillim, |do të duhej të shikohet nëse gjykata ose tribunali në të cilin dikush shpreson të paraqesë padinë ka trajtuar ndonjë rast të ngjashëm më parë ose ndonjë proces gjyqësor strategjik në përgjithësi. Nëse jo, mbase duhet të bëhen përpjekje për të kuptuar se sa rol aktiv kanë gjyqtarët dhe gjykatat në mbikëqyrjen e çështjeve dhe çfarë janë tendencat e tyre të përgjithshme. Juridiksionet ose gjykatat më konservatore mund të jenë më pak të hapura ndaj padive novatore ose proceseve gjyqësore potencialisht novatore të iniciuara nga aktivistët.

- Nëse gjatë hulumtimit konstatohet se një gjykatë ose tribunal aktualisht po trajton një rast me lëndë shumë të ngjashme, mund të dëshironi të kontaktoni avokatët e përfshirë në atë rast për ndërhyrje (p.sh., bashkim i palëve, ose bashkëndërgjyqësi, në përputhje me nenin 264 të LPK), bashkëpunim ose bashkim të burimeve. Mbase do të jetë gjithashtu e mundshme të paraqitet një padi e veçantë dhe pastaj t'i kërkohet gjykatës ose tribunalit t'i shqyrtojë të dy rastet së bashku (bashkimi i padive ose rasteve, neni 408 i LPK).

Mjetet juridike dhe ndikimi: Në varësi nga gjykata ku është paraqitur padia, mjetet juridike që mund të kërkohen në rastin në fjalë mund të jenë gjithashtu shumë të ndryshme. Disa gjykata mund të jenë në gjendje të ofrojnë vetëm kompensim monetar, ndërsa të tjerat do të kenë kompetenca më të gjera. Në të njëjtën mënyrë, ndikimi i një suksesi ose humbjeje mund të jetë në mënyrë

dramatike më i madh ose më i vogël në varësi nga gjykata ose tribunali që nxjerr urdhrin ose vendimin. Si rregull e përgjithshme, sa më e lartë të jetë gjykata ose tribunali, aq më i gjerë dhe më i fuqishëm do të jetë ndikimi. Dikush mund të dëshirojë të zgjedhë një gjykatë të njohur ose të respektuar, aktgjykimet e së cilës do të kenë ndikim jo vetëm në nivel kombëtar, por potencialisht edhe në shkallë ndërkombëtare.

Ankimet: Qasja në gjykatat më të larta mund të kufizohet tërësisht ose pjesërisht për ankime, në rastet kur një gjykatë më e ulët ka marrë tashmë një vendim dhe pala humbëse ka kërkuar nga një gjykatë më e lartë që ta shqyrtojë atë vendim. Ankimet mund të jenë kyçe për çështjet gjyqësore strategjike, si për nga sigurimi se çështja do të shqyrtohet në mënyrë të drejtë ashtu edhe për nga qasja në gjykata më të larta dhe më të spikatura për të ngritur profilin e rastit dhe për të ofruar një ndikim më të thellë. Do të duhej të hetohet procedura e ankimit në juridiksionin ku synohet të paraqitet padia dhe të kuptohet se në cilat gjykata mund të bëhet ankim ndaj një vendimi (duke përfshirë tribunalet përkatëse ndërkombëtare) dhe sa kohë mund të zgjasë zakonisht procesi në çdo hap ose nivel.

Koha: Ndikimi i rastit dhe efektiviteti i mjeteve juridike që gjykatat do të mund të ofrojnë mund të varen gjithashtu shumë nga koha. Aty ku dëmi që u bëhet paditësve është i rëndë dhe i vazhdueshëm, mund të kërkohet që gjykata të ndërhyjë herët për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm dhe për të garantuar sigurinë e paditësit. Mirëpo, nëse dëmi është bërë tashmë, koha mund të jetë më pak vendimtare pasi gjykata mund të jetë në gjendje të ofrojë pak më shumë sesa kompensim monetar. Megjithatë, arritja e një fitoreje të shpejtë dhe të hershme mund të jetë ende në gjendje të ndihmojë në mobilizimin e vëmendjes dhe mbështetjes për kauzën tuaj dhe të vendosë themelet që rastet e tjera të kenë sukses.

Opsionet civile kundrejt kriminale: Në disa raste, mund të ketë opsione për të ndjekur edhe çështjet civile edhe çështjet penale. Çështjet civile në përgjithësi paraqiten nga individë ose organizata që kërkojnë mjete juridike nga gjykata për të pushuar ose kompensuar dëmin e shkaktuar nga të pandehurit. Çështjet penale zakonisht paraqiten nga avokatët e qeverisë ose të tribunalit (shpesh të quajtur prokurorë) për të ndëshkuar ose sanksionuar ndryshe një të pandehur për shkelje të ligjeve penale ose kodeve të sjelljes së juridiksionit, megjithëse disa juridiksione mund të lejojnë çështje penale të paraqitura privatisht në rrethana të caktuara.

Çështjet civile: Paraqitja e një çështjeje civile në përgjithësi jep më shumë kontroll mbi procedurat ndërsa ndiqen kërkesëpaditë drejtpërdrejt përpara gjykatës. Duke mos qenë në dispozicion burgimi dhe dënimet e tjera penale, mund të ketë gjithashtu standarde më të relaksuara për dëshmi ose prova që mund ta bëjnë më të lehtë fitimin e rastit. Duke qenë se qëllimi në çështjet civile është të ndreqen gabimet që janë bërë, ato gjithashtu ofrojnë në përgjithësi më shumë mundësi jo vetëm për të detyruar të pandehurit të ndalojnë veprimet e dëmshme, por edhe për të kërkuar kompensim për dëmin e shkaktuar tashmë. Mirëpo, çështjet civile janë përgjithësisht më të gjata dhe më të shtrenjta për t'u ngritur sesa çështjet penale. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur kundër të pandehurve të njëjtë janë ngritur çështje të veçanta penale; në ato raste, gjykatat ose avokatët e qeverisë mund të pezullojnë të gjitha çështjet civile derisa të zgjidhen çështjet penale.

Çështjet penale: Çështjet penale mund të jenë të profilit më të lartë dhe më të fuqishëm sesa çështjet civile. Për shkak të dënimeve ose ndëshkimeve që sjellin çështjet penale, ato mund të shërbejnë gjithashtu për të paralajmëruar individët ose organizatat e tjera të përfshira në aktivitete të

ngjashme që të ndryshojnë sjelljen e tyre. Megjithatë, çështjet penale mund të jenë më të vështira për t'u paraqitur dhe më të vështira për t'u fituar. Standardet për dëshmi ose prova mund të jenë më të larta dhe avokatët e qeverisë mund të kenë burime më të kufizuara ose të jenë të kufizuar politikisht. Këta faktorë mund të duhet të merren parasysh përpara se të inkurajoni qeverinë të ngrejë akuza, të ndjekë një aktakuzë penale private ose të pranojë të marrë pjesë në një çështje penale në ndonjë mënyrë tjetër.

Konteksti: Përveç shqyrtimit të ligjeve të vendit, nuk duhet harruar edhe konteksti në të cilin do të paraqitet padia. Duhet të mendoni me kujdes për nivelet e korrupsionit në juridiksion; qëndrimin e përgjithshëm të qeverisë për të drejtat e njeriut; dhe rreziqet fizike ose të tjera me ët cilat mund të përballen ata që janë të përfshirë në padinë tuaj. Nëse dikush ka rezerva serioze për sigurinë ose frikë nga hakmarrja në një juridiksion të caktuar, mund të jetë më mirë që rasti të paraqitet dhe të drejtohet nga jashtë atij juridiksioni.

Konsideratat financiare: Paraqitja e një çështjeje gjyqësore me interes publik ose një padie me ndikim mund të jetë shumë e kushtueshme, kështu që do të ishte e udhës të hetohen kostot gjyqësore, tarifat ligjore, kërkesat për dorëzani ose siguri, dhe zotimet e tjera financiare në çdo juridiksion të mundshëm. Kostot ligjore mund të jenë jashtëzakonisht të shtrenjta në disa juridiksione, kështu që mund të ketë më shumë kuptim që rastin tuaj ta paraqitni në një juridiksion ku burimet tuaja do të zgjasin më shumë. Ju gjithashtu do të duhej të hetoni nëse tarifat ligjore do të rikuperoheshin nëse e fitoni rastin, që do të thotë se të pandehurit humbës do të duhej të paguajnë avokatët tuaj dhe shpenzimet gjyqësore. Disa juridiksione parashikojnë këtë rregullim veçanërisht në çështjet gjyqësore për të drejtat e njeriut ose me interes të përgjithshëm publik.

Si provohet dhe ndërgjyqësohet çështja?

Fillimi i hetimit: Hetimi i plotë i rastit ka rëndësi kritike për të gjetur strategjinë më të mirë për sukses në sallën e gjykimit. Si hap i parë, do të duhej të mblidhen të gjitha dokumentet dhe të dhënat e disponueshme publikisht të rëndësishme për rastin. Këtu përfshihen artikujt e gazetave, revistave dhe magazinave; raportimet në media dhe raportet akademike; si dhe statistika, studime apo informacione të tjera shkencore. Pasi dikush të krijojë një zotërim të mirë të këtij informacioni bazë, duhet të mendojë të dalë në komunitet për të folur me njerëz që kanë njohuri ose përvojë aktuale me ngjarjet dhe dukuritë që qëndrojnë në themel të pretendimit ligjor. Kur kjo nuk do të rrezikonte paditësit ose nuk do të dëmtonte rastin tuaj, do të duhej të keni parasysh të bisedoni me miqtë, familjen dhe kolegët e paditësit; zyrtarët ose autoritetet qeveritare; mbrojtësit ose avokatët e tjerë në zonë; dhe këdo tjetër që mund të ketë qenë dëshmitar ose mund të ketë dijeni për gjërat që kanë ndodhur në rastin tuaj. Sidoqoftë, mbani mend se nuk mund t'i mësoni të gjitha dhe do të keni mundësinë të mësoni më shumë nëpërmjet kanaleve zyrtare pasi të jetë paraqitur padia juaj.

Konfidencialiteti: Si gjithmonë, të gjitha komunikimet ndërmjet avokatëve dhe klientëve potencialë ose aktualë duhet të mbahen në konfidencialitetin më të rreptë. Mbajeni këtë parasysh kur dikush është duke hetuar rastin pasi nuk dëshironi të rrezikoni paditësit ose ndonjë rast tjetër dhe nuk do të duhej të zbuloni kurrë informacione për rastin. Ndonjëherë, madje t'u bësh me dije njerëzve të tjerë se dikush po planifikon të ngrejë një padi mund të cenojë konfidencialitetin.

Mbajtja e evidencave: Është shumë e rëndësishme të krijohet një gjurmë në letër për hetimin e kryer. Mbani kopje të të gjitha informacioneve të publikuara ose të shkruara që janë gjetur. Merrni shënime dhe bëni foto gjatë çdo interviste ose vizite në terren që kryhet, dhe nëse është e mundur, kërkoni leje për t'i regjistruar ato. Sigurohuni që të evidentoni çdo pjesë të informacionit që dikush mëson gjatë hetimit në çfarëdo mënyre. Sa më të organizuar të jeni në mbledhjen dhe ruajtjen e informacionit, aq më lehtë do të jetë ta gjeni dhe përdorni atë gjatë gjithë rastit.

Gjetja e fakteve: Shumica e juridiksioneve parashikojnë një periudhë për gjetjen e fakteve ose zbulim kur paraqitni rastin tuaj për herë të parë. Gjatë kësaj periudhe, do të keni një mundësi për të marrë dokumente dhe informacion nga kundërshtarët tuaj, dhe ata gjithashtu kanë një mundësi për të marrë dokumente dhe informacion nga klienti(ët). Ndërsa zbuloni më shumë informacion nga kundërshtarët tuaj, ju do të duhej të vazhdoni hetimin në terren me qëllime dhe pyetje më specifike për të ndihmuar rastin tuaj të mëtejshëm ndërsa ai zhvillohet.

Provimi: Në mënyrë që gjykata të marrë vendimin e saj, do të duhet të paraqitni prova për të vërtetuar rastin. Siç u diskutua më lart, rregullat e provave ndryshojnë shumë në të gjitha juridiksionet dhe do të duhej të kuptohen plotësisht përpara se të fillojë hetimi. Duke pasur parasysh këto rregulla, do të dëshironi të tërhiqni vëmendjen e gjykatës për shumë nga gjërat relevante që mësohen gjatë hetimit.

Dëshmitarët: Personat që kanë dijeni, kanë parë ose kanë përjetuar ndryshe gjëra që janë të rëndësishme për rastin mund të jenë në gjendje të shërbejnë si dëshmitarë. Zakonisht, duhet të organizohet që një dëshmitar të vijë në gjykatë ku avokatët e klientit, avokatët e të pandehurve dhe gjyqtari do të kishin të gjithë një mundësi për të bërë pyetje. Mund të jetë gjithashtu e mundur të takoheni dhe intervistoni një dëshmitar me procesverbal jashtë sallës së gjykimit nëse palët e tjera në rastin në fjalë bien dakord për këtë. Mendoni se kush mund të shërbejë si dëshmitar në këtë rast dhe filloni të takoheni me ata individë sa më herët në fillim të procesit – mbani mend se mund të dëshironi t'u kërkoni paditësve dhe të pandehurve në rastin tuaj që të shërbejnë si dëshmitarë. Do të duhej të përgatitni tërësisht pyetjet që shpresoni t'ua bëni dëshmitarëve dhe çdo dokument ose provë tjetër që mund të dëshironi që ata të diskutojnë. Përpara se të sillet dëshmitari në gjykatë, ose të merren në pyetje ndryshe, duhet të siguroheni se ai ose ajo e kupton se si funksionon procesi dhe për çfarë pritet që të flasë ai ose ajo. E mira e së mirës është që gjithmonë të shmangni befasitë.

Provat: Nëse disponohet dokumentacion i shkruar ose fotografik, studime ose anketa shkencore, regjistrime zanore ose video, ose prova fizike, mbase do të mund t'i paraqitni ato drejtpërdrejt në gjykatë. Mund të jetë e mundur ose e preferueshme t'ia sillni në vëmendje gjykatës këto prova ndërsa dikush është duke marrë në pyetje një dëshmitar, roli i të cilit në këtë rast lidhet me provat që synoni të paraqitni. Kini parasysh se ndoshta do të jetë e nevojshme të sillni në gjykatë personin që ka ofruar provat në mënyrë që gjykata të vlerësojë se sa të mbështetshme dhe të besueshme janë provat. Kjo gjithashtu mund të jetë më e besueshme për gjyqtarin.

Ekspertët: Nëse praktikuesi i ndihmës juridike është konsultuar me ekspertë, ata ekspertë mund të paraqesin raporte në gjykatë ose të paraqiten para gjyqtarit si dëshmitar ekspert për të shpjeguar pikëpamjet e tyre. Ashtu si me çdo dëshmitar tjetër, praktikuesi do të duhet të përgatisë

tërësisht çdo ekspert për t'u marrë në pyetje përpara se të vijnë në gjykatë, pasi ata mund të merren në pyetje nga pala kundërshtare.

Strategjia e avokimit: Strategjitë dhe taktikat në rrugën drejt dhe brenda sallës së gjykimit do të jenë thelbësore për çdo fitore dhe do të jenë kryesisht përgjegjësi e avokatëve tuaj. Mirëpo, kjo është vetëm një pjesë e strategjisë së përgjithshme në rastin tuaj. Ju do të duhej të përpiqeni të zhvilloni një vizion gjithëpërfshirës të avokimit që përfshin tërheqjen e vëmendjes ndërkombëtare dhe mobilizimin e mbështetjes së gjerë për kauzën tuaj, dhe mund të dëshironi të insistoni për edukimin e gjykatave dhe profesionistëve ligjorë për çështjet në rastin tuaj në nivel lokal, kombëtar dhe global. Do të duhet të keni një strategji pasuese për periudhën pas vendosjes rreth rastit dhe sigurisht që duhet të parapritni që kauza juaj do të ketë një betejë shumë më të gjatë dhe më të gjerë sesa një vendim i thjeshtë gjyqësor, pavarësisht sa historik apo simbolik mund të jetë.

Ujdia: Shpesh herë, zgjidhja e rastit me ujdi jashtë gjykatës mund të mos jetë në përputhje me qëllimet e procesit gjyqësor strategjik pasi zakonisht nuk ofron një mundësi për të krijuar precedent ose shembull për rastet e ardhshme. Megjithatë, ndonjëherë mund të jetë alternativa më e mirë për arsye strategjike ose praktike dhe nuk do të duhej të shpërfillet. Nëse dikush vendos të zgjidhë rastin me ujdi, është e rëndësishme të mendohet për negocimin e zgjidhjeve dhe ndreqjeve që do të shtriheshin përtej thjesht paditësit ose paditësve të përfshirë në padi. Mund të përfshihen aktivisht të pandehurit, qeveria dhe publiku. Do të duhej gjithashtu të kërkohet që ujdia të bëhet e ditur në mënyrë publike duke paraqitur marrëveshjen në gjykatë nëse është e lejueshme dhe duke diskutuar kushtet e ujdisë me mediat. Ujdia mund të ofrojë një mjet të vlefshëm për të nisur lëvizjet e avokimit dhe reformës dhe gjithashtu mund të shërbejë për të parandaluar dëmtimin ose dëmin që do të shkaktohej në të ardhmen në raste të ngjashme nga të pandehurit.

Humbja: Nëse dikush nuk beson se rasti do të ketë sukses në gjykatë, nuk ka humbur gjithçka. Mund të adoptohen strategji të ndryshme avokimi që në fillim ose sapo të kuptoni me gjasë do të humbni. Mund të filloni të bëni thirrje që gjykatat të monitorohen dhe të reformohen ose të filloni një përpjekje për të rrëzuar vendimin jashtë sallës së gjykimit me ndihmën e qeverisë lokale, shtetërore ose kombëtare. Nëse mungon mbështetja në juridiksionin në të cilin është paraqitur rasti, mund të dëshironi ta çojë avokatinë tuaj jashtë kufijve të tij, si p.sh. në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila, në bazë të të nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, ka efekte të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë si dhe ka fituar epërsi ndaj dispozitave të ligjeve të brendshme. Po kështu, qëllimi i nenit 22 të Kushtetutës është konfirmuar në disa raste të vendosura nga Gjykata Kushtetuese. Së këndejmi, pozicioni i GJEDNJ në rendin juridik të brendshëm është theksuar qartë në një nga çështjet e vendosura nga ajo:

"*Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj... janë inkorporuar brenda së drejtës në Kosovë në nivel kushtetues, dhe iu është dhënë prioritet mbi dispozitat e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike. Kjo Gjykatë duhet të interpretojë Kushtetuën dhe Konventën në mënyrë plotësuese, duke mbajtur mend domosdoshmërinë e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara në të dyja. Shumë vende të Evropës që kanë dalë nga regjimet totalitare gjatë viteve të fundit kanë miratuar standarde*

evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kosova ka bërë të njëjtën gjë. Sistemi ynë është sistem i drejtësisë kushtetuese, i bazuar në parimet e baraziës, respektimit të të drejtave të njeriut, si dhe zbatimin e sundimit të ligjit" (Qemajl Kurtishi kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit, 2009).

Interpretim i ngjashëm është theksuar nga një trup gjykues i përzier i gjyqtarëve të EULEX-it në çështjen penale të Arben Krasniqi et al, (2011), gjatë interpretimit të nenit 156 (2) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) duke marrë parasysh KEDNJ, ku efekti i këtij neni duhet të jetë në lidhje me dispozitat e KEDNJ dhe jurisprudencën e GJEDNJ. Për më tepër, trupi gjykues i përzier i gjyqtarëve të EULEX-it konstatoi:

"*Neni 22 i Kushtetutës së Kosovës e bën KEDNJ drejtpërdrejt të zbatueshme në sistemin e brendshëm juridik të Kosovës. Më tutje, neni 53 i Kushtetutës së Kosovës kërkon që 'të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutën e Kosovës interpretohen në harmoni me*

vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut'... Prandaj, Trupi Gjykues duhet të interpretojë nenin 156(2) të KPPK si 'mundësi për të sfiduar" në harmoni me konstatimet e Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë themelore të njeriut" (Arben Krasniqi et al, 2011).

Përkatësisht, mund të argumentohet se jo vetëm Gjykata Kushtetuese e Kosovës është e detyruar të respektojë dispozitat e KEDNJ dhe jurisprudencën e GJEDNJ, por edhe gjykatat e tjera në Kosovë mund t'i përdorin dispozitat e KEDNJ në përpjekje për të ofruar një analizë të saktë të KEDNJ dhe interpretimin e duhur të dispozitave të ligjeve të brendshme, gjegjësisht nenit 156 (2) të KPPK. Presioni ndërkombëtar mund të jetë dhe shpesh është i dobishëm në promovimin e ndryshimeve shoqërore.

4. Si mund të mbështetet rasti në mënyrë tjetër?

Parashtresat amicus curiae: Disa juridiksione lejojnë OJQ-të, qeveritë, shoqatat tregtare, korporatat ose palët e tjera të interesuara të bëjnë parashtresa ligjore si *amicus curiae*, të shkruara nga "miqtë e gjykatës" që marrin një qëndrim në mbështetje të argumenteve të paditësit ose të të pandehurit. Në rastet që referohen në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Gjykata mund të kërkojë nga aktorë ose ekspertë të caktuar që të paraqesin parashtresa *amicus curiae* në veçanti dhe, në fakt, e ka bërë këtë në të kaluarën. Në juridiksionet ku pranohet ky lloj i parashtresave, si në Kosovë, mund të konsiderohet rekrutimi i grupeve që mbështesin kauzën tuaj për të hartuar dhe paraqitur parashtresa në gjykatë. Mund të zbulohet se ka një kufi në numrin e parashtresave që mund të bëhen nga jo-palët, ku mund të dëshironi të zgjidhni me kujdes se kush ftohet ose kush do të duhej të lejohet të paraqesë parashtresa mbështetëse. Mund të dëshironi të merrni parasysh profilet e kontribuuesve të mundshëm, reputacionin, njohuritë institucionale, prestigjin, misionin e përgjithshëm, motivin për të mbështetur rastin tuaj dhe cilësinë dhe rëndësinë e punës me të cilën ata do të jenë në gjendje të kontribuojnë.

Për shembull:

1. Shtetet e Bashkuara: Me ndihmën e një fakulteti juridik në SHBA, Human Rights Watch paraqiti një parashtresë *amicus curiae* në një rast që ka të bëjë me deportimin e emigrantëve pas dënimeve penale (para Komisionit Ndër-Amerikan për të Drejtat e Njeriut).

2. Evropë: Komisioneri për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës mund të paraqesë parashtresë *amicus curiae* në rastet e të drejtave të njeriut.

Mediat: Ndërgjyqësia strategjike mund të jetë një mënyrë e shkëlqyer për të interesuar dhe përfshirë mediat. Mediat ofrojnë një platformë për të rritur ndjeshëm ndërgjegjësimin si për rastin tuaj ashtu edhe për kauzën tuaj në përgjithësi; nëse dikush e menaxhon mirë publicitetin për rastin, ky ndërgjegjësim mund të shndërrohet në mbështetje shumë të rëndësishme publike për rastin. Edhe nëse rasti nuk është i popullarizuar në nivel lokal ose kombëtar, mediat ndërkombëtare mund të nxisin mbështetje të gjerë përtej kufijve të juridiksionit. Kur parashtrohet rasti për herë të parë ose kur ndërmerret ndonjë hap i madh i mëvonshëm, mund të dëshironi të shkruani një njoftim për shtyp ose të lajmëroni mediat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Në disa raste, mund të ketë gjithashtu kuptim të kontaktohet me politikanë që do të mbështesin përpjekjet. Si gjithmonë, kini parasysh se strategjia ligjore dhe komunikimi ndërmjet avokatëve dhe klientëve janë informacione të privilegjuara dhe konfidenciale.

OJQ-të, akademikët dhe specialistët e tjerë të të drejtave të njeriut: Ka të ngjarë të ketë një gamë të gjerë grupesh dhe individësh të gatshëm të ofrojnë ndihmën dhe mbështetjen e tyre për rastin. OJQ-të mund të ofrojnë ndihmë të çmuar duke bërë fushatë për rastin në komunitet, duke u lidhur në rrjet me mbështetës të tjerë, duke hulumtuar çështje ligjore ose faktike dhe duke mbledhur informacion në terren. Akademikët kanë qasje në shumë institucione kërkimore dhe mund të shkruajnë artikuj rreth çështjeve të rastit në fjalë, të flasin në takime dhe konferenca, ose ndryshe të rrisin ndërgjegjësimin në komunitetet ligjore dhe të të drejtave të njeriut. Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut mund të ofrojnë qasje në biblioteka, këshilla të përgjithshme dhe një shans për t'u lidhur me grupe të tjera të interesuara, ndërkohë që avokatët dhe specialistët e të drejtave të njeriut mund të ndajnë përvojat e tyre dhe të ofrojnë këshilla miqësore. Dhe, sigurisht, mos harroni mesazhet e shtrenjta të mbështetjes që mund të merrni nga familjet, miqtë dhe komunitetet e paditësve.

5. Si ndërmerren veprime pasuese pasi çështja është vendosur?

Ekzekutimi/monitorimi: Zgjidhja me ujdi ose fitimi i një rasti përpara gjykatës është vetëm fillimi i ndryshimit më të gjerë shoqëror që synon të sjellë ndërgjyqësia strategjike. Në fakt, ekzekutimi i urdhrave të gjykatës dhe marrëveshjeve të ujdisë ka qenë historikisht një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen ata që janë përfshirë në çështje gjyqësore strategjike. Mos harroni se qëllimi i ndërgjyqësisë strategjike është reforma e qëndrueshme dhe mund t'ju duhet të monitoroni vazhdimisht respektimin e aktgjykimeve ose ose marrëveshjeve për të siguruar që ato mbeten në fuqi.

Sanksionet: Nëse ka një histori, model ose praktikë të aktgjykimeve ose urdhrave të tjerë të gjykatës që nuk zbatohen detyrimisht në një juridiksion ose kundër një të pandehuri të caktuar, ju mund të dëshironi të argumentoni për një urdhër ose vendim gjykate që jep sanksione realiste dhe lehtësisht të zbatueshme në rast se palët humbëse nuk i binden aktgjykimit. Këtu mund të përfshihen vendosja e programeve të mbikëqyrjes dhe monitorimit ose dhënia e dëmshpërblimit ndëshkues monetar.

Ndihma: Shpesh mund të ketë kuptim t'u kërkohet organizatave të tjera të interesuara brenda juridiksionit që të ndihmojnë në monitorimin dhe ekzekutimin e vendimit. Nëse ata marrin raporte se qeveritë ose të pandehurit e tjerë nuk kanë ndryshuar sjelljen e tyre në përputhje me një aktgjykim të nxjerrë nga gjykata, mund t'u kërkohet të dokumentojnë këto raste dhe t'i referojnë palët e përfshira te ekipi për ndërgjyqësi. Grupe të tjera mund të ofrojnë gjithashtu të ndihmojnë në mënyrë proaktive për të siguruar që aktgjykimi juaj merr efekt duke ofruar shërbimet e urdhëruara nga gjykata ose duke intervistuar pjesëtarët e komunitetit të prekur për të parë nëse ata mendojnë se pozicionet e tyre janë përmirësuar.

Avokimi i vazhdueshëm: Pa avokim të vazhdueshëm, çdo fitore në sallën e gjykimit mund të harrohet shpejt ose – më keq akoma – të zhbëhet. Pavarësisht nëse rasti fitohet apo jo, avokimi pas procesit gjyqësor është thelbësor për të çuar përpara qëllimet e ndërgjyqësisë strategjike dhe nuk duhet pushuar së argumentuari për politika dhe përmirësime më të mira nga qeveria, si programet më efektive të ndihmës, edukimi dhe shërbimet e përgjithshme për komunitetin në përputhje me kauzat e përzgjedhura. Lidhja me organizatat me bazë në komunitetet të prekura në veçanti dhe me juridiksionin në përgjithësi mund të jetë jetike për suksesin në planin afatgjatë.

NDËRGJYQËSIA STRATEGJIKE SI INSTRUMENT
PËR REFORMËN NË KOSOVË – Tri raste studimore

<u>Rasti 1: BIRN kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës</u>

- <u>Objektivi</u>

- Krijimi i precedentit që kërkon që KGJK dhe KPK të zbulojnë emrat e gjyqtarëve
- dhe prokurorëve të shpallur fajtorë për sjellje të pahijshme
- Rritja e ndërgjegjësimit për të drejtën e llogaridhënies në sistemin e drejtësisë

- <u>Strategjia e ndërgjyqësisë</u>

- Dokumentimi i shkeljes së Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Kushtetutës së Kosovës
- Kryerja e shpejtë e ankimit administrativ
- Ankimi i konstatimit nga procedimi administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës
- Ankimi i mëtejshëm në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, sipas nevojës

- <u>Identifikimi i rastit</u>

- Fillohet me çështjen

- <u>Zgjedhja e palës së duhur</u>

- Legjitimiteti si palë: të vendoset nëpërmjet shkeljes së LQDP
- Besueshmëria/Fytyra publike: kompani e besuar, e pavarur mediatike

- <u>Zgjedhja e gjykatës së duhur</u>

- Rrugë relativisht e shpejtë për vendim nga Gjykata Supreme
- Juridiksion i qartë ankimor/shterim i procedurave administrative
- Ankim i mundshëm në Gjykatën Kushtetuese

    - Strategjia e avokimit

- Mediat tradicionale – mbulim i garantuar në të paktën një media të spikatur
- Avokim paralel nëpërmjet fushatës dhe partnerëve tanë
- Parashtresa *Miku i Gjykatës* në Gjykatën Supreme, sipas nevojës

    - Statusi

- Ende në pritje të vendimit
- Ministrja e Drejtësisë në procesverbal në tryezën e rrumbullakët Drejtësia dhe Populli
- Vazhdimi i peticioneve dhe avokimit

Rasti 2: Osmani kundër Gjykata Supreme e Kosovës

    - Objektivi

- Krijimi i precedentit që qartëson kufizimet kushtetuese për paraburgimin.
- Rritja e ndërgjegjësimit për çështjen e paraburgimit të zgjatur në Kosovë

    - Strategjia e ndërgjyqësisë

- Identifikimi i rastit model të paraburgimit të pajustifikuar dhe të zgjatur
- Kryerja e procesit të ankimit nëpërmjet Gjykatës Supreme të Kosovës
- Ankimi në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës

    - Identifikimi i rastit

- Fillohet me çështjen
- Puna me OJQ-të për identifikimin e rastit (Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kosovë)

    - Zgjedhja e palës së duhur

- Legjitimiteti si palë/juridiksioni: Rasti ku pala e akuzuar ka kundërshtuar urdhrat e paraburgimit në Gjykatën Supreme
- Besueshmëria/Fytyra publike: Shkelja është e qartë dhe eklatante, pala e akuzuar nuk ka të dhëna të regjistruara për sjellje të pahijshme gjatë paraburgimit
- Përfaqësimi nga një avokat i besueshëm

    - Zgjedhja e gjykatës së duhur

- Juridiksion i qartë ankimor në Gjykatën Kushtetuese
- GJEDNJ ofron precedent të qartë dhe të detyrueshëm
- Precedenti i Gjykatës Kushtetuese është i detyrueshëm në mbarë Kosovën

    - Strategjia e avokimit

- Mediat tradicionale
- Avokim paralel nëpërmjet fushatës dhe partnerëve tanë
- Parashtresa *Miku i Gjykatës* në Gjykatën Kushtetutës, sipas nevojës

    - Mangësitë:

- Risku i një rezultati të pafavorshëm

    - Strategjia pas-vendimit

- Analiza e arsyeve të mundshme për rezultatin
- Gjetja e një rasti tjetër dhe nisja nga e para
- Paraqitja e të njëjtit rast sërish:
    - Kundërshtimi i aktvendimit të mëvonshëm për paraburgimin mbi baza të pavarura, por të ndërlidhura
    - Përqendrimi i ndërgjyqësisë dhe avokimit në fakte që nuk mund të kontestohen në mënyrë të arsyeshme
    - Mos tëhuani gjykatën

Rasti 3: <u>Kastrati kundër Gjykatës Komunale të Prishtinës, et al.</u>

    - Objektivi

- Krijimi i precedentit duke vendosur detyrën e institucioneve të sistemit të drejtësisë për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje nga kanosjet e njohura të dëmtimit të rëndë dhe përgjegjësia për dëmet
- Rritja e ndërgjegjësimit për të drejtat e viktimave të dhunës në familje

    - Strategjia e ndërgjyqësisë

- Mbështetja në precedentin detyrues të GJEDNJ për të qartësuar detyrimet e institucioneve sipas Kushtetutës së Kosovës
- Përdorimi i një rasti të profilit të lartë për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për dhunën në familje

    - Identifikimi i rastit

- Fillohet me faktet e rastit

- Zgjedhja e palës së duhur

- Legjitimiteti si palë: qëndrimi i gjerë sipas KEDNJ mund të mbulojë prindërit e viktimave
- Besueshmëria/Fytyra publike: babai i përkushtuar ndaj kauzës, jo vetëm ndaj rastit

- Zgjedhja e gjykatës së duhur

- Vendimi nga gjykata mund të marrë shumë vite
- Argument i mirë se rrugët e tjera të ndreqjes/lehtësimit nuk ekzistonin
- Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë precedent i detyrueshëm për gjykatat e instancave më të ulëta
- Nëse konstatohet e pranueshme, vendimi brenda rreth 1 viti

- Strategjia e avokimit

- Përdorimi i rastit si pikë qendrore për diskutimin publik të dhunës në familje dhe të drejtave të viktimave
- Rritja e ndërgjegjësimit publik

- Statusi

- Kërkesa e miratuar nga Gjykata Kushtetuese (shih vendimin e bashkëngjitur)
- Vendimi do të duhej të jetë i detyrueshëm për gjykatat e tjera ose në rastet e ardhshme para Gjykatës Kushtetuese

- Strategjia pas-vendimit

- Publiciteti dhe shpjegimi i vendimit
- Çështja çohet një hap më tutje:
  - Ndjekja e mundshme penale / përfaqësimi i prindërve si palë të dëmtuara për të ilustruar të drejtat e viktimave sipas Kodit të Procedurës Penale
  - Kundërshtimi i mundshëm për kufizimet e dëmeve ndaj institucioneve publike

ANEKSET:

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

Për: Inspektoratin e Punës – Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Nga: (emri, mbiemri dhe adresa e pales)

Lënda: Ankesë

Datë:

Parashtruesi i ankesës, (emri dhe mbiemri i pales) i cili identifikohet sipas letërnjoftimit me numër personal _____ i lindur më _____, ka qenë në marrëdhënie pune të përhershme sipas kontratës që nga viti _____ deri në pensionim në Ministrinë e Shëndetësisë – Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Nga viti _____ deri në muajin _____, ka punuar si _____ në _____, me koeficient të pages__
Në muajin _____ të vitit _____, është caktuar në pozitën e punës si _____. (nese, eshte ngritur ne pozite gjate viteve)

Parashtruesi i ankesës nga momenti i caktimit në pozitën si Përgjegjës vazhdimisht ka kërkuar që t'i lëshohet vendimi lidhur me këtë ndryshim, mirëpo kjo nuk ka ndodhur deri më dt. _____.
Me Vendimin Nr. Prot. _____ të dt. _____ është përcaktuar edhe ngritja e koeficientit të pagës në__

Provë: *Vendimi Nr. Prot. _____ i dt. _____*

I pakënaqur me këtë vendim, z. _____, më dt. _____ ka paraqitur ankesë me shkrim Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të QKUK-së, me të cilën ka kërkuar që t'i bëhet kompensimi e pagës me rritje që nga koha kur është caktuar si Përgjegjës i Ndërrimit në Kuzhinën Qëndore, respektivisht nga muaji Prill i vitit 2011.
Me Vendimin Nr. Ref. ___të dt. ____, të pranuar më ____, Komisioni i Ankesave i QKUK-së e ka refuzuar ankesën e paraqitur.

Provë: *Vendimi Nr. Ref. _____ i dt. _____*

Me nxjerrjen e Vendimit me të cilin është refuzuar ankesa, Komisioni i Ankesave i QKUK-së ka konstatuar gabimisht gjendjes faktike, pasi që parashtruesi i ankesës ka punuar në pozitën si _____

Kjo vërtetohet edhe nga arsyetimi i Vendimit Nr. Prot. _____ i dt. _____, ku shprehimisht ceket se: "U.D. Shef i Sektorit i Ushqimit dhe Servimit të QKUK-së me shkresën nr___ të datës_____, njofton se z. _____ që nga muaji ____ i vitit ____ është caktuar në pozitën e punës Përgjegjës i Ndërrimit në Kuzhinën Qëndrore dhe kërkon që të bëhet korrigjimi, përkatësisht ndryshimi i kontratës nga kuzhinieri në Përgjegjës të ndërrimit dhe ngritjen e koeficioentit në 6.0".

Duke marrë parasysh të lartëcekurat, kërkojmë nga Inspektorati i Punës, që të pranojë ankesën si të bazuar, dhe të urdhërojë Ministrinë e Shëndetësisë – Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, që parashtruesit të ankesës z. _____ t'ia kompensojë pjesën e mbetur të pagave me koeficient 6.0 dhe atë nga muaji _____ i vitit _____ deri më _____.

Në Prishtinë **Ushtruesi i ankesës**

Data: _____

Tel:

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PENSIONALE TE R. KOSOVËS
Nr. dos._____ ZYRA REGJIONALE - Prishtinë

Për

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PENSIONALE
"KËSHILLI I ANKESAVE"
PRISHTINË

_____ me vendbanim të përhershëm në _____ cila e posedon letërnjoftimin e R. Kosovës me nr. personal _____, Kundër Vendimit të Departamentit të Administratës Pensionale nr. i dosjes _____ brenda afatit ligjor, e parashtron këtë:

ANKESË

Kundër Aktvendimit të Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës nr. _____ të dt. _____ të pranuar me datë: _____ për shkak të:

- Vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe
- Aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

ARSYETIMI

Me Vendimin e Departamentit të administratës pensionale për pensionin e personave me aftësi të kufizuar, nr. i dosjes _____ të dt. _____ i është refuzuar kërkesa për njohjen e të drejtës në pensionit pasi Komisioni mjekësor ka konstatuar se te aplikuesi nuk ekziston aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme.

Me rastin e marrjes së këtij Vendimi, organi i shkallës së parë e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike e cila konsiston në faktin se, sipas të gjitha raporteve mjekësore por edhe sipas gjendjes reale faktike, tek aplikuesi për pension invalidor është konstatuar aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme pasi, që një kohë të gjatë lëngon nga sëmundja.

Provë: *Raportet Mjekesore*

Është i pakuptimtë Vendimi i atakuar e cila ka pasuar Kërkesës dhe dëshminë mjekësore të bashkangjitura kërkesës, i njëjti organ tek aplikuesi ka konstatuar aftësi të plotë, kurse në bazë të

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas - Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas Prishtinë, Rr. "Zenel Salihu" nr.30,
Tel. 038 200 18 941 Tel. Falas 0800 11 777, web: www.anji-rks.org

raporteve mjekësore të aplikuesi aftësia e kufizuar është e përhershme dhe mund të konstatohet shumë lehtë në bazë të raporteve mjekësore.

Organi i shkallës se parë pa asnjë hulumtim më të thellë apo ndonjë ekzaminim kualitativ dhe pa i shqyrtuar fare raportet mjekësore, merr Vendim për refuzimin e njohjes të së drejtës ne pension për personat me aftësi të kufizuar.

Aplikimi i gabuar i së drejtës materiale konsiston në faktin se, mu për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, organi i shkallës së parë i ka aplikuar gabimisht dispozitat ligjore .

Komisioni Mjekësor ka anashkaluar dispozitave të ligjit ---- përkatësisht nenit --. Paragrafi (a) dhe nenit 9 i Ligjit Nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti (Gazet Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.35/05 Qershor 2014). për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë, dhe me të drejtat tjera të përcaktuara në Kushtetutën e R. Kosovës, pasi që në bazë të gjendjes shëndetësorë dhe fizike është plotësisht e kufizuar në aftësinë për punë

Me sa u tha më lartë, kërkoj nga organi i shkallës së dytë që, pas shqyrtimit të kësaj ankese dhe Raporteve mjekësore, të merr njërin prej vendimeve të propozuara më poshtë:

VENDIM

APROVOHET Ankesa si e bazuar.

NDRYSHOHET Vendimi i Departamentit të administratës pensionale nr. i dosjes nr. _____ të dt. _____, ashtu që _____, i njihet e drejta në pension si person me aftësi të kufizuar.

ose

PRISHET Vendimi i Departamentit të administratës pensionale nr. i dosjes _____ të dt. _____, dhe lënda kthehet në rivendosje.

Prishtinë, data. Parashtruesi i Ankesës

(emri dhe mbiemri)

Tel:

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

A U T O R I Z I M

Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas në (vendi i zyres regjionale), autorizon (emrin,mbiemrin dhe adresen e avokatit), që ta përfaqësoj përfituesin e ndihmës juridike falas, lënda e së cilës në ZRNJF është evidentuar me numër _____, e dt._____.

Përfituesi i ndihmës juridike falas, _____ nga _____, _____, me nr. të letërnjoftimit _____, i lëshuar nga MPB, përfaqësohet nga av. _____ në lëmin Civile

Çështja juridike: _____

Autorizimi vlen deri në përfundim të lëndës dhe nuk mund të shfrytëzohet për çështje tjera.

Në _____
Dt._____

A u t o r i z u e s i

Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas
Zyrtar për Ndihmë Juridike Falas
_____
_____

Pala: (Emri dhe mbiemri i palës)

(nënshkrimi) _____

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOČ
LEGAL AID

Veprimi juridik

Pala:
Lënda:
Numri i lëndës:
Data:

Emri, mbiemri i zyrtarit
Zyrtar për Ndihmë Juridike Falas
Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas
Prishtinë

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas - Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas Prishtinë, Rr. "Zenel Salihu" nr.30,
Tel. 038 200 18 941 Tel. Falas 0800 11 777, web: www.anjf-rks.org

AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS
Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas Prishtinë
Referim Av.

Evidenca e veprimeve juridike për lënden: numri i lëndes e datës:

Nr.	Avokati	Veprimi Juridik	Data e veprimit	Data e pranimit	Vlera	Nënshkrimi
1.						
2.						
3.						
4.						
5.						
6.						
7.						
8.						
9.						
10.						

(emri, mbiemri i zytarit)
Zyrtare Ligjor
_____

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

GJYKATËS THEMELORE PRISHTINË

-Departamenti i përgjithshëm-

LËNDA: Kërkesë për lirim nga taksa

(emri, mbiemri, adresa, numri i personal i pales), i lëshuar nga MPB, është përfitues i ndihmës juridike falas.

Provë: Vendimi i lëshuar nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas – Prishtinë, me (numër te lendes), i (data).

Pala është shfrytëzuese e ndihmës juridike falas, dhe nuk është në gjendje të paguaj taksën gjyqësore, nga se në mënyrë të drejtpërdrejt, rrezikohet egzistenca e saj. Andaj, kërkojm nga ju, që në pajtim me nenin 8 paragrafi 8.1 dhe 8,3 pika 8.3.2 të Udhëzimin Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të njëjten ta lironi nga shpenzimet e procedurës gjyqësore.

Prishtinë, Data_____ (emri, mbiemri i zytarit)

_____
Zyrtar për Ndihmë Juridike Falas
Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas

Parashtruesi i kërkesës
(Emri dhe mbiemri i palës)
_____

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

GJYKATËS THEMELORE PRISHTINË

-Departamenti i përgjithshëm-

LËNDA: Kërkesë për lirim nga taksa

(emri, mbiemri, adresa, numri i personal i palës), i lëshuar nga MPB, është përfitues i ndihmës juridike falas.

Provë: Vendimi i lëshuar nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas – Prishtinë, me (numër te lendes), i (data).

Pala është shfrytëzuese e ndihmës juridike falas, dhe nuk është në gjendje të paguaj taksën gjyqësore, nga se në mënyrë të drejtpërdrejt, rrezikohet egzistenca e saj. Andaj, kërkojm nga ju, që në pajtim me nenin 8 paragrafi 8.1 dhe 8,3 pika 8.3.2 të Udhëzimin Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të njëjten ta lironi nga shpenzimet e procedurës gjyqësore.

Prishtinë, _____ (emri, mbiemri i zyrtarit)

_____
Zyrtar për Ndihmë Juridike Falas
Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas

Parashtruesi i kërkesës
(Emri dhe mbiemri i palës)
_____

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

P.nr._____

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM

Për:

GJYKATEN SUPREME TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS NË PRISHTINË

Pala: I dënuari _____ nga _____

Lënda: Kërkesë e të dënuarit për mbrojtjen e ligjshmërisë

Në _____ dt. _____

Me aktgjykimin P.nr._____ të datës _____ të Gjykatës Themelore në _____ (emri dhe mbiemri i pales) është shpallur fajtorë për vepër penale Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare nga neni 437 par 1. yë KPRK-së. Dhe është dënuar me dënim me gjobë në shumen prej 1000 (njëmijë) € dhe dënim me kusht prej (katër) muajve ekzekutimi i të cilëve nuk do të bëhet në afate prej një viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk do të kryej vepër tjetër penale. Kundër këtij aktgjykimi pala ka parashtruar ankesë _____ Gjykatës së Apelit në Prishtinë, mirëpo e njëjta me aktgjykimin _____ të datës _____, ankesën e ka refuzuar, kurse aktgjykimin e P.nr._____ të datës: _____ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si Gjykatë e shkallës së parë, e ka vërtetuar, aktgjykimi tani i formës së prerë, në mbështetje të nenit 452 paragrafi 1. të KPPK-së si i dënuar. paraqesë këtë:

KËRKESË

për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Kundër aktgjykimit _____ të datës: _____ të Gjykatës së Apelit në Kosovë si gjykatë e shkallës së dytë i dënuari paraqet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kërkon nga Gjykata

Supreme e Kosovës, që aktgjykimin _____ të dt. _____ Gjykatës Themelore në _____ë, dhe aktgjykimin _____ të dt. _____ të Gjykatës së Apelit në Kosovë t'i anuloj dhe lëndën për rigjykim ta kthej në Gjykatën Themelore në _____ për këto shkaqe:

Duke pasur parasyshë se me kërkesë të prokurorisë ishte kërkuar dënimi _____ dhe gjykata u pajtua me kërkesën, gjykata gabimisht aplikoi dispozitat ligjore të KRPK-së si dhe nene procedurës penale _____ dhe ____

1. Gjykata e shkalles së parë ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë lidhur me dënimin _____ ka aplikuar gabimisht dispozitat ligjore për shkakun se me nenin _____ të KPRK – së janë paraparë rrethana lehtësues për personat që pranojnë fajësinë, pasi që i dënuari nuk ishte në dijeni që një veprim i tillë është në kundërshtim me rendin juridik.

2. Aktgjykim i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë ashtu, edhe Aktgjykimi sipas ankesës në shkallë të dytë nuk ka marrë për bazë gjendjen ekonomike dhe familjare si rrethanë lehtësuese pasi që i dënuari është i pa punë, si dhe faktin se i dënuari gjatë tërë jetës dhe veprimtarisë së tije nuk ka rënë ndeshë me ligjin.

Në bazë të gjitha këtyre paraqesë këtë kërkesë me propozim që të aprovohet e bazuar dhe të konstatohen shkeljet e pretenduara.

Në _____,
Dt._____

Parashtruesi i kërkesës

(emri dhe mbiemri)

.....

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

P.nr. ____

PËR GJYKATËN THEMELORE NË _____
Departamenti i përgjithshëm

Në çështjen penale kundër të akuzuarit _____, i biri i _____, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në _____ – Departamentit të Përgjithshëm, me numër _____, të datës _____, i dyshuar se ka kryer veprën penale _____ nga neni _____ par.__ lidhur me nenin _____ të KPRK-së, në bazë të nenit _____ dhe nenit _____ të Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale të Kosovës (*në tekstin e mëtejmë do t'i referohemi **si KPPK***), paraqes këtë:

KUNDËRSHTIM TË PROVAVE DHE KËRKESË PËR HEDHJE TË AKTAKUZËS
HYRJE

Pala, _____, nga i ati _____, i lindur me dt._____ në _____, me nr. të letërnjoftimit _____, është qytetar i ndershëm dhe i vlerësuar në rrethin shoqëror të komunës së tij.
Mirëpo, me dt. _____ ndaj tij është ngritur aktakuzë për kryerjen e veprës penale _____ nga neni _____ par.1 lidhur me nenin _____ të KPRK-së
Prokurori pretendon që pala ka qenë fajtor për rastit për të cilin akuzohet.

ELABORIMI I KËRKESËS

Në bazë të aktakuzës _____ të dt._____ të ngritur nga prokurori, mund të vërejmë se disa nga rrethanat e rastit janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe prokurori nuk ka bërë vlerësimin e duhur dhe të dyanshëm për të cilin është edhe i obliguar me anë të ligjit.
Fillimisht, para se të lëshohemi në kualifikimin e veprës penale, duhet të theksojmë se _____ në kohen e ndodhjes së rastit nuk ka qenë në vendodhje ne atë moment i njëjti është inkuadruar për të ndihmuar _____ e ti i cili ishte i therur me thikë në rastin në fjal, gjithashtu e ka ndihmuar dhe e ka përcjell deri në spital ku ju është dhënë ndihma e parë, i njëjti deklaron me përgjegjësi morale e penale se _____ gjithherë na ka ngacmuar dhe provokuar duke na fyer me fjalët më banale, veprime te cilat _____i ka bërë herë pas here. Së dyti, vepra për të cilën akuzohet pala, në akuzën e ngritur nga prokurori është kualifikuar në mënyrë të gabuar pasiqë figura e veprës penale të përshkruar dhe figura e veprës penale të cilësuar nuk përkojnë më njëra tjetrën gjë që krijon bazë të mjaftueshme për hedhje të aktakuzës nga neni _____.
Së treti, vepra e pretenduar nga prokurori, është vepër e cila kryhet vetëm me dashje, kurse pala nuk ka vepruar me dashje por i shtyrë nga rrethanat e ndryshme shtëpiake si dëmtimi i pronës dhe personalitetit , fakt i cili nuk konstituon dashjen në kuptimin e plotë të saj.
Vlen të përmendet se prokurori i rastit nuk i ka kryer obligimet e tij nga neni _____ i KPPR – së lidhur me dhënien e materialeve të cilat i jepen të pandehurit me ngritjen e aktakuzës, përveq aktakuzën dhe një procesverbal kurse provat e tjera të grumbulluara nuk i'a ka dhënë palës duke detyruar të përmbushë obligimet e tij nga neni _____ i KPPRK – së.

Së fundi, duhet të përmendim që pala është në gjendje të rendë ekonomike është mbajtësi i familjes dhe nuk ka qenë asnjëherë i dënuar apo i akuzuar për vepër te ngjashme penale, fakt që jep të kuptohet se pala është një qytetar i devotshëm dhe i përgjegjshëm.
Andaj, në bazë të fakteve dhe rrethanave të paraqitura më lart si dhe dispozitave ligjore parashtrojmë këtë:

PROPOZIM

Provat e kundërshtuara të veçohen nga shkresat e lëndës si të papranueshme, ***Ndërsa,*** aktakuza e prokurorisë **PP.nr. _____ e dt. _____** të **Hudhet** si e Pabazuar.

Datë: _____ **Propozuesi:**

_____

(emri dhe mbiemri)

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

MARRVESHJE ME SHKRIM E ÇIFITIT MARTESOR MBI RUAJTJEN, EDUKIMIN DHE MBAJTJEN E FËMIJËVE

E lidhur në bazë të nenit 70 al.2 të ligjit mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare të Kosovës ndërmjet :

1. Emri dhe Mbiemri _____, nga_____, adresa_____numri personal_____

2. Emri dhe Mbiemri _____, nga_____, adresa_____numri personal_____

Çifti jashtëmartesor u murrën vesh në këtë mënyrë si vijon:

1. Nënshkruesit e kësaj marrëveshjes kanë vendosur që ta zgjidhin bashkëjetesën sepse marrëdhëniet e tyre kaherë dhe në mënyrë serioze janë çrregulluar . Çifti jashtëmartesor janë të pajtimit që bashkëjetesa të zgjidhet me marrëveshje, ndërsa sa i përket fëmijut ata janë marrë vesh që kjo të bëhet në këtë mënyrë .

a. Çifti jashtëmartesor deklarojnë se kanë bashkëjetuar dhe nga kjo bashkëjetes kanë dy femijë:

- (emri dhe mbiemri i femijut) e lindur më dt. _____, dhe
- (emri dhe mbiemri i femijut) e lindur me dt. _____ në _____

1. Çifti jashtëmartesor janë të pajtimit që fëmija të mbes në kujdesie, edukim dhe mbajtja te nënës/babait (emri dhe mbiemri).

2. **Bashkëshortet** pajtohet që në emër të ushqimi së kontributit për mbajtjen e fëmijëve plotësimit të nevojave, kërkesat për zhvillimin e fëmijëve të mitur, babait/nëna (emri dhe mbiemri) të paguajnë në çdo muaj shumën prej _____ € të hyrave personale dhe atë deri me dt: 05 të muajit vijues

3. Çifti jashtëmartesor tek i cili do mbetet fëmijët do ti mundësoj babait/nënës (emri dhe mbiemri i prindit) që të mbaj konntakte me fëmiun e tij, dhe vizita do të jetë e lire.

4. Babai/nëna (emri dhe mbiemri) pajtohet qe ish-bashkeshorti/ja mund te marrë fëmijët _____ e lindur më dt. _____, dhe _____ e lindur me dt. _____ jashtë territorit të Republikes së Kosoves.

5.Kjo marrëveshje është përpiluar në 4 ekzemplar prej të cilave nga një i takon bashkë, ndërsa një për Gjykatën kompetente e cila vendos mbi zgjidhjen e martesës .

Me datën _____

Bashkeshortet jashtëmartesor

1. Emri dhe mbiemri _____
2. Emri dhe mbiemri _____

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

GJYKATA THEMELORE NË _____
Departamenti i përgjithshëm

PADITËSI/JA: (emri, mbiemri dhe adresa e pales paditese)
I/E PADITURI/JA: (emri, mbiemri dhe adresa e pales se paditur)

PADI

për pagimin e pagave jubilare

_____ i lindur më _____, ka qenë në marrëdhënie pune si _____ e sistemuar në vendin e punës _____ në _____ në _____ sipas kontratës se punës të lidhur me _____, Komuna e _____ Nr. _____ datë _____.
Ne baze te nenit 67 te Ligjit te Punës është pensionuar me vendimin _____ të _____ dhe i ndërpritet marrëdhënie e punës më _____, sipas fuqisë ligjore për shkak të plotësimit të kushteve për mosha 65-vjet.

Provë: *Kontrata se Punës te lidhur me _____, Komuna e _____ date _____; Provë: Vendimin _____ të datës _____*

Me datën _____ pala është drejtuar me kërkesë me shkrim të paditurës që të bëjë pagesën e tri pagave përcjellëse dhe tri pagave për shërbim jubilar, të cilat i takojnë në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit para universitar të datës _____, e cila është në fuqi dhe zbatohet prej datës _____. Neni 36 pika 9 dhe 10 i kësaj kontrate parasheh që i padituri të bëjë pagesat mirëpo, kjo kërkesë nuk më është miratuar kinse përgjegjësia e implementimit të kontratës kolektive bie mbi MASHT-in.
Edhe pse punëdhënësi ka qenë i obliguar për pagesën pagave jubilare, pasi që asaj i takojnë sipas nenin 90 Ligji Nr. 03/L-212 I PUNËS, neni 4 paragrafi 2 Kontrata e Përgjithshme Kolektive 18.03.2014 dhe neni 36 paragrafi 9 i Kontratës Kolektive te nënshkruar nga Ministri Ramë Buja dhe SBASHK-ut me date 11.04.2014 .
Megjithatë, baza ligjore Kushtetua e Republikës se Kosovës dhe Konventa Evropiane për te Drejtat e Njeriut Kontrata e Përgjithshme Kolektive dhe Kontrata e nënshkruar nga Ministria e Arsimit , Ministri Buja ka krijuar një pritje legjitime qe paga jubilare dhe pagat tjera do ti paguhen pas daljes ne pension te Paditësit.

BAZA LIGJORE E PËR PAGIMIN PAGAVE JUBILARE

Kontrata e Përgjithshme Kolektive nga e cila derivon Kontrata Kolektive e nënshkruara nga Ministri Ramë Buja dhe SBASHK-ut me datë 11.04.2014 ka theksuar se sipas nenit 36 te Kontratës

Kolektive te u njihet punëtoreve shpërblimi i pagave Jubilare qe e paguan punëdhënësi i fundit dhe shpërblimeve tjera qe i njeh ligji për shkak te daljes ne pension .

Kushtetua e Republikës Kosovës: Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]
Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:
[...]

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

Kushtetua e Republikës Kosovës Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Lidhure me një pritje legjitime Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ne rastet si per shembull rastet , *Pine Valley Developments Ltd v Ireland (1993) 16 EHRR 379; Stretch v United Kingdom (2003) 38 EHRR 196. thekson se* :

Në rastin e pretendimeve të ligjshme, një autoritet publik është zakonisht e nevojshme për të marrë ekzistencën e një pritje legjitime në konsideratë kur duke arritur në vendimin e tij dhe, në qoftë se vendos të heqë dore prej tij , për të dhënë arsyet e atij vendimi.

Prandaj, në një rast të ligjshme pritjes autoriteti publik do të ballafaqohet me një detyrë jo vetëm për të arritur rezultatet e duhura materiale, por edhe për të arritur këtë rezultat nga një proces përfundim të saktë.

Kjo është potencialisht një e vështirë e imponuar nga Akti i të Drejtave të Njeriut në lidhje me të drejtat e Konventës.

Karakteristikat themelore të doktrinës së pritshmërisë së ligjshme janë njohur. Kur autoriteti publik përfaqëson (ose me anë të një premtimit të shprehur apo të nënkuptuar me mënyrën e praktikën e kaluar) se do të bëjë atë ai edhe kështu duhet të veprojë, dhe autoriteti publik duhet të japë efektet lidhur me atë pritje.

Pritjet e tilla legjitime janë zakonisht të ndarë në pritjet procedurale të ligjshme, ku pritja është e një përfitim procedurale të tilla si njoftim apo konsultim para çdo ndryshim dhe pritjet legjitime substanciale, ku shpresa është që autoriteti publik do të veprojë në përputhje me përfaqësimin e saj si një çështje e substancës.

Ne rastin tone konkret me rastin e nënshkrimit të Kontratës Kolektive nga Ministri Buja ka rregulluar rregullon marrëdhëniet midis punëdhënësve dhe punëmarrësve në sektorin e Arsimit në mënyrën më të mirë të mundshme.

Andaj nga, provat e ofruara dhe bazën ligjore, duke rezervuar të drejtën në ofrim të provave të tjera shtesë, gjatë shqyrtimit të kësaj lende dhe nga se u tha me lartë , i propozojmë Gjykatës Themelore që pas administrimit dhe shqyrtimit provave të cekura në këtë padi , të bien këtë:

AKTGJYKIM

APROVOHET- Padia dhe kërkesëpadia e Paditëses për **pagimin pagave jubilare**

OBLIGOHET- te padituri qe paguaj shumën e caktuar nga gjykata me kamatë ligjore si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës gjyqësore lidhur me këtë lëndë, të gjitha në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të detyruar.

Në _____, dt._____ Paditësi

_____

(emri dhe mbiemri)

Tel :

Dokumentet e bashkangjitura :

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative

PADITËSI/JA: (emri, mbiemri dhe adresa e pales) K. Prishtinë, e cila e posedon letërnjoftimin e R. së Kosovës me nr. personal _____.

I/E PADITURI/A: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale DAPRK - Prishtinë.

PADI

PËR ANULIMIN E AKTVENDIMIT Nr._____ dt: _____

Kundër Vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në vazhdim MPMS) - Departamentit të Pensioneve, nr. _____ dt: _____ të pranuar më dt. _____.

Më dt. _____ znj. Hatiqe (Ajet) Zuka ka parashtruar kërkesë me nr. Pro. _____ për njohjen e të drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Pas shqyrtimit të kërkesës, MPMS– Departamenti i Pensioneve, më dt. _____ nxjerr vendim me të cilin **Miratohet** kërkesa e (emrin e pales) për njohjen e të drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të dytë pasi që janë përmbushur të gjitha kriteret e parapara në harmoni me nenin 1.1. të nenit 3 dhe pika 1 e nenit 7 të Ligjit 05/L-067 përkatësisht vlerësimit të komisionit mjekësor të dt. _____ sipas të cilit i plotëson kushtet ligjore për kompensim të **Grupit të Dytë**.

Provë: *Vendimi nr. _____ të dt. _____*

E pakënaqur me vendimin e lartcekur parashtruesja e kërkesës ju është drejtuar me ankesë Këshillit të Ankesave pranë DP në MPMS.

Këshilli i ankesave pranë DP në MPMS me dt: 10.12.2018 gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk ka shqyrtuar me arsyshmeri te plotë shkresat ne dosjen e ankueses dhe pa ndonjë hulumtim, ekzaminim të thellë lenë në fuqi vendimin e organit të shkallës së parë.

Provë: *Vendimi Nr._____ dt: _____*

Me nxjerrjen e këtij Vendimi, organi i shkallës së parë, ka bërë shkelje të dispozitave ligjore, përkatësisht të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit 05/L-067, si dhe rregullores nr.07/2017 neni 5

par. 1.2 dhe 1.3, dhe neni 6 par. 1.2 në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik. [….] per shkak se nuk është aprovuar kërkesa në grupin e parë.

1. Përfituesve të këtij ligji u njihet e drejta për një kujdestar personal, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore, e të cilët kompensohen në shumën e njëjtë sikurse përfituesit e këtij ligji.

2. Përfituesit e këtij ligji kanë të drejtën e zgjedhjes së kujdestarit të tyre.

Arsyetimi është kontradiktor me vete Ligjin për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, ku ne paragrafin 1 te nenit 8, decidivisht thuhet se Përfituesve te këtij ligji u njihet e drejta për një kujdestar personal, në baze të vlerësimit nga komisioni vlerësues, me qellim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore, e të cilët kompensohen në shumën e njëjte sikurse përfituesit e këtij ligji.

Me rastin e marrjes së këtij vendimi, organi i shkallës së parë përkatësisht komisioni vlerësues e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike e cila konsiston në faktin se, sipas të gjitha raporteve mjekësore por edhe sipas gjendjes reale faktike, tek aplikuesja është konstatuar aftësia e kufizuar plotë dhe e përhershme konkretisht humbje e plote e ndjeshmërisë se ekstremiteteve e cila është në përputhshmëri me Ligjit 05/L-067 dhe nenet e cekura më lartë, pasi që një kohë të gjatë lëngon nga sëmundja – shih Raportin mjekësor të bashkangjitur.

Provë: *Fletëlëshimi dt.16.02.2018, Fletlëshimi dt.30.03.2004.*

Duke u mbështetur në të cekurat më lartë kërkojmë që si shoqëruese të jetë (emri dhe mbiemri i shoqeruesit), e cila do të shoqëroj gjatë udhëtimeve të ndryshme, do të kujdeset për veshmbathje, vizita mjekësore apo gjithçka qe paraqitet nevoja lidhur me përcjelljen e sajë në vende të ndryshme.
Për këtë përkujdesje dhe përcjellje ne mesë parashtrueses se padisë dhe rejes së saj është e përpiluar edhe **deklarata.**

Provë: *Deklarata, dt.06.03.2019*

Paditësja konsideron se vendimi kontestues i Ministrisë së paditur është marrë edhe mbi bazë të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe disp. ligjore në fuqi dhe në vështrim të nenit 10 të Ligjit të Konflikteve Administrative, është e qartë se ky aktvendim përmban të meta formale – juridike andaj i Propozon kësaj Gjykate që pas shqyrtimit të çështjes dhe provave të bashkangjitura të marrë këtë:

AKTGJYKIM

Të miratohet si e bazuar padia (emri dhe mbiemri i pales) për anulimin e Aktvendimit **nr.**_____ **dt:** _____ të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve në _____ si të kundërligjshëm dhe Gjykata vetë të **miratojë kërkesën** e paditëses për njohjen e të

drejtës në pension Paraplegjik dhe Tetraplegjik në **grupin e parë**, dhe kjo nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Dokumentet e bashkangjitura:

1. **Vendimet nr.____ dt._____ dhe dt._____**
2. **Fletlëshimet dt._____ dhe _____**
3. **Deklarata, dt._____**
4. **Vendimi për Lejimin e Ndihmës Juridike Falas A.nr.**
5. **Kërkesa për lirim nga taksa gjyqësore A.nr.**

Prishtinë, **Paditësi/ja:**

Data: **Tel:**

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

PADITËSI/JA: (emri, mbiemri dhe adresa e paditesit)

I/E PADITURI/A: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Prishtinë, Departamenti për familje e dëshmorëve, **invalid të luftës** dhe viktimave civile

PADI

PËR ANULIMIN E AKTVENDIMIT Nr. _____ dt. _____

Paditësi është shtetas i Republikës së Kosovës dhe jeton në _____.
Meqënese, paditësi është person me aftësi të kufizuara shëndetësore i cili ka qenë përfitues i pensionit material për përsonat me aftësi të kufizuara, i njejti ka kërkuar që ti **vazhdohet** e drejta në pension të Skemes Invalid i Luftës.
Me vendimin e ministrisë Nr. _____ dt. _____ të pranuar me datë _____, kërkesa e tij është refuzuar kinse te paditësi nuk ekziston aftësia e kufizuar dhe e përhershme per invalid i luftës.

Provë: *Aktvendimi Nr. _____ dt. _____*

I pakënaqur me aktvendimin e shkallës së parë, pala ka ushtruar ankesë në organin e shkallës së dytë, i cili ankesën e tij e ka refuzuar me arsyetimin se nuk i plotëson kushtet ligjore për t'iu njohur kjo e drejtë konform dispozitave të nenit 5 paragrafi 1.2.1 si dhe nenit 9 dhe 10 të Ligjit nr.04/L-054 për statusin dhe të drejtat e Familjeve të Deshmerve, veteranve dhe Pjestar të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftes.
Andaj, organi i shkallës së dytë ka nxjerrë vendim arbitrar pa u lëshuar fare në vërtetimin e gjendjes faktike dhe shqyrtimin e provave të bashkangjitura.

Nga këto që theksuam shihet qartë se ekzistojnë të gjitha provat, faktet dhe dëshmitë valide që të njihet e drejta në statusin dhe të drejtat e Familjeve të Deshmorve, veteranve dhe pjestarë të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës. Pasi që e njëjta në bazë të Vërtetimit nr. _____ dt. _____ dhe të diagnozës mjekësore nuk është e aftë ti përgjigjet nevojave personale.

Provë: *Vërtetimit të dt._____, Raportet mjekësore dhe shkresat e dosjes MPMS.*

Mosekzaminimi i palës nga ana e komisionit mjekësor ka bërë që ndaj palës të krijohet parafytyrim i gabuar (*konstatim i gabuar i gjendjes faktike).*
Aplikimi i gabuar i së drejtës materiale konsiston në faktin se, mu për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, organi i shkallës së parë i ka aplikuar gabimisht dispozitat ligjore. Nga e gjithë kjo që u përmend më sipër vendimi i atakuar me këtë padi cenon rëndë të drejtat e siguruara me ligjin, Ligjit nr.04/L-054 për statusin dhe të drejtat e Familjeve të Deshmerve, veteranve dhe Pjestar të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftes, dhe me të drejtat tjera të përcaktuara në Kushtetutën e R. Kosovës.
Organi i administratës së shkallës së dytë, i ka injoruar të gjitha provat dhe dëshmitë dhe nuk e ka kontrolluar fare personin në fjalë dhe në vendimin e lëshuar nuk ka dhënë kurrfarë arsyetimi pse ato nuk janë marrë fare parasysh por vetëm me arsyetim të përgjithshëm se nuk ka dëshmi dhe ka refuzuar ankesën.

Provë: *Raportet nga Konsulta mjeksore*

Të meta e tilla qëndrojnë në shkeljen thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Administrative, shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47 dhe 48 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë raste nënkupton vendimin e kontestuar, duhet patjetër të përmbaj, për veq tjerash , edhe një përmbledhje të konstatime faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklarim të pa bazë.

Paditësi konsideron se vendimi kontestues i Ministrisë së paditur është marrë edhe mbi bazë të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe dispozitave ligjore në fuqi dhe në vështrim të nenit 10 të Ligjit të Konflikteve Administrative është e qarte se ky aktvendim përmban të meta formale – juridike andaj i Propozon kësaj Gjykate që pas shqyrtimit të çështjes dhe provave të bashkangjitura të marrë këtë:

AKTGJYKIM

MIRATOHET - si e bazuar padia e _____.

dhe

ANULOHET Aktvendimit Nr. _____ dt. _____ të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë si të kundërligjshëm dhe Gjykata vetë të miratojë kërkesën e paditësit për

njohjen e të drejtës në pension Pjestar të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftes, **Invalid i Luftës**, dhe kjo nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Në Prishtinë **Paditësi/ja**

Data_____ (emri dhe mbiemri)

_____

Tel:

NDIHMA JURIDIKE | PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS (ANJF)
Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas-_____

Njoftim

I/E nderuar avokat/e, _____

_____, rr._____ Komuna _____, me nr. të letërnjoftimit, _____ në pajtim me Ligjin nr. 04/L-017për Ndihmë Juridike Falas, është përfituese e ndihmës juridike falas.

Kërkojmë që të pranoni palën e referuar, duke u mbështetur në:

- Ligjin nr. 03/L-117 për Avokatinë, në përputhje me nenin 14 pikën 1, dhe
- Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe Mirëkuptimit në mes të OAK-së dhe ANJF-së

Për veprimet e ndërmarra dhe kompletimin e lëndës për procedim të pagesës i referoheni **tarifës** së ANJF-së dhe dokumenteve të cekura në vijim, ndërsa për avokatët që angazhohen për herë të parë nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas dhe që nuk janë të regjistruar si furnitorë, nevojiten këto dokumente:

- Veprimet juridike (origjinali i vulosur nga gjykata)
- Fatura origjinale (duhet ë përmbaj: numrin e faturës, numrin e llogarisë, numrin unik identifikues)
- Letërnjoftimi (kopje)
- Letërkonfirmimi nga banka në emër të biznesit (jo me emër tregtar)
- Numri unik identifikues

Për avokatët që kanë qenë të angazhuar edhe më herët nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas dhe janë të regjistruar si furnitorë në thesar, nevojiten këto dokumente:

- Veprimet juridike (origjinali i vulosur nga gjykata)
- Fatura origjinale (duhet ë përmbaj: numrin e faturës, numrin e llogarisë, numrin unik identifikues)

Për çdo ndryshim në dokumentacion kërkojmë që të na njoftoni.

***Vërejtje*:** Nëse lënda është e pakompletuar nga ana e avokatit/es sipas referimit të lartshënuar, ajo nuk do të pranohet nga zyrtarët e Zyrës Rajonale për Ndihmë Juridike Falas në _____.

I/e nderuar avokat/e nëse nuk e pranoni palën e referuar, kërkojmë që të na dërgoni me shkrim arsyet e refuzimit.

Për informata shtesë, ju lutemi na kontaktoni në numrin pa pagesë: **- 0800 - 11 - 777**

Zyrtar për Ndihmë Juridike Falas
_____

_____

av._____

_____, Dt. _____

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm

PADITËSI/JA: (emri, mbiemri dhe adresa e pales paditëse)
I/E PADITURI/A: (emri, mbiemri dhe adresa e pales se paditur)

PADI

për kompensimin e dëmit

Vlera e kontestit**:** _____**€**

I/e paditura me dt._____ rreth orës _____ përmes punëtoreve të autorizuar duke punuar në ndërrimin e njësorit elektrik nr. _____ në shtëpinë e paditësit gjatë kyçjes së energjisë elektrike me njësorin i kanë ngatërruar lidhjet e përçuesve elektrik me që raste paditësit i shkaktojnë dëme të pajisjeve elekro-teknike në shtëpi.

Provë: Procesverbali nr. _____ dt. _____

Punëtorët e autorizuar të të paditurës në momentin e shkaktimit të dëmit kanë udhëzuar paditësin qe të informoj dhe të parashtroj kërkesë në _____ me qellim të evidentimit dhe të kompensimit të dëmit nga e paditura.

Provë: Kërkesa nr._____ dt. _____

Sipas kërkesës së paditësit, komisionit përkatës i të paditurës me datë _____ ka ardhur në shtëpinë e paditësit dhe ka konstatuar dhe evidentuar në procesverbal dëmin e shkaktuar nga punëtoret e autorizuar.

Provë: Procesverbali nr. _____ dt. _____

Ashtu si është e cekur edhe në proceset më lartë, paditësi disa herë iu ka drejtuar të paditurës që në mënyrë të rregullt ta zgjidhin çështjen e kompensimit të dëmit, mirëpo e paditura në rastin konkret përveç që nuk është përgjigjur me shkrim në kërkesën e parashtruar është injoruar nga zyrtarët përgjegjës.

Pasi që e paditura këtë çështje të kompensimit të dëmit të shkaktuar me fajin e sajë nuk ka dëshiruar të rregulloj jashtë gjykatës, paditësi është i detyruar që këtë çështje ta zgjedhë përmes kësaj gjykate dhe kërkon kompensimin e dëmit :

- Në emër të dëmit material shumën prej _____ €
- Në emër të satisfaksionit, (vuajtjes psikike) shumën prej _____ €

Realizimin e të drejtës mbi kompensimin e dëmit material dhe jo material nga e paditura e mbështesë në bazën ligjore:

Neni 136 par 1, pika 1 i LMD: " Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensoj, përveq nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij":

Neni 137 i LMD: " Dëmi është zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së sajë (fitimi i humbur) si dhe shkaktimi i tjetrit i dhimbjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo materjal)."

Neni 8 par, 1 pika 1 i LMD: " Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vetë dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit ":

Neni 169 par 1, pika 3 i LMD: "Kurë rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur apo, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktoj që ai t'ja paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit ":

Neni 174 i LMD: " Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykoj shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materialë e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim"

Neni 183 par 1 pika 2 i LMD: "Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror".

Neni 323 i LPK: "Po që se vërtetohet se palës i takon e drejt aqë t'i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që ti caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë".

Andaj duke u mbështetur në provat e ofruara dhe Bazën Ligjore, të neneve 136 dhe 137 par 1, neni 8 par 1, pika 1, neni 169 par 1, pika 3, dhe neni 183 par 1, pika 2 të LMD, si dhe nenit 323 të LPK, duke rezervuar të drejtën në ofrim të dëshmitarëve dhe provave të tjera shtesë, gjatë shqyrtimit të kësaj lende, dhe nga se u tha me lartë, i propozojmë Gjykatës Themelore në _____ të bien këtë:

AKTGJYKIM

APROVOHET- Padia dhe kërkesëpadia e paditëses e bazuar

OBLIGOHET- e _____ që në afate prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, me kanosje të përmbarimit me forcë, paditësit _____ t'ja kompensoj shumën e parave prej _____ € në emër të dëmit material dhe shumën prej _____ € në emër të satisfaksionit (vuajtjes psikike), si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore lidhur me këtë lëndë.
Të gjitha këto me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si për deponim në kursim me afat përtej një viti pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e parashtrimit të padis deri në pagesën definitive.
Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e mbështes në nenin 449 të LPK:

Prishtinë, dt._____ **Paditësi/ja**

_____
(emri dhe mbiemri)
Tel:

Dokumentet e bashkangjitura :

5. Procesverbali nr. _____ dt. _____
6. Kërkesa nr._____ dt. _____
7. Procesverbali nr. _____ dt. _____

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

DEKLARATË

Unë _____ e lindur me dt._____ , në K._____me vendbanim të përhershëm në _____me nr. letërnjoftimit _____të lëshuar nga MPB, në përgjegjësinë time morale dhe penale:

DEKLAROJ

Se (personi per te cilin deklaron) _____ e lindur më _____ me vendbanim në _____ K. _____ me nr.personal _____ të letërnjoftimit të lëshuar nga MPB e R.e Kosovës, është e sëmurë me humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve(kategori paraplegjik dhe tetraplegjik), është e pa aftë që të kujdeset për vetën e saj, andaj unë e kam nën përkujdesje dhe përcjellje.

Kjo deklaratë do te shërbej pranë Departamentit të Pensioneve ku do të rregullohet çështja për pension për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, duke u bazuar në ligjin nr. 05/L-067 .

Në Prishtinë **Deklaratdhënësi:**
Data_____

_____

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

PADITËSI/A: (emri, mbiemri dhe adresa e pales paditese)

I/E PADITURI/A: (emri, mbiemri dhe adresa a pales se paditur)

PADI

për
besimin e fëmijëve dhe alimentacion

Palët ndërgjyqës ndërmjet vete kanë krijuar bashkësi jashtëmartesore që nga viti _____ deri në vitin _____, kur bashkësia jashtëmartesore ka pësuar ndarje faktike.

Raportet ndërmjet palëve ndërgjyqësve kanë qenë të mira në fillim por me kalimin e kohës ato janë çrregulluar ashtu që bashkësia jashtëmartesore është shkëputur në mënyrë të pariparueshme.

Provë: *Dëgjimi i palëve*

Nga kjo bashkësi jashtëmartesore ka lindur fëmija _____ e cila është në përkujdesje ekskluzive të nënës/babit – paditëses/paditësit _____ i/e cila ofron përkujdesje prindërore, mbajtje dhe edukim.

Nga koha e shkëputjes nga bashkësia martesore i padituri fare nuk ka shprehur interesim për mirë rritjen edukimin dhe mbajtjen e fëmijës të mitur _____, mospërfillje e obligimit ligjor qe rrjedh nga ligji mbi familjen nga ana e të padituri

Provë: Pohimi i ndërgjygjësve, certifikatat e lindjes së fëmijës Nr. Ref. _____ nr. Rendor _____ dt._____

Meqenëse, ndërgjyqësit më tepër se _____vite kanë bërë shkëputjen faktike të bashkësisë jashtëmartesore/martesore dhe tash jetojnë të ndarë nga shtrati dhe tryeza, paditësja me fëmijën

e saj jeton në adresën e lartcekur në kushte ekonomike skajshmërish të vështira, duke i ofruar me vështirësi mbajtje dhe edukim fëmijës, prandaj duke pasur parasysh interesin e fëmijës, paditësja i **PROPOZON** gjykatës, që pas administrimit të provave të propozuara dhe përfundimit të seancës për shqyrtim kryesor në kuptim të dispozitave të nenit 8 të LPK-së dhe nenit 69 të Ligjit për Familjen, të marrë këtë:

AKTGJYKIM

Aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe vendoset :

- Fëmijët jashtëmartesor _____ caktohen dhe besohet në ruajtje dhe edukim, mbajtje dhe përkujdesje prindërore, nënës/babait _____

  Babait/Nënes _____ i caktohet kontakti me fëmijën e tij dy herë në muaj ekskluzivisht në lokalet e Qendrës për punë Sociale në _____, nën mbikëqyrje të personelit të qendrës .

- Detyrohet i/e padituri/a që në emër të ushqimit, kontributit për mbajtjen e fëmijës plotësimit të nevojave, kërkesat për zhvillimin e të miturës, të paguaj në çdo muaj shumën prej 1/3 të hyrave personale dhe atë deri me dt: 05 të muajit vijues,

- Obligohet zyra e gjendjes civile ne Komunën e _____ që t'ja mundësoj paditësit/es ta posedoj me dokumente identifikimi të miturën _____ pa pëlqimin e të paditurit/

Ky detyrim të realizohet prej datës së parashtrimit të padis në këtë Gjykatë.

Detyrohet i padituri ti paguaj shpenzimet procedurale kontestimore sipas llogarisë së Gjykatës.

Të gjitha këto në afate prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit nën kanosje të përmbarimit me forcë.

Në Prishtinë **PADITËSI/JA**

Data._____ (emri dhe mbiemri)

_____

Tel:

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PENSIONALE TE R. KOSOVËS
Nr. dos._____ ZYRA REGJIONALE - Prishtinë

Për

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PENSIONALE
"KËSHILLI I ANKESAVE"
PRISHTINË

_____ me vendbanim të përhershëm në _____ cila e posedon letërnjoftimin e R. Kosovës me nr. personal _____, Kundër Vendimit të Departamentit të Administratës Pensionale nr. i dosjes _____ brenda afatit ligjor, e parashtron këtë:

ANKESË

Kundër Aktvendimit të Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës nr. _____ të dt. _____ të pranuar me datë: _____ për shkak të:

- Vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe
- Aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

ARSYETIMI

Me Vendimin e Departamentit të administratës pensionale për pensionin e personave me aftësi të kufizuar, nr. i dosjes _____ të dt. _____ i është refuzuar kërkesa për njohjen e të drejtës në pensionit pasi Komisioni mjekësor ka konstatuar se te aplikuesi nuk ekziston aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme.

Me rastin e marrjes së këtij Vendimi, organi i shkallës së parë e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike e cila konsiston në faktin se, sipas të gjitha raporteve mjekësore por edhe sipas gjendjes reale faktike, tek aplikuesi për pension invalidor është konstatuar aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme pasi, që një kohë të gjatë lëngon nga sëmundja.

Provë: *Raportet Mjekesore*

Është i pakuptimtë Vendimi i atakuar e cila ka pasuar Kërkesës dhe dëshminë mjekësore të bashkangjitura kërkesës, i njëjti organ tek aplikuesi ka konstatuar aftësi të plotë, kurse në bazë të

raporteve mjekësore të aplikuesi aftësia e kufizuar është e përhershme dhe mund të konstatohet shumë lehtë në bazë të raporteve mjekësore.

Organi i shkallës se parë pa asnjë hulumtim më të thellë apo ndonjë ekzaminim kualitativ dhe pa i shqyrtuar fare raportet mjekësore, merr Vendim për refuzimin e njohjes të së drejtës ne pension për personat me aftësi të kufizuar.

Aplikimi i gabuar i së drejtës materiale konsiston në faktin se, mu për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, organi i shkallës së parë i ka aplikuar gabimisht dispozitat ligjore .

Komisioni Mjekësor ka anashkaluar dispozitave të ligjit ---- përkatësisht nenit --. Paragrafi (a) dhe nenit 9 i Ligjit Nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti (Gazet Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.35/05 Qershor 2014). për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë, dhe me të drejtat tjera të përcaktuara në Kushtetutën e R. Kosovës, pasi që në bazë të gjendjes shëndetësorë dhe fizike është plotësisht e kufizuar në aftësinë për punë

Me sa u tha më lartë, kërkoj nga organi i shkallës së dytë që, pas shqyrtimit të kësaj ankese dhe Raporteve mjekësore, të merr njërin prej vendimeve të propozuara më poshtë:

VENDIM

APROVOHET Ankesa si e bazuar.

NDRYSHOHET Vendimi i Departamentit të administratës pensionale nr. i dosjes nr. _____ të dt. _____, ashtu që _____, i njihet e drejta në pension si person me aftësi të kufizuar.

ose

PRISHET Vendimi i Departamentit të administratës pensionale nr. i dosjes _____ të dt. _____, dhe lënda kthehet në rivendosje.

Prishtinë,
Data_____

Parashtruesi i Ankesës

(emri dhe mbiemri)

Tel:

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

GJYKATËS THEMELORE PRISHTINË

Departamenti i pergjithshëm – Divizioni Civil

PADITËSI/JA: (emri, mbiemri, adresa e pales paditese)
I/E PADITURI/A: (emri, mbiemri, adresa e pales se paditur)

PADI

Baza e kontestit: Vërtetimi i pronësisë.
Vlera për taksë : _____€.

Paditësit për shkak të mos zgjidhjes së tyre banesore një kohe kanë jetuar dhe qëndruar ne shtëpinë e _____ në _____. Duke e parë gjendjen jo të mirë në të cilën kemi jetuar këtu i padituri pasi që ishte i punësuar në _____vendosi ta takonte babain tonë të ndjerë _____për të biseduar rreth një banese në _____ për të bërë një zgjidhje optimale për të qëndruar dhe për të jetuar të gjithë ne paditësit në atë banesë dhe për të mos i mbetet barrë e mëtutjeshme _____ në _____ i cili nuk i kishe edhe kushtet aq te mira materiale. Babai jonë i ndjerë _____ pas bisedës së gjatë me këtë të padituri _____ erdhi në përfundim që të dytë të kontribuojnë për blerjen e kësaj banese në mënyrë që të zgjidhet çështja e banimit. Babai i ndjerë _____ tha qe ishte në kontakt me _____ e cila e kishte një banesë në shitje në _____. Pas konsultimeve në mes të babit tonë të ndjerë _____ dhe te padituri _____, e ne të cilën bisedë kam qenë prezente unë, babai dhe vëllai jonë i madh këtu i padituri u dakorduan që ta blejë banesën e _____, dhe se kjo banesë do ti takoj vëllait të vogël paditësit _____.

Pas dakordimit në mes të padituri _____ dhe babait tonë të ndjerë _____ i padituri u kthye në _____ për të kërkuar një kredi të vogël, meqenëse pjesën dërrmuese te të hollave për blerjen e kësaj banese e ka paguar babai jone _____ , ndërsa një pjesë e të hollave është siguruar nga shitja e një veture, mirëpo këto mjete nuk mjaftonin për blerjen e banesës, dhe me vullnetin e tij te mirë daja ynë _____ shprehu dëshirën qe të ndihmonte dhe të na mundësonte që ta blejmë banesën.

Shpenzimet e avokatit rreth kompletimit te dokumentacionit i ka paguar babai im i ndjerë _____

Meqenëse, i padituri si vëlla më i madh babi është shprehur qe kjo banesë të blehet në emër të _____ për ta menagjuar më mirë pasurinë e paluajtshme meqenëse, vëllai _____ për të cilin është dedikuar blerja e kësaj banese ka qenë i moshës jo madhore sepse në vitin 2000 ai ka pasur vetëm 12 vjet, dhe babai nga frika se _____ri nuk do të mund të menaxhoj në mënyrën më të mirë me paluajtshmërinë lëndore deklaroi që fillimisht kjo banesë të blehet në emër të vëllait të madh të padituri _____, në atë mënyrë që kur këtu paditësi _____ të arrij moshën madhore, atëherë kjo paluajtshmëri lëndore (banesa) në _____ të bartet në emër të

tij. Poashtu, këtu i padituri në momentin e blerjes së baneses është dakorduar që kjo banesë të bartët në emrin e këtij paditësi _____.
Por, në realitet ndodhi e kundërta. Këtu i padituri pasi krijoi familjen e tij të ngushtë dhe u martua, ai menjëherë na u drejtua me fjalë kërcënuese që dëshiron të na dëboj nga banesa me arsyetimin se kur te vjen nga _____ dëshiron që në këtë banesë të qëndroj i vetëm me bashkëshorten e tij.
Paditësit e kanë vëlla të padituri. Ndërsa _____ e cila ne vitin _____ ka qenë e moshës _____ vjeçare, meqenëse ka qenë fëmiu më i madh ka qenë e detyruar që të përkujdeset për paditësit tjerë dhe ka marre rolin e nënës, dhe se prej atij momenti e deri me tani pala paditëse _____ është përkujdesur për rritjen , mbajtjen dhe edukimin e këtyre paditësve tjerë.

Provë: *Nuk është kontestuese, në rast nevoje dëgjimi i dëshmitarit _____, adresa_____*

Meqenëse, banesa lëndore nuk është blerë vetëm me paratë e këtij të padituri të cilin e kemi _____, por kjo banesë është blerë edhe me paratë e _____ , e po ashtu edhe me kontributin e _____ , duke pas parasysh faktin kjo banesë qysh në momentin e blerjes është blerë dhe dedikuar për vëllain e vogël _____ , mirëpo nuk ka mund të bartet në emër të _____ kjo banesë, për shkak se _____ në momentin e blerjes së kësaj banese ka qenë i moshës jo madhore, kërkojmë nga Gjykata që mos ta lejoj te padituri në asnjë mënyrë që të na dëboj nga kjo banesë, meqenëse kjo banesë nuk është e tij dhe blerja e kësaj banese qysh në momentin e kontraktimit të saj ka qenë e dedikuar për këtë paditësin _____.
Gjithashtu, nuk është kontestues fakti qe këta paditësit banesën lëndore e kanë poseduar dhe shfrytëzuar qysh prej momentit të lidhjes së kontratës mbi shitblerjen e kësaj banese në vitin _____ dhe se prej atëherë e kanë në posedim dhe shfrytëzim të pandërprere, e gjithashtu edhe sot e kësaj dite e posedojnë dhe e shfrytëzojnë ketë banesë.

Provë: *Nuk është kontestuese. Në rast nevoje dëgjimi i dëshmitarëve*.

Te gjitha shpenzimet të cilat rrjedhin nga posedimi dhe shfrytëzimi i kësaj banese, përfshire këtu edhe pagesën e energjisë elektrike, pagesën e tatimit, të gjitha pagesat tjera komunale janë të evidentuara në emër të paditëses _____ , dhe e njëjta prej vitit _____ e tutje në vazhdimësi - pandërprere në kontinuitet të gjitha këto pagesa i ka bërë paditësja _____ - e që është edhe prove materiale qe këta paditësit janë në posedim dhe shfrytëzim të pandërprere te banesës lëndore.

Provë: *Dokumentacioni mbi pagesat*.

Meqenëse, i padituri si _____ dëshiron të keqpërdor pronën e cila qysh në momentin e blerjes është dedikuar për paditësin _____ , dhe i njëjti po mundohet në çdo mënyre që të na dëboj nga kjo banesë, atëherë që të gjithë ne paditësit kërkojmë që në banesën lëndore të kemi bashkëpronësinë në pjesë te barabarta, ngase me ketë është i pajtimit edhe paditësi _____ nga shkaku se te gjithë ne paditësit qysh nga viti _____ e posedojmë dhe shfrytëzojmë banesën lëndore me mirëbesim, andaj edhe e gëzojmë të drejtën që të jemi bashkëpronar në banesën lëndore sepse të njëjtën e kemi në posedim dhe shfrytëzim të pandërprere prej më shumë se 18 vite, andaj janë plotësuar kushtet ligjore meqenëse ketë paluajtshmi e posedojmë me mirëbesim më shumë se 18 vite atëherë është arrite në kufi maksimal fitimi me parashkrim nga Neni 40 I Ligjit për Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore – Ligji nr. 03/L-154 .
Nga sa u tha më lartë paditësit i propozojnë Gjykatës që të caktoj seancë kryesore dhe pas administrimit të provave të merr këtë :

AKTGJYKIM

I.MIRATOHET NE TERESI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve: _____ , që të gjithë nga _____ , dhe DETYROHET I padituri _____, me vendqëndrim në _____i, ndërsa me vendbanim të here pas hershëm në _____, qe paditësve të u'a njoh të drejtën e bashkëpronësisë në banesën e cila gjendet në _____ dhe atë që të gjithëve bashkëpronësinë në nga _____ të banesës lëndore , dhe të lejoj që të njëjtit në aparatin kadastral të Komunës të _____ të regjistrohen si bashkëpronar në nga _____ të banesës lëndore, që të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit me kërcenim të përmbarimit me dhunë.

II. Detyrohet i padituri që paditësve të ua kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësinë të cilën e aprovon Gjykata.

Për shkak se ekziston rreziku i tjetërsimit të banesës lëndore nga ana e të padituri dhe po që një gjë e tillë do të ndodhë atëherë, paditësit do të mbeten në rrugë dhe në mëshirën e askujt, paditësit i propozojnë Gjykatës që në mbështetje të dispozitës se Nenit 297 te LPK-se të caktohet masa e sigurimit, meqenëse pa caktimin e një masë të tillë i padituri si palë kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës sidomos me tjetërsimin e pasurisë , me fshehjen e saj apo me ndonjë mënyrë tjetër me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave dhe në këtë mënyrë do te ndikonte negativisht në të drejtat e paditësve.

Andaj, në kuptim të dispozitës të nenit 297 lidhur me nenin 300 të LPK-se paditësit i propozojnë Gjykatës që të merr këtë:

AKTVENDIM

1. Caktohet masa e sigurisë me të cilin të padituri _____ i **NDALOHET** : Shitja e banesës e cila gjendet _____, fshehja e saj apo ngarkimi i të njëjtës me ndonjë mënyrë tjetër, vënia e kësaj palujtshmëri në ndonjë hipoteke apo ngarkesa me ndonjë barrë tjetër deri në vendimin përfundimtar të formës së prerë të lëshuar nga Gjykata lidhur me këtë çështje juridike.

Me këtë vendim të njoftohen Oda e Noterisë së Kosovës si dhe Drejtoria Gjeodete Komunale në _____ dhe të mos lejojnë shitjen, ngarkesën me ndonjë barrë apo hipoteke e gjithashtu edhe bartjen e paluajtshmërisë në ndonjë person të tretë.

Paditësit:
(emri dhe mbiemri)

_____

Tel:

Në _____
Data:

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË

-Departamenti i përgjithshëm-

PADITËSI/JA: (emri, mbiemri, adresa e pales paditese)

I/E PADITURI/A: (emri, mbiemri, adresa e pales se paditur).

PADI

për zgjidhjen e martesës

Palët ndërgjyqësore ndërmjetë veti me datën _____, kanë lidhur martesë në zyrën e gjendjes civile në Komunën e _____.

Provë: *Ekstrakti nga libri amë i të martuarve Certifikata e Martesës Nr. rendor. _____ e lëshuar me datën _____*

Bashkëshortët gjatë jetës së tyre martesore kanë dy fëmijë, _____ i lindur me dt. _____ dhe _____ i lindur më _____.

Provë: *Certifikatat e lindjes së fëmijëve*

Bashkëshortët kanë jetuar në bashkësi martesore nga viti _____ deri n vitin _____ dhe kanë lidhur martesë pranë Zyrës të Gjendjes Civile në _____, në fillim të jetës bashkëshortore marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve kanë qenë të mira dhe në harmoni të plotë, mirëpo ndërkohë këto marrëdhënie bashkëshortore janë keqësuar deri në atë masë sa që jeta e përbashkët e ndërgjyqësve është bërë e padurueshme për shkak të karaktereve dhe botëkuptimeve të ndryshme për jetën e përbashkët, si pasojë e marrëdhënieve të keqësuara ka ardhur deri te shkëputja faktike e bashkësisë martesore, jetojnë te ndarë afërsisht që 1 muaj ndërgjyqësit dhe kanë ndërprerë çdo kontakt bashkëshortor si dhe nuk ka gjasa për rikthim të bashkësisë martesore.

Provë: *Dëgjimi i palëve*.

Meqenëse, ndërgjyqësit afërsisht që 1 (një) muaj e kanë bërë shkëputjen faktike të bashkësisë martesore tani më pothuajse fare nuk komunikojnë mes vete, paditësja me femijet jeton te prinderit e saj, jeta e paditëses është bërë e padurueshme për shkak të situatës së krijuar dhe tash jetojnë të ndarë nga shtrati dhe tryeza, paditësja ka interes juridik që ta zgjidhë martesën andaj i **PROPOZON** gjykatës, që pas administrimit të provave të propozuara dhe përfundimit të seancës për shqyrtim kryesor në kuptim të dispozitave të nenit 8 të LPK-së dhe nenit 69 të Ligjit për Familjen, të marrë:

AKTGJYKIM

- **Zgjidhet** martesa e lidhur me datën dhe numër _____ në zyrën e gjendjes civile në Komunën e _____, në mes të paditëses (emri, mbiemrin e pales paditeses) dhe (emrin, mbiemrin e pales se paditur)

- Fëmijët të lindur nga kjo martës, (emri i femijeve i lindur me dt. _____ dhe emri i femijese i lindur më _____) i caktohen dhe besohet në ruajtje dhe edukim, mbajtje dhe përkujdesje prindërore (emri dhe mbiemri i prindit te cilit i besohet femiju).

- (emri dhe mbiemri i prindit), i caktohet kontakti me fëmijën e tij dy herë në muaj ekskluzivisht në lokalet e Qendrës për punë Sociale në _____, nën mbikëqyrje të personelit të qendrës .

- Detyrohet i padituri (emri dhe mbiemri i prindit) që në emër të ushqimisë kontributit për mbajtjen e fëmijës plotësimit të nevojave, kërkesat për zhvillimin e fëmijëve, të paguaj në çdo muaj shumën prej 1/3 të hyrave personale dhe atë deri me dt: 05 të muajit vijus,

Ky detyrim të realizohet prej datës së parashtrimit të padis në këtë Gjykatë.

Detyrohet i padituri ti paguaj shpenzimet procedurale kontestimore sipas llogarisë së Gjykatës.

Të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes se aktgjykimit, nën kanosje të përmbarimit me forcë.

Prishtinë, më dt. _____

Paditësja:
(emri dhe mbiemri)

Tel:

Shtojcë:

1. **Certifikata e Martesës Nr. rendor Nr. rendor. _____ e lëshuar me datën _____**
2. **Certifikata e lindjes të fëmijëve _____ dhe _____**
3. **Kërkesa për lirim nga taksa gjyqësore _____ dt._____**
4. **Vendimi për lejimin e Ndihmës Juridike Falas _____ dt._____**
5. **Letërnjoftimi kopje**

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

C.nr.
_____

GJYKATES THEMELORE NË _____ – DEGA NË _____
për
GJYKATEN E APELIT NË PRISHTINË

PADITËSI/JA: (emri, mbiemri dhe adresa e pales paditese)
I/E PADITURI/A: **(emri, mbiemri dhe adresa e pales se paditur)**

Në mbeshtetje te dispozites se nenit 187.1 te Ligjit për Proceduren Kontestimore, ndaj ankeses të të paditureve _____ nga _____, Komuna e _____, ushtruar kunder aktgjykimit të Gjykates Themelore në _____ – Dega në _____ C.nr._____, brenda afatit ligjor prej 7 (shtate) ditesh paraqet:

PËRGJIGJE NË ANKESË
me propozim

Që Gjykata e Apelit në Prishtinë në proceduren sipas ankeses, ankesen e të paduturës_____, e ushtruar më datë _____ kundër akgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtine - Departamentit per Çështje Ekonomike _____ te dt. _____ – ta refuzoj në tërësi si të pa ***themeltë*** dhe të ***vërtetoj*** aktgjykimin e Gjykates Themelore në Prishtinë – Departamenti per Çeshtje Ekonomike _____ të dt. _____.

ARSYETIM

Me aktgjykimin _____ të dt. _____, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çeshtje Ekonomike pjeserisht e ka aprovuar kërkesepadine e paditesit, dhe e ka detyruar të padituren _____ nga _____ , që në emer të kompensimit të demit të i'a paguaj paditesit shumen e përgjithshme të mjeteve në lartësi prej _____ €, së bashku me normen e kamates në lartesi prej _____, e cila do të llogaritet nga data _____ e deri në pagesen definitive, në afat prej 7 ditesh nga data e plotefuqishmerise se ketij aktgjykimi, e cila shumë perfshin kompensimin si ne vijim:

1.1. në emer të demit material për _____ e demtuara shumen e mjeteve në lartesi prej _____ Euro,
1.2 në emer të fitimit te pa realizuar (fitimit te munguar) shumen e mjeteve në lartesi prej _____ Euro
Ndersa, në pjesen tjeter kerkesepadia e paditesit është refuzuar si e pabazuar.
Kundër ketij aktgjykimi e paditura ka ushtrua ankesë per shkak të shkeljes së dispozitave të procedures kontestimore; vertetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të të drejtes material dhe vendimit mbi kamaten.
Ankesa e te paditures është e PATHEMELTE, nga arsyeja se:

Akgjykimi i atakuar nga ana e të paditures – nuk përmban asnjë shkelje thelbesore të dispozitave të procedures kontestimore. dhe se nuk ekzistojnë shkaqet nga të cilat është goditur aktgjykimi, e as shkaqet për të cilat gjykata kujdeset sipas detyres zyrtare .
Gjykata e shkallës së parë në menyrë të drejtë dhe të plotë e ka vertetuar gjendjen faktike dhe në bazë të vertetimit në menyrë të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike ka aplikuar në menyrë tëdrejte te drejtën material, do të thot është zbatuar e drejta material, duke e mbeshtetë me dispozite perkatese ligjore çdo bazë të kërkesëpadisë së paditësit si për pjesën e kerkesëpadise së aprovuar, ashtu edhe për pjesen e kerkesepadise se refuzuar.
Aktgjykimi i goditur nuk permban asnjë shkelje te dispozitave të procedures kontestimore, dhe nuk ekzistojne shkaqet nga te cilat eshte goditur aktgjykimi, e as shkaqet per te cilat gjykata kujdeset sipas detyres zyrtare andaj, për keto arsye ankesa e të paditures duhet refuzuar si e pathemelte, ndërsa aktgjykimi i atakuar duhet **VERTETUAR** (Neni 200 I Ligjit per Proceduren Kontestimore).
Nga keto arsye e autorizuara e paditesit propozon si në propozim te pegjigjes ne ankese

Në_____, dt._____ **Paditësi:**

_____

Tel:

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

Përmes Përmbaruesit privat- Zyra përmbarimore _____

për

GJYKATEN THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

KREDITORI: emri, mbiemri dhe adresa e kreditorit

DEBITORI: emri, mbiemri dhe adresa e debitorit

PRAPSIM I DEBITORIT

Vlera e kontestit: _____.

Kunder aktvendimit per ekzekutim të _____te datës _____ debitori ne afatin ligjor parashtron këtë:

PRAPËSIM

Propozimi për përmbarim i kreditorit - përmes përmbaruesit privat Zyra përmbarimore _____ emeruar për Gjykaten Themelore në Prishtinë mbi caktimin e ekzekutimit të propozuar në Gjykaten Themelore në _____, Kompania _____ të datës _____ është i pa bazë dhe si të tillë duhet hudhur poshtë.

Arsyetim

Kreditori me propozim për perbmbarim cek se në emer të shfrytezimit të _____ e ngarkon debitorin të paguaj shumen prej _____ **Euro.** Debitori e kundershton këtë Aktvendim me arsyetimin se Kreditori nuk ka dëshmuar faturat në bazë të të cilave është lejuar përmbarimi dhe jane dorëzuar te debitori. Nuk ka asnjë provë se faturat janë dorëzuar në procedure të rregullt dhe është bërë shfrytëzimi i _____ në shumen e cekur në faturat e debitorit.
Andaj në pajtim me nenin 58 të LPP paraqes këtë prapsim mbi parashkrimin e _____, Borxhi i referohet periudhës të padefinuar ndërsa propozimi për përmbarim përmes përmbarusit privatë është parashtruar me _____ për të gjitha faturat e arritura mbas nje viti sipas ligjit

konsiderohen të parashkruara, e që borxhi është parashkruar në kuptim të dispozitave të LMD-LIGJI NR. 04/L-077 (neni 360 par. 1.1)

Debitori e mohon borxhin i cili i vihet në barrë për arsye se faturimi është regjistruar në mënyrë paushallë, si dhe gjendja e rëndë socio-ekonomike dhe shëndetësore nuk ja mundëson që të kryej obligimet e shërbimeve ndaj kompanisë së lartë cekur.

Kreditori nuk ka dhënë as një argument se në bazë të cilës kontratë të lidhur me debitorion i ka bazuar faturat .

Debitori nuk është në dijeni me përmbajtjen e faturave që jane objekt i lejimit të përmbarimit pasi ato nuk jan dërzuar debitorit pa bazë ligjore, andaj jane të plotësuar kushtet ligjore që Gjykata në procedur të rregullt të marrë këtë:

AKTVENDIM

Aprovohet Prapsimi i debitorit _____, dhe **Abrogohet propozimi** për përmbarim i kreditorit _____. **Anulohen dhe pezullohen** të gjitha veprimet e ndërmarrura si të kundërlgjshme, ose Gjykata të hap seancë gjyqësore.

Prishtinë, **Debitori:**

Data: _____

Emri dhe mbiemri

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

PROPOZIM

për besimin e fëmijëve me marrëveshje

(emri, mbiemri dhe adresa e palës)
(emri, mbiemri dhe adresa e palës)

Palët kanë krijuar bashkësi jashtëmartesore që nga data_____dhe kanë jetuar në adresën_____Nga martesa ata kanë sjellë në jetë fëmijë, (emrat e fëmijëve) _____datat e lindjes së fëmijëve _____ vendi i lindjes së fëmijëve _____

Dëshmia: Certifikata e lindjes së fëmijëve - Zyra e Gjendjes Civile, Komuna e Prishtinës.

Fillimisht, marrëdhënia bashkëshortore ishte e mirë, por me kalimin e kohës, çifti kanë vënë re se ata kishin pikëpamje të ndryshme për jetën, veset, tiparet, zakonet dhe qëndrimet e kundërta, të cilat e kanë bërë jetën bashkëshortore të padurueshme me kalimin e kohës.

Me kalimin e kohës, bashkëshortët janë përpjekur t'i ndryshojnë këto tipare, por ato përpjekje kanë qenë të pasuksesshme, kështu që bashkëshortët në fakt janë ndarë nga njëri-tjetri dhe tani jetojnë të ndarë.

Besimi i fëmijës (emri dhe mbiemri i fëmijës), i lindur më _____ dhe (emri dhe mbiemri) i lindur më_____ në Prishtinë, sipas marrëveshjes ndërmjet bashkëshortëve, për kujdestari, përkujdesje dhe edukim i është besuar nënës. /babai **(emri dhe mbiemri i prindit)**

Dëshmi: *Marrëveshja e palëve e datës*_____

Dëgjimi i palëve

Meqenëse kjo bashkësi jashtëmartesore ka dështuar dhe nuk ka më gjasa të rikthehet, propozuesit kanë interes ligjor për ta shpërbërë atë formalisht, ndaj i propozojnë kësaj Gjykate që pas shqyrtimit të provave të propozuara dhe përfundimit të seancës kryesore, të vendosë dispozitat e nenit 8 të LPK-së dhe nenit 69 të Ligjit për Familjen, si në vijim:

AKTGJYKIM

• Fëmijët (emri dhe mbiemri i fëmijës), i lindur më _____, dhe (emri dhe mbiemri i fëmijës) i lindur më _____ në _____, i janë besuar nënës/babait (emri dhe mbiemri i prindit)

• **Bashkëshortët** pajtohen që babai/nëna të paguajë shumën prej 100.00 € (njëqind euro) nga të ardhurat e tij personale për ushqimin, mbështetjen, nevojat dhe kërkesat për zhvillimin e fëmijës së mitur çdo muaj dhe deri më datën: 5 të muajit pasardhës. Shuma prej 100.00 € (njëqind euro) mund të rritet sipas kostos së jetesës në Kosovë dhe kapacitetit material dhe financiar të propozuesve.
Ky detyrim duhet të përmbushet nga data e paraqitjes së propozimit në këtë Gjykatë.

• **Kontakti** ndërmjet fëmijës _____ dhe _____ mbetet i hapur, e gjitha kjo sipas marrëveshjes ndërmjet propozuesve.

Nëse Gjykata e miraton propozimin tonë, ne heqim dorë nga **ankesa** eventuale.

Secila palë do të paguajë për shpenzimet e veta procedurale.

PROPOZUESIT

(emri dhe mbiemri i propozuesit) **(emri dhe mbiemri i propozuesit)**

--- ---

Vendi:_____ **Data:**_____

Aneksi:

1. Certifikata e lindjes së fëmijës të lindur me datën_____
2. Certifikata e lindjes së fëmijës të lindur me datën_____
3. Kopje e letërnjoftimit të prindit (babait)_____
4. Kopje e letërnjoftimit të prindit (nënës)_____
5. Kërkesë për përjashtim nga taksat gjyqësore, Nr____ i datës_____
6. Vendim për Lejimin e Ndihmës Juridike Falas, Nr____ i datës

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

_ .nr. _____

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË

- Departamenti i Përgjithshëm -

PROPOZUESI: (emri, mbiemri dhe adresa e propozuesit)

KUNDËRPROPOZUESI : (emri, mbiemri dhe adresa e kunderpropozuesit)

PROPOZIM

Për ekzekutimin e Aktgjykimit me numër _.nr._____ dt._____

Me Aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____, _.nr._____ dt. _____ është **APROVUAR** kërkesë padia e _____ si e bazuar, të cilën e ka ushtruar kundër të paditurës _____, në bazë të të cilës ka kërkuar _____ të datës _____, dhe është **ANULUAR** aktvendimi i të paditurës _____ _____, i datës _____, në bazë të të cilës qështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Provë: *Aktgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës Themelore në _____ me numër _.nr. _____dt. _____*

Propozuesja nuk realizon të ardhura të mjaftueshme dhe është në gjendje të vështirë shendetësore. Pasi qe pala përgjegjëse nuk ka vlerësuar drejtë gjendjen faktike në rastin konkret dhe e njëjta e ka refuzuar ankesën e paditëses, me arsyetimin _____. Pala përgjegjëse gjithashtu nuk ka zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në _____ që të metat e cekura më lartë ti mënjanoj sipar vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, andaj kërkoj nga kjo Gjykatë që të lejohet ekzekutimi i Aktgjykimin me numër _.nr. _____. dt._____

Duke pasur parasysh gjendjen e vështirë ekonomike të propozueses Propozoj Gjykatës Themelore në _____ të bien këtë:

AKTGJYKIM

LEJOHET ekzekutimi i Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____, _.nr. _____. dt._____

OBLIGOHET Kundërpropozuesi _____, që në riprocedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi ti mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë, të bazuar në ligj sipas caktimit qe i është bërë në Aktgjykimin me numër _.nr. _____ dt. _____

Shpenzimet e ekzekutimit bien në barrë Kundërpropozuesit.

Në Prishtinë **Propozuesi/ja**
Data: _____

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

Lidhja C.nr._____ dhe A.nr._____

GJYKATES THEMELORE NË PRISHTINË

për

GJYKATEN SUPREME TË REPUBLIKES SË KOSOVËS NË PRISHTINË

PADITËSI/JA: (emri, mbiemri dhe adresa e pales paditëse)
I/E PADITURI/A: (emri, mbiemri dhe adresa e pales se paditur)
Kundër aktgjykimit _____ te datës _____, të Gjykatës së Apelit në _____ me të cilën është refuzuar ankesa e të paditurit, të paraqitur kunder aktgjykimit C. nr. _____, të Gjykates Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në afatin e caktuar, i padituri, paraqet kete:

REVIZION

- Për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtes materiale.

Me aktgjykimin e Gjykates Themelore- Deparatamenit per Çeshtje Ekonomike në Prishtine C.nr._____, të datës _____ është ***shfuqizuar*** aktvendimi per lejimin e permbarimit _____, te datës _____, dhe është ***miratuar*** kekespadia e paditesit_____ nga _____ dhe është obliguar e paditura, _____nga _____ qe t'ia kompenzoje paditesit borxhin në shumë prej _____ Euro, me norme kamatare prej _____ ne vit, duke filluar nga dita e ushtrimit të padise, dt. _____ deri në përmbushjen e pageses definitive të borxhit, si dhe në emer të shpenzimeve kontestimore shumen prej _____ Euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditesh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kercenim të permbarimit të detyrueshem.
Kunder aktgjykimit të shkallës së parë i padituri ka ushtruar ankesë në Gjykaten e Apelit ne Prishtinë, duke theksuar se gjykata e shkalles së parë për shkak të vertetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit te gabuar të të drejtes materiale, mirpo Gjykata e Apelit e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e te paditures _____nga Prishtina, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i _____ C. nr._____ i datës _____.
Duke pas parasysh qe gjykata e shkalles së dyte nuk i ka pranuar këto thënje të ankeses dhe ankesen e ka refuzuar, i padituri konsideron qe Gjykata e Apelit në Prishtinë e ka shkelur dispoziten ligjore nga neni _____ të LMD-se, nga se kerkespadia e paditësit është parashtruar meqenese ka kaluar afati tre vjeqar me dispoziten e nenit _____ të LMD- se, nga arsyeja se fatura e paditesit me numer _____ daton prej dates _____ ne shumë prej _____ Euro, ndersa padia eshte ushtruar me daten _____, cka do të thot se ka kaluar afati tre vejqar dhe se kërkesëpadia e paditësit për borxhin në shumë prej _____ euro është parashkruar, nga se prej dates _____ e deri me datë _____, është një vit, prej datë _____ e deri me daten _____ jane dy vite, ndersa prej dates _____ e deri me daten _____ jane tri vite, keshtu qe kerkespadia e paditesit është parashkruar dhe gjykata është dashur që në këtë pjese ta refuzoj kërkespadine e paditesit në tërsi si të pa bazuar për shkak të parashkrimit të kerkespadies se paditesit nga neni _____ LMD-se.

Ndersa, paditesi e ka ushtruar padin me daten _____ – do të thot pas kalimit të afatit tre vjeqarë, dhe atë _____ muaj e _____ dite pas kalimit te afatit tre vjeqar.
Gjithashtu, e paditura e ka bëre kthimin mbrapa të mallit nga fatura numer _____ të datës _____ në vlerë prej _____, i cili mall ka qenë i perfshire me këtë fature dhe i njejti ka qenë në Zone Doganore të Kosoves ne Fushe Kosove me teper se tri vjet, dhe i njejti mall nuk ka arritur kurre te e paditura per shkak te cilesise se dobet te mallit.
Ky mall është kthyer tek paditesi në marrveshje në mes Zones Doganore në _____- _____ dhe paditësit, me të cilën marrëveshje është dakorduar është dakorduar edhe i padituri, e çka vërtetohet nga dokumentacioni i lëshuar nga Zona Doganore në _____, e datës _____, keshtu që edhe nga kjo baze paditesi nuk ka të drejtë ligjore të kerkojë pagesen e borxhit në emer të mallit meqenese i njejti mall i është kthyer paditesit, dhe se paditesi me të padituren tani nuk kanë asnjë detyrim financiar në raport me njeri –tjetrin.

Provë: Dokumentacioni i Zones Doganore në _____, datës _____, mbi kthimin e mallit paditesit.

Nga këto arsye e paditura i propozon Gjykates Supreme te Kosoves, që ketë Revizion ta aprovoje në atë menyrë që: ***Aktgjykimin*** e shkallës së parë dhe të dytë ta ndryshoje dhe kerkesepadine e paditesit ta ***Refuzoj*** në tërsi si të pa bazuar, ose ***Revizionin*** ta aprovoje dhe aktgjykimet e siper shënuara ti anuloj në tërsi si të pa baze ligjore

Në _____, Data_____ Paditësi/ja

_____

Tel:

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

C-IV-_____

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME

PËR : Gjyqtarin e Çështjes

NGA: (emri, mbiemri dhe adresa e pales).

LËNDA: Urgjencë për përshpejtim të lëndës

Pranë kësaj Gjykate zhvillohet procedura civile për lëndën _____ në çështjen juridike të _____

Pala është _____ dhe e shtyrë në moshë me gjendje te rëndë shëndetësore dhe ekonomike, andaj i lutem Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në _____ që këtë lëndë ta shqyrtojë me prioritet dhe në nja afat të arsyeshëm kohor.

Andaj, duke pasur parasysh natyrën e problemit si dhe periudhën e gjatë kohore prej kur paditësi-ja ka parashtruar ankesën, vlerësojmë se ky kontest duhet të zgjidhet sa më shpejtë dhe ankuesi të realizojë të drejtën e tij në lidhje me pagat e papaguara.

Pala nga situata e vështirë në të cilën ndodhet, e ka shumë urgjente që lënda të shqyrtohet sa më shpejtë, me qëllim të realizimit të të drejtës së tij.

Nga të cekurat më lartë kërkojmë nga kjo Gjykatë që ta marrë parasysh këtë kërkesë dhe ti jepet prioritet kësaj lënde.

Nga të cekurat më lartë kërkojmë që ta marrë parasysh këtë kërkesë dhe ti jepet prioritet kësaj lënde.

Në _____,
dt. _____

Paraqitësi i kërkesës
_____
Tel:

NDIHMA JURIDIKE • PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

AGJENCIA PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas (vendi i zyres regjionale)

(numri i lendes)
(data)

Në pajtim me neni 32. pika 1,2,3 dhe 4 të Ligji për Ndihmë Juridike Falas, nr. 04/L-017, Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas në Prishtinë, bie këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa për lejimin e ndihmës juridike falas për (emri,mbiemri, adresa e pales) cila është përfituse e ndihmës juridike falas.

A r s y e t i m

Pala (emri, mbiemri i pales) ka parashtruar kërkesën për ofrimin e ndihmës juridike falas. Pas shqyrtimit të kërkesës së aplikuesit, verifikimit të përmbushjes së kritereve në pajtim me nenin 7,8 dhe 9 të LNJF, si dhe dokumentacionit të bashkangjitur, Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas, në Prishtinë, konstatoi se përfituesja potenciale e ndihmës juridike falas i plotëson të gjitha kriteret e parapara, në pajtim me Ligjin për Ndihmë Juridike Falas Nr. 04/L-017.

Zyrtar i Ndihmës Juridike Falas

(emri, mbiemri i zyrtarit)

_____

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtrojë ankesë, në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit. Ankesa i dorëzohet Komisionit për Ankesa, të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.